




abkons
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

EITI Shqipëri, Raporti Studimor Përfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse

Nëntor 2020

Tiranë, Shqipëri



MICHAEL BARRON
Consulting 

abkons
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards



PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	EITI Shqipëri Studimi Mjedisor për Industrinë Nxjerrëse
TITULLI I DOKUMENTIT	Raporti Studimor në fushën e Mjedisit

SHQY.	QËLLIMI I STUDIMIT	SHËNIME/PËRSHKRIMI	AUTORË	DATË
1	Draft-Raport	Shqyrtim i Brendshëm	Abkons sh.p.k	14/09/2020
2	Draft Raport	Shqyrtim i Brendshëm	Abkons sh.p.k	15/10/2020
3	Draft Raport	Shqyrtim nga EITI Shqipëri	Abkons sh.p.k	27/10/2020
4	Draft Raport	Shqyrtim i Brendshëm	Abkons sh.p.k	13/11/2020

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR I STUDIMIT


	KONSULENTI			KONTRAKTORI	
	Përgatitur	Kontrolluar	Miratur	Kontrolluar	Miratur
Emri/Mbiemri	Johan Shyti Zija Kamberi Michael Barron Tim Law Sulejman Sulçe	Maklen Misha	Redion Biba		
Firma					
Datë	13/11/2020	16/11/2020	16/11/2020		
Statusi i Dokumentit	Draft	Draft	Përfundimtar		



Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje	8
1.1.	Qëllimi i Studimit	8
2.	Përshkrim i Industrive Nxjerrëse në Shqipëri	10
2.1.	Sektori Minerar	10
2.2.	Sektori i Naftës dhe Gazit	13
3.	Llojet e Projekteve të Industrisë Nxjerrëse	16
3.1.	Industria Minerare	16
3.1.1.	Minierat Sipërfaqësore	16
3.1.2.	Minierat Nëntokësore	17
3.1.3.	Minierat me Tretësirë në Vendgërmim	18
3.1.4.	Minierat e braktisura	19
3.1.5.	Fazat e një Projekti Minerar	20
3.2.	Industria e Naftës dhe Gazit	22
3.2.1.	Kërkimi	22
3.2.2.	Zhvillimi	22
3.2.3.	Prodhimi	23
3.2.4.	Braktisja	23
3.3.	Thyerja hidraulike (fraktimi): përvoja e Mbretërisë së Bashkuar	23
4.	Kuadri Ligjor dhe Rregullator	26
4.1.	Legjislacioni Kombëtar Sektorial	26
4.2.	Direktivat dhe Standardet Ndërkombëtare Mjedisore	31
4.2.1.	Konteksti Raportues Mjedisor Ndërkombëtar	31
4.2.2.	Raportimi Mjedisor në kuadrin e EITI	31
4.2.3.	Kuadri Mjedisor dhe Social i Bankës Botërore (KMS)	32
4.2.4.	Standardet e Performancës së KNF/ IFC	33
4.3.	VNM dhe Lëshimi i Lejeve	34
4.3.1.	Kuadri Ligjor Kombëtar mbi Mjedisin	34
4.3.2.	Praktikat ndërkombëtare	39
4.3.3.	Praktikat Kombëtare për VNM/lejet mjedisore të industrive nxjerrëse	40
4.3.4.	Detyrimet mjedisore dhe rehabilitimit sipas kontratës/lejes/ligjit	44
4.3.5.	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet Ligjore	47
4.3.6.	Konkluzione dhe rekomandime	58
5.	Hulumtim bazuar në të Dhëna Ekzistuese - Ndikimet në Mjedis të Industrive Nxjerrëse	60

5.1. Ndikimet në Biodiversitet	60
5.2. Ndikimet në Gjeologji, Cilësinë e Tokës, Përdorimin e Tokës dhe Peizazhin	60
5.3. Ndikimet në Cilësinë e Ajrit	61
5.4. Ndikimet në Ujërat Sipërfaqësorë dhe Ujërat Nëntokësorë	62
5.5. Ndikimet nga Gjenerimi i Zhurmave dhe Dridhjeve/ Vibrimeve.....	63
5.6. Ndikimet nga Gjenerimi i Mbetjeve	64
5.7. Ndikimet në Infrastrukturë dhe Trafik.....	65
5.8. Ndikimet në Komunitetin Lokal	66
5.9. Rastet e Mospërputhjes së Industrive Nxjerrëse në Shqipëri	66
6. Rasti Studimor 1 - Albchrome	67
6.1. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit.....	67
6.2. Përshkrimi i kontratës, lejeve, licencave të marra.....	67
6.2.1. Marrëveshja e Konçesionit.....	67
6.2.2. Leja Mjedisore	68
6.3. Ndikimet kryesore mjedisore, sociale dhe kumulative	69
6.4. Masat zbutëse dhe monitoruese	70
6.5. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore	70
7. Rasti Studimor 2 - Antea Cement	72
7.1. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit.....	72
7.2. Përshkrimi i kontratës, lejeve, licencave të marra.....	72
7.2.1. Lejet minerare	72
7.2.2. Lejet Mjedisore	73
7.3. Ndikimet kryesore mjedisore, sociale dhe kumulative	74
7.4. Masat zbutëse dhe monitoruese	75
7.5. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore	76
8. Referencat	77
9. Shtojcat.....	80
9.1. Shtojca A - Foto nga zona e projektit, Albchrome.....	80
9.2. Shtojca B- Foto nga zona e projektit, Antea Cement.....	81
9.3. Shtojca C - Termat e Referencës së Projektit.....	82
9.4. Shtojca D - Format i raportimit i të dhënave mjedisore, EITI.....	85
9.4.1. Hyrje	85
9.4.2. Të dhënat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)	86
9.4.3. Monitorimi dhe Vlerësimi i Mjedisit (MVM) - Të dhënat pas fillimit.....	87
9.4.4. Të dhëna mbi Menaxhimin e Katastrofës Mjedisore	88

Figurat

Figura 1. Ilustrimi skematik i punimeve në minerare të hapura	17
Figura 2. Ilustrimi i një zone guroreje.....	17
Figura 3. Foto ilustruese e punimeve minerare nëntokësore.....	18
Figura 4. Ilustrimi skematik i punimeve minerare me tretësirë në vendgërmim	19
Figura 5. Jetëgjatësia e një miniere.....	20
Figura 6. Proceset kryesore të fraktimit	24
Figura 7. Standardet Mjedisore dhe Sociale.....	33
Figura 8. Procesi i VNM.....	40
Figura 9. Vendndodhja e zonës minerare të operuar nga Albchrome	67
Figura 10. Vendndodhja e gurores “Boka e Kuqe”, Antea Cement.....	72

Tabelat

Tabela 1. Lejet e shfrytëzimit minierar për minerale metalore sipas Bashkive	12
Tabela 2. Lejet e shfrytëzimit minierar për mineralet jo-metalore sipas Bashkive	12
Tabela 3. Kompanitë që zotërojnë MNP me Albpetrolin	14
Tabela 4. Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në legjislacionin kombëtar mjedisor, dhe praktikën e monitorimit për industrinë nxjerrëse, dhe kërkesat / aplikimet në bazë të legjislacioneve ndërkombëtare, standardeve dhe udhëzimeve.....	47
Tabela 5. Përmbledhje e ndikimeve të mundshme të adresuara në raportin paraprak të VNM-së	69
Tabela 6. Përmbledhje e ndikimeve të mundshme të adresuara në raportin paraprak të VNM-së	74

Shkurtime

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ANG	Autoriteti i Naftës dhe Gazit
BE	Bashkimi Evropian
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
EITI	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
GNP/ MSG	Grup Ndërinstitucional i Punës
KMS	Kuadri Mjedisor dhe Social
KNF/ IFC	Korporata Ndërkombëtare e Financimit
MB	Mbretëria e Bashkuar

MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MNP	Marrëveshje për Ndarje Prodhimi
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NGR/ GRI	Nisma Globale e Raportimit
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
ONS/ ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SHSM	Shëndeti, Siguria dhe Mjedi
TAP	Gazsjellësi Trans Adriatik
TOR	Termat e Referencës
UAKM	Ujërat Acide të Kullimit të Minierës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1. Hyrje

1.1. Qëllimi i Studimit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përpilimi i një Studimi për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor të industrive nxjerrëse në Shqipëri dhe ndërlikimet që lidhen me veprimtaritë e tyre pranë komuniteteve ku veprojnë kompanitë nxjerrëse. Ky raport është përgatitur për EITI Shqipëri e cila parashtrohet raportimin e ndikimit mjedisor për të përmbushur kërkesat e Standardit EITI 2019.

Në përmbushje të këtij objekti të përgjithshëm, Konsulentët kanë:

- Analizuar ndikimin aktual dhe ndikimin e mundshëm në të ardhmen të kompanive nxjerrëse, duke përfshirë ndikimet në tokë, ajër, ujë (si ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë), zhurmat, dridhjet/ vibrimet dhe florën dhe faunën;
- Identifikuar detyrimet e kompanive nxjerrëse për të vlerësuar, administruar dhe zbutur ndikimin mjedisor sipas legjislacionit shqiptar, rregulloret dhe kushteve të lejeve minerare, licencave dhe kontratave të hidrokarbureve, si dhe kritereve ndërkombëtare përkatëse;
- Kryer një analizë të mangësive/ mospërputhjeve midis detyrimeve që mbartin kompanitë nxjerrëse sipas legjislacionit kombëtar/ lejes dhe zbatimit konkret në lidhje me vlerësimin, administrimin dhe zbutjen e ndikimeve mjedisore;
- Paraqitur dy raste studimore në lidhje me minierat për të ilustruar ndikimin mjedisor të aktiviteteve të tyre, kërkesat për kontroll dhe përmbushjen detyrimeve sipas lejeve mjedisore;
- Paraqitur gjetjet dhe rekomandimet në një mbledhje pune (workshop) të organizuar nga EITI Shqipëri me pjesëmarrjen e GNP / MSG dhe palëve të tjera të interesuara për Studimin; dhe,
- Paraqitur gjetjet dhe rekomandimet tek GNP/ MSG, Sekretariati Kombëtar i EITI në Shqipëri dhe tek palët e tjera të interesuara të përfshirë në proces.

Sfera e veprimtarisë së projektit mbulon industrinë dhe kompanitë që janë pjesë e objektit të raportimit të EITI. Këto janë kompani të përfshira në:

- Kërkimin e naftës, gazit dhe mineraleve; dhe,
- Nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve.

Siç vërehet në objektivat e mësipërme, fusha e veprimtarisë së projektit mbulon dhe ndikimin e këtyre aktiviteteve në burimet tokësore, ujë, ajër, zhurmë dhe florën dhe faunën.

Duke pasur parasysh ndikimet e rëndësishme të gurore në mjedis, Konsulenti i ka kushtuar vëmendje të veçantë aktiviteteve të mbajtësve të lejeve për nxjerrjen e mineraleve të ndërtimit.

Bazuar në termat e referencës (bashkëlidhur si Shtojca C) dhe kërkesat e EITI Shqipëri, sipas qëllimit të kësaj detyre, Konsulentët kanë përfshirë në fushën e punës së tyre vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të industrisë së përpunimit të mineraleve, duke u përqendruar tek fabrikat e pasurimit të bakrit dhe kromit.

Për sa i përket industrisë së nxjerrjes së naftës, fokusi kryesor është në vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore që vijnë si rrjedhojë e përdorimit të teknologjisë së thyerjes hidraulike në nxjerrjen e naftës.

Sa i përket periudhës kohore, projekti ka marrë në konsideratë legjislacionin mjedisor, rregulloret dhe kriteret në fuqi deri më 20 Gusht 2020. Projekti ka kryer një vlerësim të përgjithshëm të ndikimeve.

Kohëzgjatja dhe qëllimi i projektit nuk lejojnë për një vlerësim të hollësishëm të ndikimeve të çdo aktiviteti të veçantë nxjerrës në sektorët e minierave, naftës dhe gazit.

Dy rastet studimore u përzgjedhën mbi të dhënat dhe sugjerimet e Sekretariatit të EITI. Të dy rastet janë kompani private që veprojnë brenda sektorit të industrisë nxjerrëse; Albchrome vepron në miniera nëntokësore për nxjerrjen e mineralit të kromit dhe Antea Cement vepron në miniera sipërfaqësore (gurore të gurit gëlqeror) për nxjerrjen e lëndës së parë që përdoret në prodhimin e çimentos.

2. Përshkrim i Industrive Nxjerrëse në Shqipëri

Shqipëria është e pasur me burime minerale dhe industritë nxjerrëse kanë një rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit. Përbërja kryesore gjeologjike e Shqipërisë (Albanidet) ka mundësuar një shpërndarje të gjerë dhe të larmishme të mineraleve në të gjithë territorin e vendit. Depozitat kryesore të mineraleve të metalit gjenden në zonat e brendshme tektonike ndërsa depozitat e naftës gjenden në zonat e jashtme tektonike. Duke qenë e pasur me minerale, industritë e shfrytëzimit të mineraleve, naftës dhe gazit kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin ekonomik të vendit. Në vitin 2016, industritë nxjerrëse u llogaritën në 6% të PBB-së dhe kontribuan 805 milionë dollar të ardhura në buxhetin e shtetit (5% e të ardhurave të përgjithshme)¹.

Në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i këtyre industrive, është e rëndësishme që politikat e zhvillimit në këto industri duhen të marrin në konsideratë ruajtjen e të drejtës së brezave të ndryshëm të shqiptarëve për të përfituar nga këto burime natyrore. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Shqipërisë (Neni 59/1) përcakton se "Shteti, në përputhje me të drejtat kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon të përmbushë nismën dhe përgjegjësinë private për:

- një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- shfrytëzimin e arsyeshëm të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

2.1. Sektori Minerar

Inventari i mineraleve në Shqipëri përfshin metale me ngjyra dhe metale (kromi, bakër, zink, hekur-nikel, nikel-silikat, sulfite nikeli, boksitë, titano-magnetikë, metale të çmuar, etj.), minerale industriale (olivenite, dolomite, argjila, magnezite, gips, fosforitet, qelqi vullkanik, gurë dekorativë, bazaltë, kuarcite, rërë kuarciti etj.), qymyr, torfe dhe materiale ndërtimore.

Zhvillimi i industrive të tjera varet shumë nga shfrytëzimi i minierave, të cilat mbështesin veprimtari të mëtejshme në këto industri, të tilla si ato të çimentos, prodhimit të materialeve të ndërtimit, industrinë metalurgjike, industrinë kimike, si dhe shumë të tjera. Në tregun e brendshëm, kërkesa për gips, argjilë dhe materiale çimentoje është disa qindra milion dollarë dhe ky treg varet nga mineralet e importuara, kështu, Shqipëria jo vetëm që ka mundësi të furnizojë tregun e brendshëm me këto materiale, por mund të shndërrohet në një burim të rëndësishëm eksporti për rajonin, BE-në dhe më gjerë.

Shfrytëzimi i minierave është një burim kryesor punësimi kryesisht në zonat rurale, ku ky aktivitet përpara 1990-ës punësonte rreth 50% të fuqisë punëtore. Megjithatë shkalla e punësimit në industrinë minerare aktualisht nuk është e lartë, kjo industri kontribuon ndjeshëm në ruajtjen e një baze të kualifikuar rurale dhe është një faktor kryesor për një ekonomi rurale të strukturuar mirë. Sipas të dhënave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, aktualisht me shumë se 7,000 punonjës janë të punësuar në këtë industri, edhe pse mundësitë janë për një numër shumë më të lartë duke fuqizuar veprimtarinë e përpunimit të mineraleve si një vlerë e shtuar për industrinë minerare. Për më tepër, fuqizimi i industrisë minerare do të shkurajojë edhe më shumë migrimin drejt zonave urbane dhe do të inkurajojë zhvillimin e zonave rurale duke përfshirë një larmi më të madhe të industrive. Eksportet e mineraleve dhe prodhimeve minerale janë një mundësi të rëndësishme ekonomike për Shqipërinë. Megjithatë niveli i tanishëm i prodhimit të mineraleve nënkupton se nivelet e eksportit janë të ulëta, prirja drejt përpunimit mund të nxitet në mënyrë që të rritet vlera në treg e prodhimeve.

¹ Të dhënat e marra prej Raportit EITI në Shqipëri 2016

Sektori minerar në Shqipëri ka kaluar nëpër tre faza:

Deri në 1944

Faza e parë, e cila përfshin periudhën përpara Luftës së Dytë Botërore, ku u shënjua nga dy ngjarje të rëndësishme në industrinë minerare. Në 1922 u prodhuan harta e parë gjeologjike e Shqipërisë; e para e këtij lloji në Ballkan, dhe në 1929 u miratua një ligj për shfrytëzimin e minierave, i cili i hap rrugën kërkimit dhe shfrytëzimit të burimeve minerare.

1944-1994

Faza e dytë shënjon periudhën kur aktiviteti minerar u organizua në ndërmarrje shtetërore dhe u konsiderua si një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik të vendit. Zhvillimi i minierave dhe industrive të lidhura me to u bazua mbi politikën e një ekonomie të centralizuar shtetërore. Kromi, bakri, qymyri, hekur-nikeli, argjila, guri gëlqeror, dhe disa minerale të tjera u futën për herë të parë si pjesë e këtij planifikimi të centralizuar, në mbështetje të eksportit dhe nevojave për punësim.

Që prej viti 1994

Faza e tretë ishte periudha prej 1994-ës, kur u përhap koncepti i pronësisë dhe i zhvillimit të aktivitetit minerar. Zhvillimi i sektorit kaloi nga modeli i centralizuar në atë të bazuar mbi konceptin e tregut të lirë. Në këtë periudhë, pronësia shtetërore dhe aktiviteti minerar u kaloi subjekteve private bazuar mbi blerjen e të drejtave të shfrytëzimit minerar, në formën e koncesioneve.

Periudha e tranzicionit, e cila e transformoi industrinë minerare, nga një element themelor i ekonomisë së centralizuar shtetërore, në një sektor tregu funksional për vendin, u realizua me miratimin e ligjit të parë të minierave të Shqipërisë të miratuar në shkurt 1994, ku shteti ruajti pronësinë e burimeve minerale ndërsa të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve ua kaloi subjekteve minerare.

Industria minerare në Shqipëri ka qenë për shumë dekada në themel të rritjes industriale dhe lidhjeve ekonomike, duke u bazuar në një burim themelor të bollshëm të kromit për të cilin ishte, deri në vitet 1980, një nga prodhuesit më të mëdhenj në botë, së bashku me mineralizimin e nikelit, hekurit dhe bakrit. Komplekset e mëdha industriale funksiononin si pjesë e një zinxhiri të integruar të vlerave nga minierat përmes përpunimit metalurgjik deri në fabrikimin e metaleve në rrjedhën e poshtme. Pas një zgjerimi të rregullt për tre dekada (1950-1980), industria e minierave përjetoi një rënie në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990.

Duke pranuar se një sektor minerar i rilindur do të shërbente si një industri kyçe dhe do të ishte në gjendje të nxiste zhvillimin ekonomik, qeveria shqiptare u përpoq të reformonte sektorin në mënyrë që të kthehej në një kontribuues madhor në makro-ekonomi, zhvillimin e komunitetit lokal dhe punësimin.

Për këto arsye, qeveria i dha industrisë minerare prioritet të lartë në zhvillimin ekonomik të vendit. Përgjatë tre dekadave të fundit, qeveria ka miratuar disa strategji dhe legjislacion sektorial për zhvillimin e sektorit minerar. Aktualisht aktivitetet në sektorin minerar rregullohen nga Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe bazohen në një strategji afatgjatë për këtë sektor që mbulon periudhën 2010-2025 të miratuar me një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 479, datë 29.06.2011.

Strategjia minerare 2010-2025 parashikon rritjen dinamike dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe të harmonizuar të industrisë minerare. Kjo do të përfshijë hartimin e politikave dhe strategjive që do të garantojnë përkrahjen e investimeve të brendshme dhe të huaja në këtë sektor, zbatimin e teknologjive të reja, rritjen e përpunimit të mineraleve në vend, konkurrencën, transparencën, profesionalizmin e institucioneve minerare përkrahë përforsimit dhe konsolidimit të kapitalit minerar. Ky vizion gjithashtu përfshin realizimin e mbikëqyrjes dhe monitorimin efektiv të aktiviteteve minerare, rritjen e gamës së produkteve minerale përmes futjes së mineraleve të reja si dhe promovimin dhe nxitjen e përpunimit të mineraleve për të rritur vlerën e tyre dhe punësimin në vend, respektimin e mjedisit dhe përkrahjen nga

komuniteti. Gjithashtu i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit minerar do të jetë koordinimi i politikave dhe programeve minerare me politikat minerare të BE-së dhe përputhja me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të industrisë si dhe integrimi i zhvillimeve të industrisë minerare me planet e përgjithshme të zhvillimit të qeverisë.

Në vitin 2019 në të gjithë territorin e Shqipërisë u raportuan 571 leje aktive shfrytëzimi minerar, 301 prej tyre ishin leje për shfrytëzimin e mineraleve metalore, ndërsa 270 leje ishin për shfrytëzimin e mineraleve jo-metalore dhe materialeve ndërtimore. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lëshoi 12 leje të reja minerare për shfrytëzimin e mineraleve metalore dhe 4 leje për shfrytëzimin e mineraleve jo-metalore dhe materialeve ndërtimore.

Aktivitetet minerare janë të përhapura në të gjithë vendin. 301 leje për shfrytëzimin minerar për minerale metalore janë shpërndarë në 20 bashki dhe 270 leje për shfrytëzimin e mineraleve jo-metalore dhe materialeve ndërtimore janë shpërndarë në 49 bashki.

Tabelat 1 dhe 2 më poshtë paraqesin numrin e lejeve për mineralet metalore dhe jo-metalore për çdo bashki.²

Tabela 1. Lejet e shfrytëzimit minerar për minerale metalore sipas Bashkive

Nr.	Bashkia	Nr. i lejeve	Nr.	Bashkia	Nr. i lejeve
1.	Bulqizë	126	9.	Lezhë + Kurbin + Mirditë	9
2.	Dibër	5	10.	Librazhdi	7
3.	Elbasan	2	11.	Mat	5
4.	Fushë-Arrëz	8	12.	Pogradec	14
5.	Has	17	13.	Prrenjas	16
6.	Klos	23	14.	Pukë + Vau i Dejës	3
7.	Korçë + Devoll + Maliq	5	15.	Tropojë	32
8.	Kukës	29			
Totali i Lejeve					301

Tabela 2. Lejet e shfrytëzimit minerar për mineralet jo-metalore sipas Bashkive

Nr.	Bashkia	Nr. i Lejeve	Nr.	Bashkia	Nr. i Lejeve
1	Berat	7	26	Malësi e Madhe	1
2	Belsh	4	27	Maliq	7
3	Bulqizë	1	28	Mallakastër	3
4	Cërrik	3	29	Mat	6
5	Devoll	2	30	Memaliaj	1
6	Dibër	1	31	Mirditë	4
7	Dropull	5	32	Patos	3
8	Durrës	2	33	Përmet	5

² Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor për Monitorimin, 2019 i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Nr.	Bashkia	Nr. i Lejeve	Nr.	Bashkia	Nr. i Lejeve
9	Elbasan	9	34	Pogradec	7
10	Fier	6	35	Polican	3
11	Finiq	3	36	Prrenjas	5
12	Fushë-Arrëz	1	37	Pukë	2
13	Gjirokastrë	1	38	Rrogozhinë	2
14	Has	1	39	Sarandë	3
15	Himarë	9	40	Selenicë	20
16	Kavajë	5	41	Shijak	4
17	Kelcyrë	2	42	Shkodër	4
18	Klos	1	43	Skrapar	20
19	Kolonjë	3	44	Tepelenë	2
20	Korçë	8	45	Tiranë	9
21	Krujë	23	46	Tropojë	2
22	Kukës	3	47	Urë Vajgurore	22
23	Kurbin	8	48	Vau i Dejës	6
24	Lezhë	9	49	Vlorë	5
25	Librazhd	7			
Totali i Lejeve					270

Sipërfaqja e përgjithshme e licencuar për shfrytëzimin e mineraleve metalore është rreth 150 km ose 0.5% e territorit të përgjithshëm të Shqipërisë. Zona e hapur e prekur nga aktivitetet e shfrytëzimit të mineraleve metalore është vlerësuar të jetë rreth 4.1 km ose 0.014% e territorit të përgjithshëm të Shqipërisë.

Zona e përgjithshme e licencuar për shfrytëzimin e mineraleve jo-metalore dhe materialeve ndërtimore është rreth 89.2 km² ose 0.32% e territorit të përgjithshëm Shqipërisë, ndërsa zona e përgjithshme e prekur nga aktivitetet minerare për këto minerale është rreth 5.73 km² ose 0.02% e territorit të përgjithshëm Shqipërisë.

Aktivitetet e shfrytëzimit mineral në Shqipëri janë mbikëqyrur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e cila është një agjenci në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Përsa i përket aktivitetit të shfrytëzimit të mineraleve, aktualisht gjenden 9 leje për kërkim mineral. Të gjitha lejet janë lëshuar për kërkimin e kromit. Të gjitha lejet mbulojnë një zonë kërkimi prej 32.6 km², që është 0.117% e territorit të përgjithshëm të Shqipërisë.

Lejet për shfrytëzimin mineral janë lëshuar nga MIE, ndërsa mbikëqyrja e aktiviteteve shfrytëzuese e kryer nga përfituesit e lejeve është nën përgjegjësinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

2.2. Sektori i Naftës dhe Gazit

Sektori i naftës në Shqipëri është relativisht i vogël sipas standardeve ndërkombëtare, por historikisht ka qenë një kontribuues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që atëherë, fushat naftëmbajtëse janë zbuluar në zona tokësore dhe detare. Prodhimi i naftës bruto

në Shqipëri filloi në vitin 1929 me 750 ton naftë bruto. Pas Luftës së Dytë Botërore prodhimi pati një rritje të qëndrueshme dhe arriti kulmin e tij në vitin 1974 me një prodhim vjetor prej 2.25 milion tonë ekuivalent me 38,408 fuçi/ditë. Përgjatë viteve 1970-1980 Shqipëria zhvilloi një industri të përpunimit të naftës, e cila i mundësoi ekonomisë shqiptare të përpunonte naftën bruto dhe të prodhonte një numër nënproduktesh të naftës, të cilat i shërbyen nevojave të vendit. Që prej 1980, prodhimi ka pësuar një rënie të theksuar, kryesisht për shkak të mungesës së investimeve në kërkime. Në vitet 1980 prodhimi i naftës ra nën 1 milion ton në vit dhe nuk pati rritje deri më 2012 kur vendi regjistroi një rritje të prodhimit të naftës bruto.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë (2018-2030) rezervat e njohura të naftës vlerësohen afërsisht në 220 milion fuçi, ndërsa rezervat e gazit natyror vlerësohen afërsisht në 5.7 miliardë m³.

Albpetroli, kompania shtetërore e naftës zotëron fushat kryesore të naftës dhe gazit në vend. Gjithsesi, bazuar në legjislacionin vendas (Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)” i ndryshuar, shumica e prodhimit të naftës mbi të cilën Albpetroli ka të drejtën e prodhimit, është kontraktuar përmes Marrëveshjeve me Ndarje Prodhimi (MNP) tek një numër kompanish vendase dhe të huaja Aktualisht, shumica e prodhimit vendas të naftës bruto eksportohet për përpunim jashtë vendit. Aktualisht, nëntë MNP me kompaninë shtetërore të naftës Albpetrol për zhvillimin dhe prodhimin e fushave ekzistuese të naftës janë nënshkruar për shfrytëzimin e naftës dhe gazit.

Tabela 3. Kompanitë që zotërojnë MNP me Albpetrolin

Nr.	Rajoni	Kompania
1.	Patos-Marinza	Bankers Petroleum (2004)
2.	Ballsh-Hekal	Continental Oil and Gas (2016)
3.	Cakran-Mollaj, Gorisht-Koculit,	Albpetrol
4.	Delvina	Global Energy Management (2016)
5.	Kucova	Sherwood International Petroleum (2007)
6.	Visoka	Transoil Group (2009)
7.	Amonica	Albpetrol
8.	Drashovica, Finiq-Karne and Pekisht-Murriz	Phoenix Petroleum (2013)
9.	Divjakë, Ballaj-Kryevidh, Povelce, Panaja and Frakull	Phoenix Petroleum (2013)

Përveç kësaj, Shell Upstream Albania ka nënshkruar me Qeverinë dy Marrëveshje të Naftës për dy blloqe, Berat-Roskovec dhe Memaliaj-Tepelenë-Përmet, ku po kryejnë aktivitete të kërkimit të naftës dhe gazit.

Për shkak të investimeve të reja të kryera nga kompanitë private të naftës prodhimi i naftës së rëndë në Shqipëri është trefishuar përgjatë dekadës së fundit në 1.29 milion tonë në vitin 2015, me Bankers Petroleum (një kompani naftë e regjistruar në Kanada) që ndikon pothuajse të gjithë rritjen.

Sektori i naftës së përpunuar në Shqipëri përballlet me sfida të rëndësishme në të dy industritë, si atë nxjerrëse dhe atë përpunuese. Rezervat e pazbuluara të naftës dhe gazit në Shqipëri, së bashku, në det dhe në tokë, mendohet të jenë të konsiderueshme, por kërkimi i tyre do të kërkojë përdorimin e teknologjive të përparuara të cilat nuk zotërohen në vend. Rënia e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare që prej

2004-ës ka shkaktuar një rënie përkatësisht në prodhimin e naftës dhe investimin në sektor në 4-5 vitet e shkuara. Aktualisht, asnjë aktivitet i naftës nuk po kryhet në zonat detare, megjithëse në të shkuarën një numër i kompanive të rëndësishme ndërkombëtare të naftës kanë kryer aktivitete kërkimi në zonat detare por pa rezultate domethënëse.

Sektori i naftës dhe gazit po zhvillohet bazuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë të miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 480, datë 31.07.2018 Strategjia Sektoriale e Energjisë në Shqipëri është e harmonizuar përsa i përket qëllimeve, detajeve të sektorit të energjisë dhe afatit kohor me një numër dokumentesh të tjerë strategjikë dhe ligjorë që janë në fuqi. Plotësimi dhe pasurimi i këtyre dokumenteve ka krijuar një sinergji në përcaktimin e prioritetëve të politikave dhe programeve dhe në zhvillimin e rekomandimeve strategjike.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë disa nga përparësitë dhe veprimet në sektorin e naftës përfshijnë:

- Përmirësimin e administrimit të të drejtave ekzistuese të naftës të Kompanisë Shtetërore të Naftës (Albpetrol) dhe atyre që u janë dhënë kompanive të huaja për kërkime dhe prodhime të reja të naftës.
- Zhvillimin e rezervave të ardhshme të naftës përmes mbështetjes së investimeve private në mënyrë të përgjegjshme për mjedisin dhe financiarisht transparente, përfshirë detyrime të rrepta të vlerësimit dhe ndikimit në mjedis.
- Vazhdimin e monitorimit të aktiviteteve të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit për të siguruar zbatimin e rreptë të Planit të Masave Zbutëse dhe Menaxhimit Mjedisor për secilën kompani të naftës dhe gazit; dhe
- Marrjen e masave për grumbullimin emergjent të naftës bruto dhe nënproduktet e saj në përputhje me Direktivat e BE-së për produktet.

Sa i përket prodhimit të gazit natyror, aktualisht ka një prodhim të ulët të gazit natyror vendas. Pavarësisht prodhimit të ulët të gazit vendas, ndërtimi i gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) përgjatë Shqipërisë për të lidhur fushat e gazit të rajonit të Kaspikut me tregun evropian, ka krijuar një mundësi të rëndësishme për gazifikimin e ekonomisë shqiptare.

Duke pasur parasysh këto zhvillime, Qeveria e Shqipërisë themeloi Albgaz sh.a., një kompani në pronësi të plotë të shtetit, e krijuar në formën e një operatori të bashkuar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit. (VKM nr. 848, datë 07.12.2016). Albgaz sh.a. do të angazhohet në realizimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe për ndërlidhjen e Shqipërisë me rrjetet rajonale të gazit.

Sektori i gazit në Shqipëri do të përballë me sfida të rëndësishme sepse është një sektor tregtar që do të ndërtohet nga e para, por ka mundësinë të veprojë si një ndër sektorët më të rëndësishëm, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji të ekonomisë dhe popullatës.

Disa prej përparësitë dhe veprimet kryesore të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Energjisë për sektorin e gazit përfshijnë:

- Zhvillimin e planeve për krijimin e tregut shqiptar të gazit dhe integrimin e tij rajonal, dhe për marrjen, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjet me pakicë të gazit natyror nga TAP-i dhe burime të tjera të gazit përpara mbërritjes së parashikuar të gazit.
- Konsolidimin dhe forcimin e mëtejshëm të Albgaz sh.a., mbi rolin e operatorit të bashkuar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, si dhe për integrimin rajonal të rrjetit shqiptar të gazit.
- Zbatimin e reformave të tregut me qëllim përputhjen me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe acquis të BE-së, kushteve për t'u bërë shtet anëtar i BE-së.

3. Llojet e Projekteve të Industrisë Nxjerrëse

3.1. Industria Minerare

Shfrytëzimi minierar përfaqëson nxjerrjen e mineraleve të vlefshme ose materialeve të tjera gjeologjike nga toka. Guroret janë një lloj minierë e hapur nga e cila nxirren gurë ose minerale. Në industrinë e minierave, materialet përftohen nga mineralet përmes proceseve të ndryshme. Materialet e përfutuara zakonisht janë qymyr, bakër, diamante, hekur, ar, plumb, mangan, magnez, nikel, fosfat, platin, kripë, argjend, kallaj, titan, uran, zink, argjilë, rërë, zhir, zhavorr, granit dhe gur gëlqeror.

Zakonisht janë tre forma të nxjerrjes së mineraleve që përdoren në industrinë minerare: minierat sipërfaqësore (përfshirë minierat e hapura), minierat nëntokësore dhe punimet minerare të lëngshme (punimet minerare me tretësirë në vendgërmim).

3.1.1. Minierat Sipërfaqësore

Ka disa forma të ndryshme të punimeve minerare sipërfaqësore. Këto përdoren kur depozitat e mineraleve ose gurëve gjenden relativisht pranë sipërfaqes. Të gjitha përfshijnë heqjen e sasive të mëdha të gurëve/ shkëmbinjve që mund të ndikojnë gjeologjinë natyrore apo tokën në atë zonë. Gërmimi mund të përdorë makineri të rënda të tilla si ekskavatorë, traktor gërmues dhe kamionë të mëdhenj për të hequr/ transportuar gurët, si dhe mund të përfshijë metoda të shpërthimit të kontrolluar për të copëtuar shkëmbinjtë në fragmente më të vogla dhe të lehtësojë procesin nxjerrës. Metoda që përdoret në një minierë të caktuar është në varësi të materialit nxjerrës, gjeologjisë së vendgërmimit dhe faktorëve të tjerë që vlerësohen. Këtu kemi parasysh tre metoda kryesore.

Punimet minerare të një grope të hapur janë një mënyrë e nxjerrjes së gurit apo materialeve nga toka nga një gropë e hapur apo shpat. Kjo metodë përfshin shpërthimin dhe zhvendosjen e një sasive të madhe materiali, si dheu, gurë/ shkëmbinj apo bimësi që duhet hequr për të arritur tek mineralet. Karakteristikë e minierave të hapura janë gropat e mëdha të ngjashme me krateret me “breza” (tarraca të gjera), në mënyrë që xeheroret apo mineralet më të thella të mund të arrihen me makineri të rënda. Këto lloje minierash zakonisht përdoren për nxjerrjen e metaleve dhe qymyrit, si dhe për nxjerrjen e lëndëve të para kryesore si gur, rërë dhe zhavorr të përdorura në industrinë e ndërtimit (psh. rrugë). Minierat e hapura zakonisht zënë sipërfaqe të mëdha toke. Norma e nxjerrjes përgjithësisht është më e madhe se 20,000 tonë në ditë.

Punimet minerare të majave është një metodë ku e gjithë kodra ose mali (ose maja e tyre) hiqet përmes proceseve të minierave sipërfaqësore për të arritur tek mineralet (shpesh qymyr). Kjo metodë përfshin edhe shpërthimin, por sjell sfida të tjera mjedisore pasi shpërthimi mund të nevojitet të kryhet në një anë të ekspozuar të malit ndryshe nga fundi i një grope të hapur.

Punimet minerare me shirit janë një metodë e përdorur për nxjerrjen e mineraleve (zakonisht qymyr) të cilët ndodhen shumë pranë sipërfaqes dhe në një shtresë të cekët. Një shirit i gjatë shkëmbi hiqet duke përdorur një ekskavator të madh. Më pas minerali nxirret. Më pas punimet minerare kalojnë në një shirit paralel, me gurët sipërfaqësor që depozitohen në gropën e lënë nga grumbulli i parë i mineraleve të nxjerra. Ekskavatorët e mëdhenj zhvendosin rreth 100,000 deri në 200,000 tonë në ditë.




Figura 1. Ilustrimi skematik i punimeve në minerare të hapura

Burimi: <http://www.visualdictionaryonline.com/energy/geothermal-fossil-energy/coal-mine/open-pit-mine.php>



Figura 2. Ilustrimi i një zone gurorëje

Burimi: <https://pixabay.com/photos/quarry-mountain-earth-engineering-443255/>

3.1.2. Minierat Nëntokësore

Punimet minerare nëntokësore përfshijnë zhytjen e boshteve vertikal dhe tuneleve për të arritur depozitat e mineraleve që ndodhen shumë më poshtë sipërfaqes së Tokës. Këto boshte mund të penetrojnë shumë thellë në tokë ose anash në një anë mali. Zakonisht përdoren për nxjerrjen e metaleve të tilla si bakër, zink, hekur, krom, ar, etj. Minierat nëntokësore priten të jenë më të vogla përse i përket procesit të punës sesa minierat sipërfaqësore/ë hapura. Përgjithësisht, ato prodhojnë nga 20,000 në dhjetëra mijëra apo dhe

miliona tonë xeheror përgjatë gjithë jetës së minierës dhe mund të arrijnë deri në 3,000 m në thellësi në kushte të caktuara, në varësi të gjeologjisë dhe topografisë së terrenit. Në përgjithësi, në punimet minerare nëntokësore dëmtohet më pak tokë në krahasim me punimet minerare sipërfaqësore, gjithsesi kjo mund të ndryshojë nga një vendgërmim në tjetrin. Ndikimet mjedisore vlerësohen gjerësisht si më pak të serioze krahasuar me ato në sipërfaqe apo minierave të hapura, sidoqoftë burimet ujore nëntokësore zakonisht janë më të rrezikuara nga aktivitetet e shfrytëzimit të minierave nëntokësore.



Figura 3. Foto ilustruese e punimeve minerare nëntokësore

Burimi: <https://resourceglobalnetwork.com/tag/underground-mining/>

3.1.3. Minierat me Tretësi në Vendgërmim

Punimet minerare të lëngshme (miniera me shpëlarje / tretësi në vendgërmim) janë një metodë në të cilën mineralet nxirren nga injektimi i një tretësi në një depozitë xeherore. Tretësi minerale e përgatitur pompohet në sipërfaqe, ku minerali ose metali i nxjerr prej tretësisë nga procese të tilla si precipitimi, shkëmbimi i joneve dhe elektroliza. Në thelb, metoda e nxjerrjes përqendrohet në nxjerrjen e mineraleve përmes proceseve të ndryshme fiziko-kimike ku trupi i xeherorit lihet në vend sesa të copëtohet dhe zhvendoset. Në përgjithësi, në trupin e xeherorit shpohen një seri pusesh dhe një tretës qarkullohet nëpër formacion prej injektimit përmes puseve të caktuara dhe tërheqjes përmes të tjerëve. Megjithatë punimet minerare me tretësi në vendgërmim nuk përdoren zakonisht, ato janë përdorur në depozitat e uranit dhe bakrit në mjediset e përshtatshme hidrogeologjike. Megjithatë ky proces në vendgërmim shkakton pak dëme në sipërfaqe dhe nëntokë, ndikimi i tij në cilësinë e ujërave nëntokësore mund të jetë i rëndësishëm pasi përbërja kimike e ujit nëntokësor mund të ndryshojë në mënyrë drastike prej tretësit të injektuar dhe procesit të pompimit.




Figura 4. Ilustrimi skematik i punimeve minerare me tretësirë në vendgërmim

Burimi: <http://www.infinipipe.com/solution-mining.htm>

3.1.4. Minierat e braktisura

Zonat e minierave përgjithësisht konsiderohen të braktisura nëse nuk kryhen aktivitete të nxjerrjes, kërkimit apo zhvendosjes dhe nuk ka pronarë ose shfrytëzues të njohur për objektet. Si rezultat, minierat e braktisura mund përkufizohen si zona që nuk janë më në gjendje pune, nuk administrohen dhe/apo rehabilitohen më në mënyrë aktive, duke shkaktuar probleme të mëdha mjedisore dhe/ose sociale, dhe për të cilat askush nuk është më përgjegjës për riparimin dhe mirëmbajtjen e objektit.

Minierat e braktisura paraqesin shumë probleme fizike dhe mjedisore. Vendet me industri të zhvilluar më parë si Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja, Afrika e Jugut apo vende në Ballkanin Perëndimor ende përballen me një gamë të gjerë të problemeve mjedisore dhe sociale që vijnë si rezultat i këtyre zonave minerare të braktisura. Mes çështjeve të përbashkëta mjedisore që karakterizojnë zonat më të braktisura minerare përfshijnë peizazhin e ndryshuar, gropa dhe boshte të papërdorur, toka të papërdorshme për shkak të humbjes së dheut, nivele të larta të pH, zona me shpatë të pjerrëta, objekte të braktisura të hedhjes së mbetjeve minerare, ndryshime në regjimet e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, ndotje e dheut dhe ujore nga sedimentet, ndryshime në mbulimin me bimësi, zona të braktisura me tokë të ngjeshur dhe grumbuj të mbeturinave të qymyrit të djegur dhe të punimeve.³ Ndotja e burimeve ujore përfaqëson një nga çështjet më shqetësuese të minierave të braktisura. Ujërat kullues nga minierat e braktisura mund të përmbajnë përqendrime të rëndësishme/të larta të metaleve të rënda, lëndë të ngurta të tretura tërësisht, dhe mund të kenë temperatura të larta dhe pH të ndryshuar, në varësi të natyrës së trupit xeheror dhe kushteve gjeokimike vendore. Këto ujëra mund të kthehen në acidike me kalimin e kohës kur ekspozohen ndaj oksigjenit dhe, nëse janë të pranishme, pirite ose minerale të tjera sulfite. Këto ujëra acidike të pasur me metale mund të ndotin burime të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ujërat neutrale dhe alkaline

³ Një rishikim i problemeve dhe zgjidhjeve të minierave të braktisura në Afrikën e Jugut
https://www.researchgate.net/publication/276061220_A_review_of_problems_and_solutions_of_abandoned_mines_in_South_Africa

gjithashtu mund të përmbajnë metale që tejkalojnë standardet e cilësisë së ujit dhe të jenë një rrezik serioz për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

3.1.5. Fazat e një Projekti Minerar

Projektet minerare zakonisht përfshijnë pesë faza: kërkimi, fizibiliteti, zhvillimi (përgatitja për fillimin e aktiviteteve të prodhimit), shfrytëzimi (faza aktive e prodhimit), dhe çmontimi (mbyllja dhe rehabilitimi).




Figura 5. Jetëgjatësia e një miniere

Burimi: <http://www.engaged-consulting.com/mining-lifecycle.html>

Kërkimi

Faza e kërkimit fillon me mbledhjen e informacionit dhe njohurive përkatëse për vendndodhjen e mineralit, llojin dhe vlerën e mineralit si dhe shtrirjen e depozitimit të mineralit. Kjo fazë përfshin vlerësimin e përgjithshëm, studimin në terren, puset e shpimeve testuese, dhe gërmime të tjera kërkimore. Gjatë fazës së kërkimit mund të jenë të nevojshme operacione gjithëpërfshirëse dhe gërmime të thella të tokës, ndaj shpesh kërkohet një studim i veçantë i VNM-së para fillimit të aktiviteteve të kërkimit. Faza e kërkimit mund të zgjasë vetëm 2-4 vjet, por mund të zgjasë edhe në mbi një dekadë në raste më të ndërlikuara.

Fizibiliteti

Faza e fizibilitetit është ndoshta pjesa më e ndjeshme tregtare e procesit për kompaninë minerare. Lidhet me vlerësimin ekonomik të projektit për të marrë një vendim nëse do të përparohet ose jo me projektin. Gjithashtu përfshin të gjithë punën për të vlerësuar se si dhe në çfarë afati do të nxirren mineralet. Kjo fazë shpesh ndahet në:

- Parafizibilitet – Kjo fazë përfshin përgatitjen për studimin e fizibilitetit, i cili zakonisht do të japë një pasqyrë të nivelit të lartë të logjistikës, kostove dhe sfidave/rreziqeve kryesore, përfshirë vlerësime të plota mjedisore. Studimi ka për qëllim ti ofrojë kompanisë informacionin bazë i cili nevojitet për

të miratuar një projekt, apo të vendosë mes projekteve konkurruese në rast se ka fonde të kufizuara për investime. Një vlerësim paraprak/ parafizibilitet pozitiv do të çojë në një studim fizibiliteti.

- Fizibiliteti – Studimi i fizibilitetit është një raport shumë më i thelluar që mbulon tema të ngjashme me vlerësimin paraprak/ parafizibilitet. Theksi kryesor vendoset tek rreziqet dhe mundësitë ekonomike, dhe faktorë të tjerë të cilët mund të ndikojnë mbi atë ekuilibër, të tillë si faktorët socio-ekonomikë dhe rreziqet mjedisore.
- Analiza tregtare dhe socio-ekonomike – Duke u mbështetur në studimin e fizibilitetit, ky hap përfshin kompaninë që merr vendimin nëse projekti është tërheqës ekonomikisht duke pasur parasysh gjeologjinë, vendndodhjen, vlerën e mallit dhe shumë faktorë të tjerë.

Zhvillimi

Faza e zhvillimit përfshin aktivitete ndërtimi për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese apo ndërtimin e hyrjes së zonës së projektit. Aktivitetet e zakonshme gjatë kësaj faze mund të përfshijnë: përgatitjen e zonës, pastrimin e bimësisë, hapjen e rrugëve hyrëse, ndërtimin e objekteve të zonës së projektit (psh. zyrat, objektet e furnizimit me ujë, materialet dhe pajisjet e magazinimit, etj.), dhe instalimin e pajisjeve të mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë.

Në varësi të projektit, faza e zhvillimit mund të jetë relativisht e shkurtër. Megjithatë, gjithashtu mund të jetë pjesa më sfiduese dhe e kushtueshme e të gjithë procesit të punimeve minerare. Është e mundur që faza e zhvillimit të një miniere të madhe, në distancë të largët, të kushtojë 5 miliardë dollarë ose më shumë. Kjo mund të përfshijë projekte infrastrukturore në shkallë të gjerë për të mundësuar transportin e mineraleve nga vendi i minierës në një fabrikë përpunimi ose port.

Shfrytëzimi

Faza e shfrytëzimit përfaqëson fazën aktive në një projekt minerar ku mineralet nxirren dhe përdoren në përputhje me objektivin e projektit. Natyra e saktë e fazës së shfrytëzimit varet nga lloji i punimeve minerare që ndërmerren (shih paragrafin 3.1). Në punimet minerare sipërfaqësore shtresa (e dëmtuar) e djerrinës hiqet me përdorimin e makinerive të rënda si ekskavatorët, buldozerët dhe kamionët e shkarkimit. Në të njëjtën mënyrë hiqen, përpunohen (nëse duhet, në varësi të llojit të industrisë minerare) dhe përdoren me tej depozitat e xeherorit. Ndonjëherë faza e shfrytëzimit mund të përfshijë përdorimin e eksploziveve dhe veprimtari shpërthyesë për të lehtësuar procesin nxjerrës.

Në shumë projekte, aktivitetet e mëdha minerare mund të përfshijnë ripunimin e grumbullimit të mbetjeve (shpesh lëndë të ngurta të mbetjeve) dhe asgjësimin e djerrinës dhe mbetjeve shkëmbore. Këto materiale duhet të zhvendosen ose gërmohen për të lejuar hyrjen në depozitën e xeherorit. Ndonjëherë këto mbetje mund të jenë në sasi të mëdha dhe mund të përmbajnë nivele të rëndësishme të substancave toksike, ndaj studimi i VNM-së duhet të vlerësojë me kujdes mundësitë e administrimit të këtyre mbetjeve dhe ndikimet e lidhura me to. Zakonisht këto mbetje depozitohen në vendndodhje, megjithatë në disa vende mund të ketë kufizime specifike të asgjësimit të këtyre llojeve të mbetjeve dhe ndoshta detyrime për asgjësimin në zona të dedikuara të depozitimit ose landfille.

Veç kësaj, uji është një faktor i rëndësishëm në fazën e shfrytëzimit. Shpesh, do të duhet të hiqet ujë në sipërfaqe dhe nëntokë, dhe mund të përmbajë ndotës të dëmshëm.

Çmontimi

Faza e fundit e një projekti minerar është çmontimi ose faza e mbylljes/rehabilitimit. Mbyllja e një zone miniere duhet të parashikohet dhe planifikohet përpara përfundimit të veprimtarisë minerare. Objektivi kryesor i planit të mbylljes është të garantojë që zona e minierës të lihet në gjendje funksionale në lidhje me karakteristikat ekologjike, fizike dhe kimike, krahasuar me kushtet/gjendjen e para shfrytëzimit minerar.

Udhëzimet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira rekomandojnë që faza e mbylljes dhe rehabilitimit duhet të planifikohet shumë më përpara, të paktën 3-5 vjet përpara afatit të parashikuar të mbylljes. Por në disa raste, plani i mbylljes është një pjesë thelbësore e marrjes së licencës minerare në fillim të projektit.

Disa prej aktiviteteve që janë të rëndësishme për fazën e mbylljes dhe rehabilitimit mund të përfshijnë: shembjen e ndërtesave brenda zonës së projektit, mbylljen e gropave të hapura, ndërtimin e skarpatave dhe tarracave, sigurimin që kullimi i ujit dhe depozitat e mbetjeve të mos paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ri-gjellbërimin e zonës së prekur të projektit me bimësi vendase/ autoktone kur është e mundur dhe sigurimi i sinjalistikës së duhur për informimin e publikut apo parandalimin e hyrjes së publikut/ njerëzve në zonë.

3.2. Industria e Naftës dhe Gazit

Procesi për nxjerrjen e naftës dhe gazit katër etapa kryesore: kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe braktisja.

3.2.1. Kërkimi

Në këtë etapë, projektet përqendrohen në sigurimin e informacionit rreth pranisë dhe sasisë së burimeve të naftës dhe gazit në nëntokë. Informacioni sigurohet nëpërmjet dy metodave: sigurimi i të dhënave sizmike dhe shpimi i puseve për testim dhe vlerësim.

Sigurimi i të dhënave sizmike

Kjo ndodh nëpërmjet dërgimit të valëve zanore përmes shkëmbinjve nga sipërfaqja dhe kapjen e valëve zanore ndërsa kthehen pas. Ndërsa lloje të ndryshëm të shkëmbinjve thithin sasi të ndryshme valësh zanore, jehonat pasuese mund të interpretohen për të kuptuar llojin e shkëmbinjve dhe për të zbuluar praninë e hidrokarbureve. Për marrjen e të dhënave në tokë, rreshta të gjatë gjeofonësh vendosen mbi tokë dhe më pas kamionë të rëndë përdoren për të goditur tokën në mënyrë që të dërgojnë valë zanore përmes shkëmbinjve. Jehonat pasuese të kapura nga një kamionë monitorimi, regjistrohen dhe analizohen.

Për kërkimet në det, hidrofonët tërhiqen pas një anijeje vëzhguese, e cila dërgon valë zanore nën shtratin e detit. Jehonat pasuese të kapura, regjistrohen dhe analizohen. Informacioni sizmik i përfutur përgjatë mbledhjes së të dhënave, përdoret më pas për të marrë vendime se ku do të shpohen pusët e kërkimit.

Shpimi

Pusët në tokë kërkojnë pastrim të zonave të shpimit, ndërtimin e një platforme betoni dhe transportimin me kamionë të sondës së shpimit dhe pajisjeve shoqëruese në zonën e shpimit. Zona e shpimit kërkon furnizim me ujë. Ndërtimi i objekteve të përkohshme për depozitimin e mbetjeve të shpimit është gjithashtu një element i kërkuar i projektit. Në përfundim të ekspeditës shpuese (zakonisht disa javore), pjesa më e madhe e ndërtimeve dhe objekteve do të hiqen. Do të mbetet një hapësirë e vogël betoni dhe një kapak mbi pus.

Shpimi në det kërkon një sondë shpuese lundruese përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së ekspeditës. Të gjitha pajisjet do të jenë në sondën lundruese dhe mbetjet do të mbahen përkohësisht në sondë. Sonda do të lundrojë me anije nga një bazë bregdetare (zakonisht një zonë në një port ekzistues). Pas kryerjes së aktiviteteve të shpimit, sonda do të largohet dhe do të vendoset një kapak mbi pusin në fund të detit. Pas shpimit të pusit të parë të një ekspedite kërkimore për zbulimin e hidrokarbureve, mund të nevojitet të shpohen puse të tjerë për të vlerësuar ose konfirmuar sasinë e zbuluar.

3.2.2. Zhvillimi

Faza e zhvillimit të nxjerrjes së naftës dhe gazit përfshin shpimin e puseve dhe ndërtimin e pajisjeve shoqëruese për prodhimin e hidrokarbureve, tubacione për transportin e naftës dhe gazit dhe pajisje për përpunim. Mund të lind gjithashtu nevoja për ndërtimin e pajisjeve për eksportin e naftës ose gazit në treg.

Projektet e zhvillimit në tokë

Një projekt zhvillimi në tokë karakteristike të tij ka ndërtimin e vendeve të përhershëm të puseve për shpimin dhe funksionimin e puseve të prodhimit. Madhësia dhe ndikimi i secilës vendndodhje pusi do të jetë e ngjashme me shpimin kërkimor, por këto struktura do të qëndrojnë për shumë vite, ndoshta dekada. Ka shumë të ngjarë të ndërtohen të tjera objekte si pjesë e fazës së zhvillimit, përfshirë pajisje të kontrollit dhe monitorimit të puseve dhe tubacioneve për të lidhur çdo pus qoftë në një pikë qendrore grumbullimi ose në një tubacion për të dërguar hidrokarburet për përpunim. Objektet e përpunimit mund të vendosen pranë zonave të shpimit, por ka më shumë të ngjarë të jenë në një distancë të largët dhe më pranë tregut ose pajisjeve eksportuese. Nafta ose gazi mund të përshtaten të furnizojnë objektet ekzistuese të përpunimit apo eksportit ose mund të kërkojnë objekte të reja. Në rastin e objekteve ekzistuese, disa punime mund të jenë të nevojshme për të rritur kapacitetin ose rikonfiguruar objektet. Ky projekt do të jetë shumë më i vogël sesa ndërtimi i objekteve të reja. Një ndërtim i tillë ka të ngjarë të jetë një projekt i madh që kërkon një sipërfaqe të konsiderueshme toke dhe aktivitet ndërtimor disa mujor. Në varësi të zonës së zgjedhur, mund të këtë ndikime në industrinë, agrikulturën dhe komunitetet vendore përfshirë dhe zhvendosjen e banorëve.

Projektet e zhvillimit në det

Një projekt zhvillimi në det ka të ngjarë të këtë ndikim edhe në tokë. Megjithatë vendndodhjet e puseve do të jenë në shtratin e detit, hidrokarburet ka të ngjarë që të duhet të transportohen në tokë për përpunimin dhe më tej në treg. Edhe në det, shpimi i puseve do kërkojë sërish një sondë, por pajisjet e prodhimit, kontrollit dhe tubacioni mund të jenë të vendosura në shtratin e detit dhe të drejtohen në distancë nga toka. Në raste të tjera, një platformë prodhimi instalohet në sipërfaqe mbi zonën e puseve. Projektimi i saktë i objekteve do të varet nga thellësia e ujit dhe largësia nga bregu. Ashtu si në projektet në tokë, ndërtimi i çdo impianti përpunimi do të jetë një projekt i madh, me gjasë i vendosur pranë bregut.

Zakonisht, kompanitë e naftës dhe gazit do ta vlerësojnë fazën e zhvillimit të një fushe naftë dhe gazi si një projekt, përfshirë shpimin e puseve, instalimin e pajisjeve dhe ndërtimin e objekteve të përpunimit.

3.2.3. Prodhimi

Kjo është faza operationale e nxjerrjes së naftës dhe gazit. Kompanitë e naftës dhe gazit rrallë e përmendin këtë etapë si pjesë të një "projekti". Kjo fazë konsiston në vënien në punë të puseve dhe objekteve të tjera të instaluar përgjatë fazës së zhvillimit për të prodhuar naftë dhe gaz.

Edhe pse kjo fazë nuk është një "projekt" i veçantë, përgjatë kësaj faze mund të zbatohen disa projekte të tjerë. Për shembull, mund të nevojitet shpimi i puseve të tjerë për të ruajtur prodhimin apo të instalohen pajisje kompresimi për të ruajtur presionin në rezervat e naftës dhe gazit. Projekte të tjera të zbatuara në këtë fazë mund të përfshijnë skema të shtuara të nxjerrjes së naftës, këto përfshijnë injektimin e gazit natyror ose dioksidit të karbonit në rezervat e naftës për të ruajtur nivelin e prodhimit apo rritjen e jetëgjatësisë së fushës.

3.2.4. Braktisja

Kjo fazë vjen në fund të jetëgjatësisë së fushës së naftës apo gazit dhe përfshin çmontimin dhe heqjen e të gjitha pajisjeve në një mënyrë të sigurt dhe që zvogëlon ndikimin afatgjatë në mjedis. Zakonisht ekziston një detyrim ligjor ose kontraktual ndaj kompanive të naftës dhe gazit për të financuar fazën e braktisjes.

3.3. Thyerja hidraulike (fraktimi): përvoja e Mbretërisë së Bashkuar

Fraktimi është një term që përfshin një sërë teknikash të përdorura gjatë shpimit për naftë dhe gaz për të nxjerrë hidrokarburet. Këto teknika përfshijnë injektimin me presion të ujit dhe kimikateve në pus për të thyer (frakturuar) shkëmbinjtë dhe për të lejuar naftën dhe gazin të rrjedhin përmes tubit të shpimit në

sipërfaqe (Figura 6 poshtë). Këto teknika kanë shoqëruar kërkimin dhe prodhimin jo-konvencional të naftës dhe gazit të tilla si nafta argjilore dhe gazi i ngushtë ku teknikat e shpimit konvencional janë të paafta në nxjerrjen e burimeve. Këto teknika përdoren edhe në shpimin konvencional.




Figura 6. Proceset kryesore të fraktimit
Burimi: Njësia e Inteligjencës së Energjisë dhe Klimës

Teknika e fraktimit/thyerjes hidraulike ka tërhequr vëmendjen e publikut në dhjetë vitet e fundit si rezultat i një kërkimi dhe prodhimi jo-konvencional të përmasave të mëdha në SHBA dhe Australi. Komunitetet vendore në SHBA kanë fajësuar fraktimin për ndotjen e furnizimit me ujë dhe ndikime të tjera dëmtoese në mjedis, përfshirë tërmetet. Edhe pse fraktimi është përdorur që në vitet 1970, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, për të nxjerrë naftë dhe gaz si në det në Detin e Veriut dhe në tokë në territorin e Mbretërisë së Bashkuar.

Fraktimi është shoqëruar me diskutime në Mbretërinë e Bashkuar dhe është përballur me kundërshtime nga komunitetet vendore aktiviste të mjedisit dhe politikanë të të gjitha partive kryesore politike lidhur me aktivitetet e fraktimit kur ato kanë ndodhur apo janë propozuar. Partia Konservatore në pushtet e ka mbështetur teknikën e fraktimit që prej ardhjes në pushtet më 2010 dhe nxiti kompanitë ta përdornin këtë teknike për kërkimin e gazit, veçanërisht në veri të Anglisë. Qeveria kombëtare ndryshoi rregulloret për lëshimin e lejeve për fraktimin në 2015 pasi politikanët konservatorë vendor refuzuan aplikimin e saj në Anglinë veriore. Në Skoci dhe Uells ku rregulloret e çështjeve të energjisë janë përgjegjësi e qeverive të deleguara, u vendos një moratorium për fraktimin, duke parandaluar çdo veprimtari.

Lidhja mes fraktimit dhe tërmeteve ka shkaktuar shqetësim të veçantë në Mbretërinë e Bashkuar pasi Mbretëria e Bashkuar nuk është një zonë e pirur për tërmet dhe si e tillë nuk është mësuar të përballlet me aktivitet sismik. Në vitin 2011, shpimi i një prej puseve të parë në Anglinë veriore me teknikën e fraktimit me presion të lartë shkaktoi dy tërmete. Qeveria kërkoi të kryhej një studim shkencor i cili arriti në

përfundimin se rreziku i nxitjes së tërmeteve prej teknikes së fraktimit ishte i vogël, por rekomandoi disa ndryshime në rregullore si një masë paraprake. Mbështetja e qeverisë ndaj metodës së fraktimit hasi një tjetër pengesë në mars të vitit 2019 kur Gjykata e Lartë në Londër vendosi të shpallë të jashtëligjshme udhëzimet e saj pasi nuk parashikojnë ndikimin në ndryshimet klimatike.

Më 1 nëntor 2019, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar njoftoi një “ndalim” të metodës së fraktimit. Kjo pasoi vendimin e marrë në shtator të vitit 2019 për të pezulluar shpimin e një pusi në Anglinë veriore pas një sërë tërmetesh. Rregullatori i naftës dhe gazit në Mbretërinë e Bashkuar publikoi një studim shkencor i cili arriti në përfundimin se nuk ishte e mundur të parashikohej magnituda e tërmeteve që mund të shkaktonte fraktimi apo shkalla e dëmit të shkaktuar. “Ndalim” u raportua se mbulonte të gjithë aktivitetin me metodën e fraktimit, por nuk ishte i pakufizuar. Në të vërtetë, “ndalimi” i referohej vetëm teknikës së fraktimit me presion të lartë. Fraktimi me presion të ulët lejohet akoma dhe shpimet që përdorin këto teknika vazhdojnë në pjesë të tjera të Anglisë, veçanërisht në Anglinë jugore. Vëmendja politike si dhe faktorët mjedisore dhe të sigurisë duket se kanë ndikuar mbi vendimin e qeverisë. Njoftimi për “ndalimin” erdhi gjatë një fushate të zgjedhjeve të përgjithshme gjatë së cilës partia Konservatore synonte mbështetjen e votuesve në Anglinë veriore ku fraktimi nuk ishte popullor. Teknikat me presion të ulët përdoren në Anglinë jugore ku konservatorët gëzonin që më parë një mbështetje të fortë.

4. Kuadri Ligjor dhe Rregullator

4.1. Legjislacioni Kombëtar Sektorial

Duke parë rëndësinë e aktiviteteve në industrinë nxjerrëse, Shqipëria ka hartuar dhe miratuar legjislacion të posaçëm parësor dhe dytësor që rregullon sektorët minerar dhe të naftës. Më poshtë gjendet një përshkrim i shkurtër i legjislacionit parësor që rregullon sektorët minerar dhe të hidrokarbureve dhe që përputhet me qëllimin e këtij studimi.

Ligji nr 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çdo aktivitet në sektorin minerar rregullohet nëpërmjet ligjit nr 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe legjislacionit sekondar (Vendime të Këshillit të Ministrave, Urdhëra dhe Udhëzime të Ministrit përgjegjës për sektorin minerar) të nxjerra në funksion të zbatimit të këtij ligji.

Ky ligj përcakton rregullat për zbatimin e veprimtarive minerare dhe pas-minerare në Shqipëri me qëllim nxitjen e aktiviteteve minerare në vend përmes sigurimit të transparencës dhe konkurrencës së lirë në këto aktivitete, maksimizimit të përfitimeve publike nga veprimtaritë minerare dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik nga rreziqet minerare dhe mbetjet në industrinë minerare.

Ligji nr 10304 përputhet plotësisht me Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2006/21/EC të datës 15 Mars 2006 “Për administrimin e mbetjeve të industrive nxjerrëse”.

Neni 3 i ligjit përcakton që çdo mineral në formën e tij natyrore që gjendet në territorin Shqiptar është pasuri publike. Angazhimi i personave private vendas apo të huaj autorizohet nëpërmjet lejeve minerare, të cilat lëshohen sipas procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në ligj.

Veprimtaritë minerare zbatohen në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Veprimtaria minerare është një aktivitet me interes publik.
- Çdo vendim-marrje në fushën e veprimtarisë minerare behet në kushtet e transparencës dhe paraprihet nga konsultimet me bashkësitë vendore dhe opinioneve me shkrim të autoriteteve përkatëse vendore.
- Veprimtaria minerare duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të respektojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.
- E drejta minerare është një e drejtë e shquar dhe e pavarur nga të drejtat e pronësise mbi tokën.
- Institucionet shtetërore që kanë në pronësi apo administrojnë tokën e ndikuar/prekur nga një leje minerare mund të hyjnë në marrëveshje me subjektin që zotëron lejen minerare pa iu nënshtuar procedurave të konkurrencës.
- Mbajtësi i lejes minerare është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar ndaj palëve të treta gjatë zbatimit të veprimtarisë minerare.

Të gjitha veprimtaritë minerare zbatohen në përputhje me politikat afatgjata dhe afatmesme të sektorit minerar të cilat përfshijnë:

- a) Strategjinë e sektorit minerar;
- b) Planin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare;
- c) Planin vjetor minerar.

Strategjia e sektorit minerar është dokumenti kryesor që përcakton politikat, përparësitë zhvillimore, veprimet dhe programet për administrimin e burimeve minerare për një periudhë kohore 15 vjeçare në përputhje me objektivat e strategjisë së zhvillimit kombëtar. Siç u përmend më sipër, strategjia e tanishme

minerare 2010-2025 u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr 479 të datës 29.06.2011.

Plani i Veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është një plan tri vjeçar, i cili, ndër të tjera, përmban:

- a) Drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;
- b) Nxitjen e zonave minerare që do të krijohen nëpërmjet lejeve minerare;
- c) Nxitjen e zonave minerare që bazohen në hartën dixhitale minerare;
- d) Programin e veprimtarive kryesore të shfrytëzimit gjeologjik;
- e) Parashikimin e prodhimit të përgjithshme vjetor minerar në vend;
- f) Nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore në veprimtaritë minerare; dhe
- g) Rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e tij.

Plani i fundit i veprimit 3 vjeçar u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr 664, të datës 10.10.2019 për periudhën 2019-2021.

Në përputhje me planin e veprimit 3 vjeçar, Ministri përgjegjës për sektorin minerar miraton planin vjetor minerar, i cili përgatitet nga AKBN, pas konsultimeve me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, bujqësinë, pyjet, trashëgiminë kulturore, turizmin, mbrojtjen dhe autoritetet përkatëse lokale. Plani vjetor minerar, pas miratimit, botohet në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për sektorin minerar dhe në Gazetën Zyrtare.

Sipas Nenit 10 të ligjit, mineralet klasifikohen në katër grupe:

- a) Metale, jo-metale, minerale qymyore dhe bituminoze;
- b) Minerale ndërtimi;
- c) Minerale të çmuara dhe gjysmë të çmuara;
- d) Minerale radioaktive;

I njëjti Nen përcakton aktivitetet minerare që i nënshtrohen lejeve minerare, të cilat lëshohen nga organet kompetente. Këto veprimtari përfshijnë:

- a) Veprimtaritë zbuluese dhe kërkimore;
- b) Veprimtaritë shfrytëzuese;
- c) Kombinimin e këtyre dy veprimtarive (kërkimore dhe shfrytëzuese).

Lejet minerare lëshohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr 320 të datës 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave të konkurrencës dhe kriteret e afatit të shqyrtimit të kërkesave për përfundimin e lejeve minerare në zonat e konkurrencës" dhe ligjit nr 942 të datës 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura", i ndryshuar.

Ndërmjet kërkesave të tjera, çdo kërkues i lejes minerare duhet t'i paraqesë autoriteteve:

- Një plan rehabilitimi mjedisor në përputhje me kërkesat dhe rregullat e legjislationit për mbrojtjen e mjedisit dhe rregullat teknike minerare.
- Një plan për mbylljen e veprimtarisë minerare dhe një plan për administrimin e mbetjeve.

Ligji kërkon nga Këshilli i Ministrave të përcaktojë institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive të personave/shoqërive që zotërojnë lejet minerare. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr 232 të datës 23.03.2011, institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive zbuluese dhe eksploruese është Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), ndërsa mbikëqyrja dhe monitorimi i subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi është përgjegjësi e AKBN.

Ligji përcakton që entet të cilat zhvillojnë veprimtari kërkimore minerare janë të detyruara:

- a) Të raportojnë brenda një periudhe 10 ditore përpara strukturës përgjegjëse (SHGJSH) gjetjen e burimeve minerare me interes ekonomik në zonën e miratuar për eksplorim;
- b) Të përfundojnë programin minimal të punës të përcaktuar në projektimin e veprimtarisë minerare;

- c) Të mbajnë të dhëna të hollësishme të punimeve të kryera për kërkimin e mineraleve;
- d) Të marrin masat e nevojshme për të parandaluar dëme të mundshme ndaj mjedisit dhe pasurive të tjera;
- e) Të rehabilitojnë të gjitha demet ndaj terrenit gjatë veprimtarive kërkimore;
- f) T'i paraqesin, çdo tre muaj, informacion me shkrim institucionit përgjegjës për realizimin e investimeve, punëve minerare dhe operacionet për rehabilitimin e mjedisit në formatin e miratuar nga Ministri përgjegjës për industrinë minerare;
- g) T'i paraqesin institucionit përgjegjës çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga fundi i vitit, një raport financiar dhe teknik mbi të gjitha operacionet e kryera;
- h) T'i paraqesin institucionit përgjegjës çdo vit, jo më vonë se 30 ditë para fundit të vitit, një plan vjetor pune për vitin pasardhës në përputhje me kushtet e lejes. Përmbajtja e planit të punës duhet të përputhet me urdhëresat dhe udhëzimet e Ministrit përgjegjës për industrinë minerare;
- i) T'i paraqesin institucionit përgjegjës në përfundim të afatit të lejes një informacion të detajuar mbi investimin e kryer gjatë fazës së eksplorimit sipas një formati të miratuar nga Ministri përkatës;

Entet të cilat zhvillojnë veprimtari kërkimore minerare janë të detyruara:

- a) Të përfundojnë programin e investimit të parashikuar në planin vjetor minerar dhe në projektin e veprimtarisë minerare;
- b) T'i paraqesin institucionit përgjegjës (AKBN) çdo tre muaj, por jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës, informacion mbi prodhimin, investimin, vlerën e mineraleve të shitura, punët minerare të realizuara dhe operacionet e kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe administrimin e mbetjeve sipas kushteve të lejes minerare;
- c) T'i paraqesin institucionit përgjegjës çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga fundi i vitit, një raport financiar dhe teknik mbi të gjitha operacionet e kryera në përputhje me kushtet e kontratës. Raporti duhet të përgatitet sipas formatit të miratuar nga Ministri përgjegjës për sektorin minerar.

Ligji përcaktoi, për herë të parë, garancitë financiare që kërkohen nga Mbajtësit e lejeve për kryerjen e veprimtarive minerare. Neni 32 i ligjit përcakton dy lloje të garancive financiare:

- a) Një garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit për Mbajtësit e lejeve të eksplorimit dhe shfrytëzimit;
- b) Një garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës për mbajtësit e lejes së eksplorimit dhe një garanci financiare për programin e investimit për mbajtësit e lejes së shfrytëzimit.

Garancitë financiare përllogariten nga SHGJSH për veprimtaritë eksploruese dhe nga AKBN për veprimtaritë shfrytëzuese. Metodologjitë për përllogaritjen e garancive financiare u miratuan nga Këshilli i Ministrave (vendimi nr 440 i datës 16.06.2011). Garancia financiare kërkohet të vendoset në emër të Ministrisë përgjegjëse për sektorin minerar, e cila mund t'i ekzekutojë ato në rastet kur Mbajtësit e lejeve nuk i përmbahen kushteve specifike të lejes.

Ligji përmban klauzola specifike në lidhje me detyrimet e zotëruesve të lejeve për të rehabilituar zonën e lejes minerare. Neni 37 i ligjit parashikon:

- Një zotërues i lejes për çdo veprimtari minerare ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë minerare dhe në përfundim të saj, duhet të zbatojë planin e mbylljes së minierës, planin e rehabilitimit mjedisor dhe planin për administrimin e mbetjeve, si është miratuar nga institucioni përgjegjës.
- Rehabilitimi i zonës minerare kryhet në mënyrë progresive nga Mbajtësi i lejes apo nga një palë e tretë, e cila është kontraktuar prej tij, sipas afatit kohor dhe në përputhje me planin e mbylljes së minierës dhe planin e rehabilitimit mjedisor.

- Zbatimi i planeve përkatëse për mbylljen e minierës dhe rehabilitimin e mjedisit kontrollohet nga institucioni përgjegjës, i cili, pas inspektimeve, i raporton Ministrit përgjegjës për sektorin minerar. Rehabilitimi konsiderohet i përfunduar vetëm pas miratimit të raportit përfundimtar prej Ministrit. Pas miratimit, garancia financiare i kthehet Mbajtësittë lejes.
- Në rastet kur Mbajtësi i lejes braktis zonën minerare ose nuk përfundon planin e rehabilitimit mjedisor, rehabilitimi i zonës kryhet nga kompani të specializuara të cilat përzgjidhen nga institucioni përgjegjës ndërsa kostot përballohen nga fondet e garancisë financiare.

Ligji për Naftën (Kërkimi dhe Prodhimi) (Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993), i ndryshuar

Veprimtaritë në sektorin e hidrokarbureve rregullohen nga Ligji për Naftën (Kërkimi dhe Prodhimi) (Ligji nr 7746, datë 28.07.1993), i ndryshuar.

Neni 3 i ligjit përcakton që burimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në formën e tyre natyrale brenda territorit të Shqipërisë, duke përfshirë zonën detare, janë pasuri ekskluzive e shtetit Shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përgjegjëse për hidrokarburet dhe të gjitha këto burime do të përdoren për përfitimet e popullit Shqiptar.

Ligji përcakton gjithashtu që asnjë person nuk duhet të kërkojë, zhvillojë dhe prodhojë hidrokarbure në Shqipëri pa u autorizuar nga Ministria dhe sipas kushteve të një Marrëveshje për Naftën. Kërkimi dhe shfrytëzimi i hidrokarbureve mund të kryhet vetëm nga entitete me të cilat është nënshkruar një marrëveshje për hidrokarburet.

Ministria përgjegjëse për hidrokarburet mund të hyjë në një Marrëveshje për Naftën me çdo Person të cilin e autorizon për të kërkuar, zhvilluar dhe prodhuar hidrokarbure në zonën e Marrëveshjes, sipas kushteve të Marrëveshjes. Ministria mund, gjithashtu, të autorizojë kompaninë shtetërore të gazit dhe naftës, Albpetrol, nëpërmjet një licence për të lidhur një Marrëveshje për Naftën me një kompani private, me kusht që kjo e fundit të zotëroje burime financiare dhe aftësi teknike për të përmbushur detyrimet që rrjedhin sipas Marrëveshjes.

Marrëveshja për Naftën i jep Kontraktorit të drejtën për të kërkuar, zbuluar dhe shfrytëzuar hidrokarburet në zonë të përcaktuar. Afati normal për shfrytëzimin e aktivitetit është 5 vjeçar, por nëse Kontraktori paraqet argumentet e duhura, leja e shfrytëzimit mund të shtyhet deri në 7 vjet. Afati maksimal i shfrytëzimit është 25 vjet.

Ligji përcakton gjithashtu që Marrëveshja për Naftën mund të përmbajë klauzola që i garantojnë Kontraktorit një regjim fiskal fiks (klauzola e stabilitetit) me kushtet e mëposhtme:

- Këto klauzola nuk mund të zbatohen për një afat me të gjatë se 12 vjet nga data e fillimit të prodhimit të hidrokarbureve;
- Klauzolat e stabilitetit nuk mund të zbatohen për ligje dhe rregullore që lidhen me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, mbrojtjen e jetëve njerëzore si dhe traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Një Marrëveshje për Naftën duhet të përmbajë detyrimet e mëposhtme për Kontraktorin:

- Kryerjen e operacioneve të hidrokarbureve në përputhje me Ligjin për Naftën, klauzolat e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, rregulloret e miratuara sipas Ligjit për Naftën dhe praktikatat pozitive të industrisë së naftës;
- Raportimin para Ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet të zbulimit të hidrokarbureve në zonën e kontratës brenda disa ditësh;
- Përgatitjen dhe paraqitjen për aprovim para Ministrisë të planit për vlerësimin e zbulimit;

- Në rastin e një zbulimi tregtar, përgatitjen dhe paraqitjen para Ministrisë së planit të zhvillimit të zbulimit;
- Sigurimin e një shfrytëzimi efikas të burimeve të hidrokarbureve;
- Ruajtjen e mjedisit dhe mirëqenien e komunitetit që jeton në zonën e operacioneve të hidrokarbureve;
- Kompensimin e shtetit për çdo pretendim nga palët e treta që lidhen me plagosje, humbje apo dëmtime që vijnë si pasojë e operacioneve të kryera prej Kontraktorit apo nënkontraktoreve të tij;
- Dhënien përparësi të punësimit dhe kualifikimit të shtetasve Shqiptarë dhe shërbimeve e mallrave vendase në përputhje me kërkesat e përfshira në Planin e Zhvillimit me kusht që ato të jenë konkurruese në çmime dhe të krahasueshme në cilësi;

Ligji autorizon Ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të hartojë rregullore që lidhen me:

- a) Regjistrimin e Kontraktoreve;
- b) Formatet sipas së cilëve Kontraktori duhet të paraqesë raporte, të dhëna, informacione dhe mbajtje llogarish;
- c) Masat që kanë të bëjnë me ruajtjen e burimeve të naftës, sigurinë, shëndetin, mjedisin dhe parandalimin e rrjedhjeve, mbetjet, ndotjen dhe aksidentet;
- d) Ndarjen e hapësirave me potencial hidrokarburesh në zona dhe blloqe;
- e) Të drejtën për përdorimin e tokës private dhe publike për operacione hidrokarburesh;
- f) Çdo rregullore tjetër që mund të konsiderohet e nevojshme nga Ministria për rregullimin e veprimtarive të hidrokarbureve;

Pavarësisht se Ligji autorizon Ministrinë të hartojë dhe botojë Marrëveshje Model për Naftën, sipas praktikave të tanishme, nuk është hartuar apo botuar asnjë Marrëveshje Model për Naftën. Të gjitha Marrëveshjet për Naftën, të cilat janë nënshkruar deri tani, janë negociuar me secilin Kontraktor.

Ligji për Naftën (Neni 9) i referohet në mënyrë specifike Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Ligji i detyron të gjithë kontraktorët të kenë një Marrëveshje për Naftën, autoritetet e administrimit të taksave dhe doganave, si dhe autoritetet qendrore dhe vendore të raportojnë sipas standardeve të EITI dhe kërkon që legjislacioni sekondar të jetë në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga EITI. Ligji i kërkon gjithashtu Sekretariatit të EITI të publikojë të dhëna mbi industrinë e naftës sipas standardeve të EITI.

Ligji parashikon ngritjen e një agjencie shtetërore përgjegjëse për hidrokarburet, e cila është në varësi të Ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Roli i agjencisë shtetërore përgjegjëse për hidrokarburet mishërohet tek AKBN, e cila është në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM nr 547, datë 09.08.2006, i ndryshuar).

AKBN ka këto detyra në fushën e hidrokarbureve:

- a) Të zbatojë politikat qeveritare në fushën e hidrokarbureve;
- b) Të marrë pjesë në negocimin e Marrëveshjeve për Naftën në përputhje me klauzolat e rregulloreve përkatëse;
- c) Të përgatisë dokumentacionin dhe praktikën e nevojshme për dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve në përputhje me Ligjin për Naftën;
- d) Të mbikëqyrë veprimtaritë mbi hidrokarburet dhe monitorojë zbatimin e Marrëveshjeve për Naftën.

Ndërsa ligji për sektorin minerar përmban kërkesa specifike për hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar që shërben për të rregulluar sektorin minerar, Ligji për Naftën nuk përmban klauzola të detyrueshme për hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar. Përvoja e deritanishme ka dëshmuar që mbikëqyrja dhe ndjekja e aktiviteteve të Kontraktoreve në sektorin e naftës rregullohet nga klauzolat e Marrëveshjeve specifike për Naftën sepse legjislacioni parësor nuk përmban klauzola për rregullimin e tyre.

E njëjta çështje lidhet gjithashtu me garancitë financiare që i kërkojnë Kontraktorëve të Naftës për detyrimet dhe dëmet mjedisore. Shuma e garancive financiare për çdo detyrim apo dëm mjedisor është specifike për çdo Marrëveshje Hidrokarburesh.

4.2. Direktivat dhe Standardet Ndërkombëtare Mjedisore

4.2.1. Konteksti Raportues Mjedisor Ndërkombëtar

Raportimi mbi Çështjet mjedisore prej kompanive nxjerrëse dhe zotëruesve të lejeve është sofistikuar së tepërmi gjatë 20 viteve të fundit. Kompanitë ndërkombëtare minerare si dhe ato të naftës e gazit, normalisht, botojnë një informacion të gjerë mbi ndikimet në mjedis të veprimtarive të tyre. Ky informacion botohet çdo vit në raportin e qëndrueshmërisë të kompanisë apo në një dokument të ngjashëm. Informacioni përmban një përshkrim të strategjisë mjedisore të kompanisë, objektivat, performancën aktuale e cila matet kundrejt një game të gjerë parametrash ku përfshihen emetimet në ajër dhe ujë, efikasiteti i energjisë, administrimi i ujërave dhe mbetjeve, si dhe informacioni mbi planet e administrimit të incidenteve, si dhe masat për përmirësimin dhe rehabilitimin.

Një kombinim i kërkesave legjislative nga investitorë dhe aksionerë të ndryshëm ka nxitur sofistikimin në rritje të raportimit mjedisor prej kompanive nxjerrëse. Me rritjen e pritshmërive të aksionarëve rreth ndikimeve në mjedis të kompanive nxjerrëse, qeveritë dhe institucionet që përcaktojnë standardet kanë reaguar me vendosjen e kërkesave rregullatorë dhe standardeve të shtuara. Në nivel global, standardet kyçe përfshijnë ISO 14001, i cili është standardi mbi sistemet e menaxhimit mjedisor. Komunikimi dhe botimi i informacionit është një pjesë e rëndësishme e këtij standardi dhe kompanitë duhet të paraqesin dëshmi dhe fakte që ato po sigurojnë një komunikim të qartë për mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm. Kompanitë nxjerrëse përdorin raportet e qëndrueshmërisë për të treguar sesi po i përmbushin kërkesat e ISO 14001. Kompanitë nxjerrëse po përdorin gjithashtu dhe Nismën Globale të Raportimit (NGR/ GRI) si një kuadër për raportim, duke përfshirë këtu dhe çështjet mjedisore. NGR/ GRI siguron një standard për raportimin mbi një mori të gjerë çështjesh mjedisore ku përfshihen emetimet dhe administrimi i ujërave dhe mbetjeve. Për bankat që financojnë kompanitë nxjerrëse, Parimet e Ekuatorit përbejnë një kuadër për të vlerësuar rreziqet mjedisore dhe shoqërore në projektet që ato po financojnë nëpërmjet huave.

Si rezultat i këtij ekosistemi të gjerë raportimi mjedisor, aktualisht ekziston një informacion i konsiderueshëm nga kompanitë ndërkombëtare nxjerrëse mbi ndikimin dhe performancën e tyre në mjedis. Kërkesat e reja mbi raportimin mjedisor në kuadër të EITI (shih me poshtë) përcaktojnë që kompanitë të raportojnë një game të kufizuar informacioni, i cili përbën një nënkuadër informacioni që shumë kompani e botojnë tashmë. Një prej fushave ku EITI sjell risi është pagesa mjedisore tek qeveria. Këto informacione nuk raportohen normalisht nga kompanitë nxjerrëse dhe mund të përshihen në një raportim më të përgjithshëm financiar dhe kështu mund të veçohen prej sistemeve të raportimit financiar për të përmbushur Kërkesat e EITI.

4.2.2. Raportimi Mjedisor në kuadrin e EITI

Shqipëria ka mundësi të tregojë udhëheqje në raportimin mjedisor në kuadrin e EITI dhe të formësojë praktika pozitive në këtë drejtim. Kërkesat për të raportuar mbi çështjet mjedisore u prezantuan në versionin e vitit 2019 të Standardit. Versioni i Standardit 2019 paraqiti tri masa për raportimin mjedisor, një të detyrueshme dhe dy të tjera që nxiten, por janë vullnetare. Masa e detyrueshme përfshihet në Kërkesën 6.1.b dhe kërkon raportimin e të gjitha pagesave mjedisore për qeverinë, të cilat mandatohen prej ligjit, rregullores apo kontratës. Dy masat e tjera vullnetare përfshihen në Kërkesën 6.4 dhe janë:

1. Përshkrim i kërkesave ligjore dhe rregullatorë dhe praktikave të tanishme. Fushat e propozuara për raportim përfshijnë kërkesat që lidhen me detyrimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis, skemat e

çertifikimit, licencimin dhe të drejtat dhe rolin e agjencive qeveritare. EITI sugjeron gjithashtu raportimin mbi reformat e planifikuara apo ato në zbatim e sipër; dhe

2. Informacion mbi monitorimin mjedisor, sanksionet, detyrimet dhe programet e përmirësimit dhe rehabilitimit.

Në standardin e mëparshëm të vitit 2016, nuk ka pasur kërkesa të lidhura me mjedisin apo veprime të inkurajuar. Si pasojë, ka pasur pak raste të raportimeve mjedisore në raportet EITI për shkak se një pjesë e madhe e raporteve të tanishëm janë përgatitur sipas Standardit të 2016. Shumë vende të cilat zbatojnë standardet e EITI janë akoma në procesin e përgatitjes së raportit të tyre të parë sipas Standardit të 2016. Edhe aty ku raportohen, problemet mjedisore janë trajtuar ose si pjesë e përshkrimit të kuadrit ligjor për industrinë nxjerrëse ose ofrohen të dhëna të kufizuara mbi pagesat, aty ku ka pagesa të identifikueshme të taksave apo tarifave mjedisore. Për shembull, Ukraina, në raportin e saj të vitit 2017 ka përfshirë përputhjen e pagesave të taksave mjedisore, por nuk ka dhënë asnjë kontekst të ndikimit në mjedis. Armenia, në raportin e saj për periudhën 2016-2017, ka përfshirë të dhëna mbi nivelet e pagesave të ndryshme mjedisore, por nuk ka ofruar hollësi mbi pagesat faktike të kompanive.

Mongolia paraqet një shembull të praktikave pozitive në zbatimin e Kërkesave mjedisore të 2019. Raporti i saj për vitin 2018 përfshin një pjesë mbi ndikimin në mjedis dhe raporton mbi të gjithë elementet që përfshihen në Kërkesat 6.1.b dhe 6.4. Nigeria, në raportet e saj më të fundit, është përpjekur të zbatojë standardet mjedisore të 2019. Raportet e saj mbi naftën, gazin dhe mineralet e ngurta, që përfshijnë pagesat në vitin 2018 (raporti u përgatit në 2019 pas botimit të Standardit), japin të dhëna mbi të tri elementet e Kërkesave mjedisore. EITI në Nigeri përdori një format raportimi ku i kërkohej kompanive të jepnin të dhëna mbi VNM-të e kryera në vit, veprimtaritë e monitorimit mjedisor dhe pagesat e kryera, incidentet mjedisore (si derdhjet e naftës) bashkë me pagesat përkatëse për qeverinë dhe komunitetet. Një format i përditësuar është përdorur për të mbledhur të dhëna për raportin e vitit 2019.

Rekomandime

1. EITI në Shqipëri të krijojë një proces për mbledhjen, analizimin dhe botimin e të gjithë informacionit mjedisor që kërkohej nga klauzolat 6.1.b dhe 6.4 të Standardit EITI 2019, d.m.th informacionin e detyrueshëm dhe atë të rekomanduar.
2. EITI në Shqipëri t'a bazojë formatin e saj të raportimit për të dhënat mjedisore mbi modelin bashkëngjitur (Shtojca D).
3. EITI në Shqipëri të zhvillojë veprimtari ndërgjegjësimi me kompanitë dhe agjencitë qeveritare në kuadër të raportimit për të qartësuar kërkesat e raportimit mjedisor dhe informacioni që kërkohej për plotësimin e formatit të raportimit.
4. Aty ku është e mundur, EITI në Shqipëri duhet të shfrytëzojë informacionin mjedisor të botuar në faqet zyrtare.

4.2.3. Kuadri Mjedisor dhe Social i Bankës Botërore (KMS)

Prej datës 1 Tetor 2018, Banka Botërore po zbaton Kuadrin Mjedisor dhe Shoqëror (KMS) për të gjitha financimet e reja të projekteve KMS i Bankës Botërore përcakton angazhimin e BB për zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet një Politike të Bankës dhe një pakete Standardesh Mjedisore dhe Shoqërore, të cilat janë projektuar për të mbështetur projektet e Huamarrësve me synim dhënien fund të varfërisë dhe nxitjen e begatisë së përbashkët.

Dhjetë Standardet Mjedisore dhe Sociale përcaktojnë standardet që Huamarrësi dhe projekti duhet të përmbushin përgjatë të gjithë ciklit të projektit dhe tregohen në Figurën nr 7.

4.2.4. Standardet e Performancës së KNF/ IFC

KNF/ IFC zbaton Standarde Performance për të administruar ndikimet dhe rreziqet mjedisore dhe shoqërore dhe për të rritur mundësitë e zhvillimit në sektorin privat. Standardet e Performancës mund të zbatohen dhe nga institucione të tjera financiare të cilat vendosin t'i zbatojnë ato në tregjet e reja. Së bashku, tetë Standardet e Performancës përbejnë një paketë standardesh që duhet të përmbushë një projekt përgjatë ciklit të një investimi të KNF/ IFC apo ndonjë institucioni tjetër financiar. Bazuar në Standardet e Performancës mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale, të miratuar në 1 Janar 2012, ekzistojnë 8 Standarde Performance që tregohen në Figurën 7.



Figura 7. Standardet Mjedisore dhe Sociale

Burimi: <http://www.engaged-consulting.com/environment.html>

4.3. VNM dhe Lëshimi i Lejeve

4.3.1. Kuadri Ligjor Kombëtar mbi Mjedisin

Veprimtaritë e industrive nxjerrëse (minerale dhe hidrokarbure) mund të kenë ndikime madhore mbi mjedisin. Përmbushja e detyrimeve ligjore mjedisore duhet të jetë përparësi kryesore e kompanive nxjerrëse dhe agjencive përkatëse shtetërore.

Shqipëria ka hartuar dhe miratuar një kuadër të gjerë legjislacioni parësor dhe dytësor mbi mjedisin. Pavarësisht se ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri daton në vitin 1992, në dhjetëvjeçarin e fundit legjislacioni mjedisor ka pasur përparim të konsiderueshëm. Shqipëria ka miratuar një shumëllojshmëri të gjerë legjislacioni parësor mbi mjedisin, duke përfshirë ligje për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimin strategjik mjedisor, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet mjedisore, zonat e mbrojtura, mbrojtjen e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e integruar të ujërave dhe mbetjeve. Për më tepër, Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një sërë traktatesh ndërkombëtare, konventa dhe protokolle në lidhje me mbrojtjen e mjedisit duke i kthyer ato në pjesë të legjislacionit kombëtar.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër e ligjeve kryesore që kanë të bëjnë me qëllimin e këtij studimi.

Ligji 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe standardet për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel të lartë.

Ligji përputhet me Direktivën e BE 2004/35/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 21 Prill 2004 “Për përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi mjedisin”, i ndryshuar.

Parimet kryesore të politikave mjedisore që përcaktohen në këtë ligj përfshijnë:

- Parimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake;
- Parimin e ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimin e zëvendësimit dhe/apo kompensimit;
- Parimin e qasjes së integruar;
- Parimin e përgjegjësisë dhe bashkëpunimit reciprok;
- Parimin “Ndotësi paguan”;
- Parimin e të drejtës për informim dhe pjesëmarrjes së publikut;
- Parimin e nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit;

Ligji përcakton që politikat e mbrojtjes së mjedisit duhet të ndjekin një qasje të integruar për mbrojtjen e të gjithë elementeve të mjedisit duke përfshirë, ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe ndryshimin klimatik dhe duke pasur parasysh ndërveprimin ndërmjet tyre.

Neni 24 i këtij ligji përcakton që, për planet dhe programet në fushën e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjisë, industrisë, minierave, transportit, telekomunikacionit, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujërave, planifikimin e territorit, si dhe për planet dhe programet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe vendor kërkohet vlerësimi strategjik mjedisor.

Bazuar në këtë Nen, çdo plan apo program për zhvillimin e naftës, gazit dhe minierave duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi strategjik mjedisor. Procesi i vlerësimit strategjik mjedisor përcaktohet dhe rregullohet nga ligji nr 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili përshkruhet më poshtë.

Ky ligj autorizon Qeverinë të përcaktojë normativat për cilësinë e mjedisit dhe normat teknike për Emetimet në mjedis për çdo aktivitet ekonomik.

Sipas Nenit 44 të ligjit, të gjithë operatorët, që zhvillojnë veprimtari ekonomike, të cilat janë subjekt i lejeve mjedisore, janë të detyruar të monitorojnë emetimet nga veprimtaria e tyre në përputhje me klauzolat e ligjit për lejet mjedisore, si dhe kushtet e vetë lejes mjedisore.

Monitorimet mund të kryhen nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara në pronësi të vetë operatorit apo përmes një laboratorit të akredituar. Rezultatet e vetë-monitorimit i paraqiten autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin dhe kushtet e lejes mjedisore.

Bazuar në klauzolat e Nenit 44, të gjithë entitetet që kryejnë veprimtari në fushën e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve dhe mineraleve i nënshtrohen vetë-monitorimit mjedisor.

Ligji nr 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor përcakton institucionet, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM).

Ky ligj përputhet plotësisht me Direktivën e BE 2001/42/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 27 Qershor 2001 “Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve për mjedisin”.

Ky ligj përcakton procesin e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM) si përgatitje e një raporti të veçantë mbi ndikimet në mjedis të një plani apo programi, duke kryer konsultime me aktorë të ndryshëm dhe duke marrë parasysh rezultatet e raportit dhe konsultimeve në marrjen e vendimit përfundimtar për planin apo programin e caktuar.

Në përputhje me klauzolat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit (ligji nr 10431, datë 09.06.2011), në Nenin 2 të ligjit mbi VSM, industria energjetike dhe minerare përfshihen në listën e sektorëve që duhet t'i nënshtrohen VSM.

I njëjti Nen përcakton që lista e hollësishme e planeve dhe programeve, të cilit kanë ndikim negative mbi mjedisin dhe që i nënshtrohen VSM, duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mjedisit.

Sipas Nenit 7 të ligjit, fazat e procesit të VSM përbëhen nga:

- a) Njoftimi i Ministrisë së Mjedisit nga autoriteti propozues;
- b) Konsultimi me Aktorët e interesuar mbi çështjet që do të trajtohen në Raportin e VSM;
- c) Përgatitja e raportit konsultativ paraprak me aktorët e interesuar dhe publikun dhe përgatitjen e Raportit paraprak të VSM;
- d) Përgatitja e Raportit Përfundimtar të VSM;
- e) Shqyrtimi i propozimit dhe lëshimi i deklaratës nga Ministri i Mjedisit;
- f) Vendimi i autoritetit miratues;
- g) Monitorimi dhe raportimi i ndikimeve në mjedis të planit apo programit;

Sipas Nenit 10, përgatitja e raportit të VSM është përgjegjësi e autoritetit propozues dhe përgatitet nga një person fizik apo ligjor, i cili është çertifikuar prej Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në përputhje me kërkesat e Nenit 2 të këtij ligji, Këshilli i Ministrave, përmes vendimit nr. 507, datë 10.06.2015, ka miratuar një listë të hollësishme planesh dhe programesh që do t'i nënshtrohen miratimit të VSM sipas ligjit. Kjo listë përfshin:

- Strategjitë, planet, programet dhe dokumentet e tjera planifikuese që i nënshtrohen legjislacionit të sektorit minerar;
- Strategjitë, planet, programet dhe dokumentet e tjera planifikuese që i nënshtrohen legjislacionit të sektorit të hidrokarbureve (kërkimi dhe prodhimi);

Duke u bazuar për sa më sipër, të gjithë strategjitë dhe planet e hartuara për sektorin minerar dhe hidrokarbureve duhet t'i nënshtrohen miratimit të vlerësimit strategjik mjedisor sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Ligji nr 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar

Ligji mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) përcakton kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis të projekteve të propozuara, qofshin këto publike apo private.

Ky ligj përputhet plotësisht me Direktivën e BE 85/337/EEC të datës 27 Qershor 1985 “Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve për mjedisin”, i ndryshuar.

Ky ligj zbatohet mbi të gjithë projektet e propozuara, publike apo private, të cilat mund të kenë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, mbi mjedisin, për shkak të madhësisë së tyre, natyrës apo vendndodhjes. Sipas Nenit 4 të këtij ligji, kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti përfshijnë:

- Përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme/ mundshme të drejtpërdrejta apo të tërthorta në mjedis për zbatimin ose jo të një projekti.
- Ndikimet në mjedis të një projekti vlerësohen në lidhje me kushtet aktuale të vendit të prekur kur paraqitet raporti i VNM mbi projektin.
- VNM duhet të përfshijë përgatitjen, zbatimin dhe mbylljen e projektit dhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë dhe dekontaminimin/pastrimin dhe kthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse kjo kërkohet prej ligjit.
- Vlerësimi i projektit përfshin gjithashtu propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zvogëlimin, zbutjen dhe minimizimin e ndikimeve apo rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë vlerësimin e ndikimeve të pritshme të masave të propozuara.

Neni 7(2) i ligjit përcakton dy lloje të vlerësimit të ndikimit në mjedis:

- a) Procesi paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) Procesi i thelluar i vlerësimit të ndikimit në mjedis;

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis përfshijnë:

- Nxjerrjen e naftës dhe gazit për qëllime tregtare kur volumi i nxjerrë është më i lartë se 50 ton në ditë i naftës dhe 10000 m³ në ditë për gazin.
- Guroret dhe galeritë e hapura me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha ose zona për nxjerrjen e torfës me një sipërfaqe më të madhe se 1 ha.

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis përfshijnë:

- Projekte guroresh, galerish të hapura dhe nxjerrjes së torfës, të cilat nuk përfshihen në Shtojcën 1 të ligjit dhe që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis;
- Minierat nëntokësore;
- Nxjerrjen e mineraleve nga shtratet ujore dhe lumore;
- Shpimet e thella;

- Instalimet industriale sipërfaqësore për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror, mineraleve dhe rërës bituminoze;

Metodologjia kombëtare e procesit të VNM, duke përfshirë kërkesat për përgatitjen e raportit të VNM si dhe rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për kryerjen e procesit të VNM miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit.

Formati i përmbajtjes së raportit paraprak dhe të thelluar të VNM i bashkëngjiten këtij Raporti (shih paragrafin 4.3.3).

Aplikimi për miratim të VNM nga zhvilluesit e projektit paraqitet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (nëpërmjet portalit e-albania) dhe duhet të përfshijë:

- a) Për projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis (pjesë e Shtojcës II të ligjit):
 - i) Raportin paraprak të VNM të përgatitur nga një ekspert apo kompani e licencuar mjedisi sipas llojit të objektit/ projektit;
 - ii) Raportin/projektin teknik të veprimtarisë;
 - iii) Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, e cila është 30,000 LEK për raportin paraprak;
- b) Për projektet që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis (pjesë e Shtojcës I të ligjit):
 - i) Raportin e Ndërveprimit me Mjedisin – faza fillestare;
 - ii) Raportin e thelluar të VNM sipas llojit të projektit;
 - iii) Përmbledhjen jo-teknike të VNM;
 - iv) Raportin/projektin teknik të veprimtarisë;
 - v) Të dhëna mbi informimin dhe konsultimin publik;
 - vi) Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, e cila është 50,000 LEK për raportin e thelluar;

Në rastin e një VNM paraprake, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) shqyrton raportin dhe mund të vendosë që projekti i propozuar t'i nënshtrohet një VNM të thelluar nëse konstaton se projekti ka ndikim të konsiderueshëm mbi mjedisin. Nëse jo, AKM miraton raportin paraprak të VNM. Vendimi i dërgohet Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, e cila njofton zhvilluesin e projektit.

Në rastin e një procesi të thelluar të VNM, aplikimi kryhet nëpërmjet platformës e-Albania dhe i dërgohet MTM dhe më pas i përcillet AKM. AKM duhet të botojë raportin jo-teknik të VNM me qëllim që të marrë komente dhe vërejtje nga palët e interesuara dhe publiku i gjerë. Gjatë procesit të shqyrtimit të raportit të VNM, agjencia rajonale e mjedisit dhe institucionet e tjera përkatëse japin opinionet e tyre mbi raportin e VNM.

Një element kyç për procesin/procedurën e VNM së thelluar është kërkesa që AKM duhet të organizojnë dëgjesa publike të hapura për publikun e gjerë dhe OJF-të e mjedisit për të përfutur opinionin e tyre përpara marrjes së vendimit. Dëgjesat publike organizohen në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe zhvilluesin e projektit.

Në rastet kur AKM konstaton që raporti i VNM i plotëson kërkesat, AKM përgatit Deklaratën Mjedisore të projektit dhe ia dërgon Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit për miratimin përfundimtar dhe firmosje. Nëse Ministri nuk ka kundërshtime, ai/ajo firmos Deklaratën dhe ia përcjell atë zhvilluesit të projektit.

Ligji i kushton vëmendje të veçantë projekteve që mund të paraqesin ndikime në zonat e mbrojtura. Neni 21 i ligjit përcakton që kur AKM ose MTM arrijnë në konkluzion që projekti/veprimtaria e propozuar, e veçuar apo në bashkëpunim me veprimtari apo projekte të tjera ekzistuese apo të propozuara mund të kenë një ndikim të dukshëm/ qënësishëm negativ mbi integritetin e një zone të mbrojtur, autoriteti përgjegjës që mbulon zonën e projektit mund të mos e miratojë projektin vetëm nëse:

- a) Nuk ka zgjidhje të tjera alternative;
- b) Veprimtaria e propozuar duhet të zhvillohet për qëllimin e një interesi të rëndësishëm publik;
- c) Merren të gjithë masat e kompensimit me qëllim sigurimin e zbatimit të kërkesave të “Natura 2000”⁴

Ligji përmban gjithashtu dispozita që i mundësojnë zhvilluesit të projektit, i cili i nënshtrohet procesit të VNM, të paraqesë ankimim administrativ nëse ai/a jo konstaton që autoritetet nuk përmbushin procedurat ligjore.

Ligji nr 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar

Ligji për lejet e mjedisit përcakton:

- a) Rregullat për lejimin e zhvillimit të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit;
- b) Masat për parandalimin e ndotjeve dhe në rastet kur kjo nuk është e mundur, marrjen e masave për uljen e çlirimeve të gazeve, lëngjeve dhe lëndëve të ngurta në ajër, ujë dhe tokë.

Ky ligj përputhet plotësisht me Direktivën 2008/1/C të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 15 Janar 2008 “Për kontrollin e integruar dhe parandalimin e ndotjes”, i ndryshuar dhe Direktivën 2001/80/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 23 Tetor 2001 “Për kufizimin e çlirimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdhenj me djegie”.

Sipas ligjit, të gjitha veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen e mjedisit duhet të marrin një leje mjedisore. Ligji i ri prezanton dy lloje lejesh mjedisore, tipi A dhe B, në varësi të nivelit të llogaritur të ndotjes prej veprimtarisë.

Ligji kërkon që çdo veprimtari për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit, pavarësisht madhësisë së projektit, duhet të marrë leje mjedisore të tipit A, ndërsa veprimtaritë për nxjerrjen e mineraleve dhe materialeve të ndërtimit në miniera nëntokësore apo galeri të hapura duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit B.

Procedurat dhe kërkesat specifike për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore, transferimi i tyre nga një entitet tek tjetri, si dhe kushtet dhe afatet e lejeve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kërkesat për leje mjedisore paraqiten pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, që është dhe institucioni përgjegjës për lëshimin e lejeve.

Kërkesa për leje të tipit A duhet të përmbajë:

- a) Informacion mbi veprimtarinë e propozuar për të cilën kërkohet leja duke përfshirë:
 - Qëllimin e veprimtarisë dhe datën e pritshme për porositjen e instalimeve;
 - Përshkrimin e vendndodhjes ku do të zhvillohet veprimtaria, të shoqëruar me harta ilustruese dhe fotografi;
 - Përshkrimin e proceseve teknologjike të veprimtarisë;
 - Llojin, volumin, konsumin dhe prodhimin e lëndëve të para;
 - Informacionin e hollësishëm mbi Emetimet në mjedis;
 - Informacionin mbi cilësinë e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën ku do të ndodhin emetimet/ shkarkimet në mjedis;
 - Vendndodhjet me koordinata për zonat që do të preken nga emetimet në ajër dhe shkarkimet e ujërave të ndotura;

⁴ Natura 2000 është një rrjet i zonave kryesore të shumimit dhe pushimit për speciet e rralla dhe të kërcënuara të biodiversitetit, dhe disa lloje të rralla habitatesh natyrore të cilat mbrohen më vete. Ajo shtrihet në të 27 vendet e BE, si në tokë ashtu edhe në det.
https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

- Rreziqet/incidentet e mundshme në mjedis prej veprimtarisë dhe masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimin e dëmeve në mjedis;
- Masat për identifikimin dhe trajtimin e emetimeve në mjedis;
- Një program vetë-monitorimi të emetimeve në mjedis;
- Një plan rehabilitimi për veprimtaritë që përdorin burime minerare;
- Një plan emergjence të menaxhimit për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë apo depozitojnë materiale të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve;
- Vërtetim të ekspertit të mjedisit që ka përgatitur informacionin;
- Informacionin mbi konsultimin me publikun ku dokumentohet opinioni i publikut;
- b) Kopje e tarifës së shërbimit për kërkesën e miratuar nga Këshilli i Ministrave (tarifa e kërkesës për lejen e tipit A është 50,000 LEK, ndërsa për tipin B është 30,000 LEK).
- c) Leje dhe autorizime të tjera që mund t'i ketë marrë zhvilluesi i projektit për të njëjtën veprimtari.

Kërkesa për leje kontrollohet dhe verifikohet prej AKM, e cila i shpreh mendimin e saj Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nëse duhet të lëshohet apo jo leja. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos aktin e miratimit të Lejes Mjedisore.

Leja mjedisore përmban kushte mbi nivelin e emetimeve, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe kushte të tjera që mund të kenë lidhje me llojin e veprimtarisë si p.sh. grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, ose mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotura.

Një kërkesë e rëndësishme e lejes së mjedisit, që përputhet me dispozitat e ligjit, është detyrimi i mbajtësit të lejes të ndërmarrë veprimtari të rregullta monitoruese mbi mjedisin, si dhe të sigurojë raporte monitorimi për autoritetet e mjedisit (AKM, Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, Inspektoratin Shtetëror Mjedisor).

Ligji autorizon gjithashtu AKM të ndryshojë dhe modifikojë afatet dhe kushtet e lejes së mjedisit me qëllim përputhjen me ndryshimet në legjislacionin mjedisor.

Përmbushja e detyrimeve të lejes së mjedisit prej mbajtësit të lejes i nënshtrohet inspektimit prej Inspektoratit Shtetëror Mjedisor. Ligji parashikon dënime të ashpra në rastet kur mbajtësit e lejeve shkelin afatet dhe kushtet e lejes apo kërkesat e legjislacionit mjedisor, duke përfshirë propozimin nga AKM për Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit për revokimin e lejes mjedisore në rast të shkeljeve të rënda.

4.3.2. Praktikë ndërkombëtare

Praktikat pozitive ndërkombëtare në industrinë nxjerrëse kërkojnë që të gjithë projektet e kërkimit dhe shfrytëzimit të vlerësojnë, zvogëlojnë dhe raportojnë mbi të gjithë ndikimet në mjedis të projektit. Kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektet e propozuara të naftës, gazit dhe minierave është kthyer në një standard për kompanitë e famshme ndërkombëtare të naftës dhe gazit. Në të vërtetë, standardi është zhvilluar me tej sa që praktika pozitive është që një vlerësim i ndikimit në mjedis dhe social kryhet për një projekt të propozuar. Çdo VNM apo VNMS duhet të kryhet në fazën e hershme të projektit. Koha e saktë varet nga projekti por duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme mbi natyrën e projektit në mënyrë që t'i mundësojë aktorëve kryesorë të kuptojnë ndikimet dhe rreziqet e mundshme. Konsultimet me aktorët kryesorë, duke përfshirë dhe banorët e zonës, janë një pjesë thelbësore e procesit të VNM dhe VNMS. Kryerja e VNM apo VNMS sipas standardeve të pranuara ndërkombëtare (në përputhje me Direktivat e BE) është një kusht për miratimin qeveritar dhe rregullator, si dhe për sigurimin e financimit.

Pas përfundimit, raporti i VNM duhet të botohet bashkë me planin sesi propozuesit e projektit do t'i trajtojnë gjetjet e VNM dhe sesi do të zvogëlojnë ndikimet. Plani duhet të përcaktojë sesi do të monitorohen dhe zvogëlohen emetimet dhe ndikimet e tjera. Propozuesit e projektit duhet të sigurojnë raporte të rregullta (vjetore) mbi veprimet që do të ndërmarrin për trajtimin e ndikimeve në mjedis. Praktikë pozitive ndërkombëtare përfshijnë hartimin, zbatimin dhe rishikimin periodik të një plani të gjerë angazhimi me

aktorët kryesorë. Rregulloret mund të kërkojnë që kompanitë t'i raportojnë më shpesh rezultatet e monitorimit të mjedisit pranë agjencive rregullatorë (çdo muaj apo çdo tre muaj). Praktikë pozitive ndërkombëtare gjithashtu kërkon që kompanitë të hartojnë një mekanizëm ankimimi me qëllim që t'i mundësojnë publikut, punonjësve apo aktorëve/ palëve të tjerë (p.sh., furnizuesve) raportimin e shkeljeve të detyrimeve për mbrojtjen e mjedisit. Ky mekanizëm duhet të jetë i aksesueshëm në gjuhën vendase (një adresë e posaçme elektronike apo një numër i posaçëm telefoni), duhet të lejojë raportimin anonim, ndërmarrjen e një hetimi të plotë, mbajtjen e një regjistri të posaçëm të ankesave, si dhe kthimin në kohë të përgjigjeve ndaj ankuesve mbi rezultatin e ankesës.

4.3.3. Praktikë Kombëtare për VNM/lejet mjedisore të industrive nxjerrëse

Të gjitha llojet e industrive nxjerrëse duke përfshirë guroret, minierat, naftën dhe gazin mbulohen prej legjislacionit mjedisor ekzistues në Shqipëri, prandaj ato janë të detyruara të përmbushin kërkesat ligjore përkatëse, VKM, urdhërat dhe rregulloret sipas llojit të teknologjisë dhe kategorive përkatëse të industrive. Kuadri ligjor mbi procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr 10440 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të miratuar në datë 07.07.2011 dhe i ndryshuar më vonë me Ligjin nr 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin 10440, datë 07.07.2011 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe Ligjin Nr.52/2020 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar. Kuadri kruesor ligjor për procedurën e VNM përfshin gjithashtu dhe:

- VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar;
- VKM Nr 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”;
- VKM Nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregulla të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, i ndryshuar.

Procedura për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) në Shqipëri mund të përmbledhet në tri fazat e mëposhtme:



Figura 8. Procesi i VNM

- 1) **Vlerësimi paraprak (shqyrtimi dhe studimi):** propozuesi duhet të kryejë një analizë shqyrtimi të projektit duke u bazuar në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (i ndryshuar)” për kategorizimin fillestar të projektit bazuar në Shtojcat e ligjit. Nëse veprimtaria e propozuar përfshihet në listën e projekteve të Shtojcës II, propozuesi duhet të paraqesë një raport paraprak të VNM. Nëse veprimtaria e propozuar përfshihet në listën e projekteve të Shtojcës I, propozuesi duhet të paraqesë fillimisht Raportin e Ndërveprimit me Mjedisin. Në të dy rastet këto raporte i paraqiten Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), e cila ia përcjell AKM. AKM merr

vendimin përfundimtar për procesin e mëtejshëm të VNM-së. AKM, përmes një korrespondence zyrtare, komunikon me propozuesin/zhvilluesin mbi çështjet apo pikat që duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit të projektit. Nëse, sipas AKM, projekti kategorizohet në Shtojcën II, ai do të kërkojë vetëm një VNM paraprake. Nëse AKM e kategorizon projektin në Shtojcën I, propozuesi do të paraqesë fillimisht Raportin e Ndërveprimit me Mjedisin dhe më tej do të kryejë një studim të thelluar të VNM.

2) Faza e Konsultimit Lokal: Kjo fazë përfshin marrjen e një aprovimi “pa kundërshtime” prej autoriteteve dhe komuniteteve vendore (Bashkitë dhe Njësitë Administrative). Nuk kërkohet konsultim me publikun për projekte që kërkojnë vetëm një raport paraprak të VNM. Konsultimi me Publikun kërkohet vetëm për VNM të thelluar dhe përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

- i) Propozuesi dërgon një Përmbledhje Jo-Teknike të VNM dhe një kërkesë për konsultim/dëgjuesë publike. Këto dy dokumente botohen në faqen zyrtare të AKM për 20 ditë kalendarike me qëllim që të aksesohen nga komuniteti lokal, aktorët kryesore dhe palët e interesit;
- ii) Propozuesi, në bashkëpunim me AKM dhe Drejtorinë përkatëse Rajonale të Mjedisit organizojnë një konsultim/dëgjuesë publike me aktorët kryesore, ku përfshihen pjesëmarrës nga njësitë administrative, bashkia, komuniteti lokal, shoqëria civile dhe palë të tjera të interesuara;
- iii) Këshilli bashkiak shpreh një mendim mbi projektin, gjithashtu merren parasysh mendimet e njësisë administrative, komunitetit lokal dhe palëve të tjera të interesit;
- iv) Sugjerimet, komentet, pyetjet dhe përgjigjet e dëgjuesës/konsultimit publik përfshihen në Raportin e thelluar të VNM.

3) Miratimi nga MTM dhe AKM:

- i) Pas paraqitjes së Raportit Përfundimtar të VNM dhe vlerësimit prej AKM, MTM lëshon deklaratën mjedisore nëse projekti përmbush në tërësi kërkesat ligjore;
- ii) Kërkesa për lejen e VNM paraqitet pranë QKB për licencim, dhe kjo e fundit ia përcjell dokumentacionin AKM;
- iii) AKM shqyrton dokumentacionin, kryen vëzhgime në terren (nëse është e nevojshme) në bashkëpunim me DRM dhe drejtoritë e tjera përkatëse dhe përgatisin opinionin e tyre mbi projektin duke përfshirë këtu dhe kërkesa specifike mbi lejen;
- iv) Duke u bazuar në opinionin e AKM, MTM lëshon lejen dhe e dërgon atë në QKB, dhe kjo e fundit ia përcjell zhvilluesit;

Kërkesat e VNM paraprake: Projektet që duhet t'i nënshtrohen një VNM paraprake duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar. Propozuesi duhet të paraqesë një Raport Teknik të Projektit siç përcaktohet në VKM nr. 686 (i ndryshuar), si dhe një Raport Paraprak të VNM me strukturën dhe çështjet e mëposhtme:

1. Përshkrimin e mbulesës bimore në zonën e propozuar të projektit, shoqëruar me foto të vendit të përcaktuar;
2. Informacionin për praninë e burimeve ujore në zonën e projektit dhe në afërsi të tij;
3. Identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, duke përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
4. Përshkrimin e shkarkimeve të mundshme në mjedis të tilla si: ujëra të ndotura, emetime të gazeve dhe pluhurave, emetime të zhurmave dhe dridhjeve/vibrimeve, si dhe prodhimit të mbetjeve;

5. Informacionin mbi kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve të identifikuar negative;
6. Të dhënat për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimeve negative në mjedis, duke përfshirë distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerave/aspekteve të ndikuara nga zhvillimi i projektit;
7. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të zonës/mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
8. Masat e mundshme për shmangien/parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
9. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti shkakton ndikime të tilla).

Kërkesat e VNM së thelluar: Projektet që i nënshtrohen VNM së thelluar duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar. Propozuesi/ Zhvilluesi duhet të paraqesë një Raport Teknik të Projektit, si dhe një Raport të Ndërveprimit me Mjedisin (i njëjtë me raportin paraprak të VNM) siç përcaktohet në VKM nr. 686 (i ndryshuar). Pas shqyrtimit të dokumentacionit prej MTM dhe AKM, propozuesi kryen një studim të hollësishëm të VNM, përgatit një Përmbledhje Jo-Teknike të VNM së thelluar dhe zhvillon një Dëgjuesë/Konsultim me Publikun së bashku me të gjithë aktorët e interesuar në proces. Pas përfundimit të këtyre hapave, propozuesi paraqet përsëri një version të rishikuar të Raportit Teknik dhe një Raport të Thelluar të VNM me strukturën dhe çështjet e mëposhtme:

1. Informacion për projektin që kërkon VNM dhe metodologjinë e ndjekur;
 - a. Përshkrimi i qëllimit dhe objektivave të VNM;
 - b. Përshkrim i shkurtër i kuadrit ligjor për mjedisin;
 - c. Përshkrim i metodologjisë së ndjekur për përgatitjen e VNM së thelluar;
2. Përshkrim i projektit, duke përfshirë:
 - a. Qëllimin e projektit të propozuar;
 - b. Vendndodhjen e projektit dhe planet/ hartat, duke përfshirë dhe koordinatat e zonës së projektit;
 - c. Skicën dhe planimetrinë e ndërtesave dhe strukturave të projektit;
 - d. Përshkrim të proceseve të ndërtimit dhe proceseve teknologjike, duke përfshirë aftësitë prodhuese/përpunuese, sasinë e nevojshme të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
 - e. Infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin energjistik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe prodhimin e mbetjeve, si dhe informacion mbi rrugët ekzistuese apo ndërtimin e rrugëve të reja;
 - f. Programin e ndërtimit, periudhën e planifikimit, periudhën e funksionimit, fazën e rehabilitimit;
 - g. Metodatat e përdorura për ndërtimin e infrastrukturës së projektit;
 - h. Lëndët e para që do të përdoren për fazën e ndërtimit dhe mënyrën sesi do të sigurohen (materialet, uji dhe energjia);
 - i. Informacion mbi lidhjet/ndërveprimin e projektit me projektet e tjera në afërsi;

- j. Përdorimi i lëndëve të para gjatë fazës së funksionimit, duke përfshirë sasitë e nevojshme të ujit, energjisë dhe lëndëve djegëse dhe mënyrën sesi do të sigurohen;
 - k. Veprimtaritë e tjera të nevojshme për zbatimin e projektit si p.sh ndërtimi i kampeve apo godinave. Informacion mbi lejet dhe licencat që nevojiten për projektin dhe që kërkohen nga legjislacioni në fuqi dhe autoritetet përkatëse shtetërore për miratimin e lejes së projektit;
3. Përshkrimin e alternativave për zbatimin e projektit apo komponentëve të tjerë specifik (p.sh rrugët, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit, etj.), si dhe justifikimi i alternativave kyçe të propozuara duke marrë parasysh ndikimet mjedisore të çdo alternative dhe nëse është e mundur marrjen parasysh të sugjerimeve dhe mendimeve të institucioneve përkatëse shtetërore të angazhuara në projekt.
 4. Përshkrimin e kushteve ekzistuese bazë të mjedisit, të cilat mund të ndikohen nga projekti i propozuar, duke përfshirë:
 - a. Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit (klima, gjeomorfologjia dhe sizmika, gjeologjia dhe toka, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore);
 - b. Përshkrimi i biodiversiteti në zonën e projektit (habitatet, speciet e florës dhe faunës, statusin e ruajtjes së tyre kombëtar dhe ndërkombëtar, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës);
 - c. Përshkrimin e cilësisë ekzistuese të mjedisit dhe ndikimet ekzistuese (cilësia e ujit, cilësia e ajrit, nivelet e zhurmave, menaxhimi i mbetjeve, dhe çështje të tjera si erozioni i tokës, zjarret, ndotja historike, presionet kryesore mbi mjedisin si prerjet e bimësisë dhe faktorë të tjerë ndotës);
 - d. Përshkrimin e veçorive sociale në zonën e projektit të propozuar (njësitë administrative, popullsia dhe veprimtaritë kryesore ekonomike, përdorimi i tokës, trashëgimia kulturore dhe monumentet e kulturës, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura);
 5. Përshkrimin e ndikimeve negative në mjedis të projektit të propozuar.
 - a. Ndikimi negativ mbi mjedisin, duke përfshirë ndikimet mbi mjedisin fizik, ndikimet në habitate dhe biodiversitet, ndikimet nga shkarkimet dhe prodhimi i mbetjeve, ndikimet e shtuara/ kumulative të projektit, ndikimet sociale (ndryshimi i përdorimit të tokës, problemet nga krijimi i zhurmave, ndotja e ajrit, përdorimi i burimeve natyrore, etj.);
 - b. Veçoritë e ndikimeve negative në mjedis, duke përfshirë metodologjinë e zbatuar për parashikimin e ndikimeve negative, shpërndarja fizike dhe madhësia e ndikimit, llojet e ndikimeve, (të drejtpërdrejta dhe jo), mundësia e masave zbutëse dhe justifikimi i duhur i masave për ndikimet e parashikuara, zonat e ndjeshme që mund të preken/ ndikohen nga veprimtaritë e projektit (zonat e mbrojtura, habitatet, zonat e banuara, burimet ujore, zona e trashëgimisë kulturore, etj.);
 6. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti shkakton ndikime të tilla).
 7. Ndikime pozitive në mjedis (dhe sociale) që vijnë prej zhvillimit të projektit.
 8. Masat zbutëse të propozuara për secilin ndikim negativ, të përshkruara në seksionin 5, më sipër.
 9. Program i monitorimit të mjedisit gjatë fazës së funksionimit të projektit.
 10. Plani i monitorimit dhe menaxhimit mjedisor, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë për masat e propozuara për menaxhimin dhe zbutjen e ndikimeve/ dëmeve, kostot përkatëse për mbrojtjen e

mjedisit dhe faza rehabilituese, plani i komunikimit dhe informimit të publikut, komunitetit lokal dhe aktorëve kryesorë/ palëve të interesit;

11. Shtojcat e raportit të VNM së thelluar, duke përfshirë:

- a. Përmbledhja jo-teknike;
- b. Kërkesat specifike të AKM dhe institucioneve të tjera gjatë konsultimeve publike, informacion mbi metodat e përdorura për procesin e konsultimit, rezultatet/informacioni i përfituar, kontaktet e pjesëmarrësve gjatë konsultimit publik, shqyrtimi i çështjeve të ngritura gjatë konsultimeve;
- c. Lista e hollësishme e specieve të florës dhe faunës, duke përfshirë statusin e tyre të mbrojtjes/ruajtjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- d. Referenca dhe burime të informacionit të përdorur në raportin e VNM-së thelluar;
- e. Çertifikata e ekspertit që ka përgatitur raportin e VNM.

Kërkesat e Lejeve Mjedisore: me miratimin e deklaratës mjedisore për raportin e VNM (paraprak ose të thelluar), propozuesi i projektit aplikon për leje mjedisore. Në varësi të llojit të industrisë nxjerrëse, zonës sipërfaqësore të përdorur dhe metodat/teknologjinë e zbatuar, projekti klasifikohet sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 52/2020 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar. MTM dhe AKM shqyrtojnë raportin e VNM, masat e propozuara zbutëse dhe ndikimet në mjedis dhe përcaktojnë detyrimet e zhvilluesit të projektit në lidhje me angazhimin mjedisor. Për shembull, leja mjedisore mund të përcaktojë kërkesa specifike për monitorimin e mjedisit, duke përfshirë monitorimin e cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmave dhe dridhjeve/ vibrimeve, matjet e cilësisë së ujit gjatë fazës së zhvillimit të projektit. Për më tepër, kërkohen hollësi për shkarkimet e ujërave të ndotura dhe gjenerimit të mbetjeve, si dhe në lejen mjedisore specifikohen masat e menaxhimit dhe zvogëlimit të ndikimeve/ dëmeve në mjedis. MTM dhe AKM mund të kërkojnë masa zbutëse shtesë gjatë fazës së funksionimit të projektit, duke përfshirë plane menaxhimi të mjedisit dhe plane rehabilitimi. Mbajtësi i Lejes është i detyruar të përmbushë të gjithë kërkesat e përcaktuara në lejen mjedisore dhe të raportojë informacionin dhe monitorimin mjedisor në përputhje me këto kërkesa bazuar në afatet e parashikuara në Ligj/VKM dhe në vetë lejen mjedisore.

4.3.4. Detyrimet mjedisore dhe rehabilitimit sipas kontratës/lejes/ligjit

Të gjithë llojet e industrive nxjerrëse, guroret, minierat si dhe sektorët e naftës dhe gazit janë të detyruar të përmbushin kërkesat e përcaktuara në lejen mjedisore. Duke iu referuar aspekteve mjedisore, përpara vitit 2010, kërkesat dhe detyrimet ligjore për industritë nxjerrëse kanë qenë me pak të rrepta, jo vetëm brenda kuadrit ligjor, por edhe gjatë fazës së zbatimit dhe monitorimit prej institucioneve përkatëse. Me fillimin e projektit TAP, në veçanti pas vitit 2015, një pjesë e kuadrit ligjor kombëtar u përditësua/ndryshua. Kështu, projekti TAP, i cili tregoi praktika pozitive dhe zbatoi standarde mjedisore ndërkombëtare, dha kontribut në forcimin e kuadrit ligjor dhe praktik/ rregullator në Shqipëri. Aktualisht, autoritetet shtetërore kërkojnë një gamë të gjerë dokumentacioni të detyrueshëm nga industritë nxjerrëse me qëllim që ato të përmbushin detyrimet e lejeve mjedisore. Detyrimet mjedisore dhe rehabilitimit të industrive nxjerrëse sipas kërkesave të lejeve mjedisore përfshijnë dokumentacionin e mëposhtëm që duhet të paraqitet nga mbajtësi i lejes gjatë fazës operacionale/ funksionale:

1. **Monitorimi i çlirimeve/ emetimeve në ajër** – monitorimi periodik i çlirimeve/ emetimeve në ajër nga mbajtësi i lejes. Matjet duhet të kryhen nga një laborator i akredituar mjedisor.

2. **Monitorimi i shkarkimeve ujore** – monitorimi i shkarkimeve ujore (nëse ka) që mund të vijë si rrjedhojë e zbatimit të veprimtarive. Këtu përfshihen shkarkimet në sistemet e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe/apo shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave (nëse ka);
3. **Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore** – monitorimi periodik i cilësisë së burimeve ujore. Matjet duhet të kryhen nga një laborator i akredituar mjedisor.
4. **Regjistri i ankesave** – kërkohet që mbajtësi i lejes të mbajë një regjistër të posaçëm për çdo ankesë nga komuniteti lokal dhe/apo aktoret/ palët e tjerë kryesore gjatë veprimtarive operacionale. AKM dhe DRM janë të përfshira në këtë proces në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ato ndërmarrin hapat e nevojshme verifikuese në rastet kur ka ankesa;
5. **Regjistri i shkarkimit të ndotësve dhe transferimit të tyre** – në përputhje me VKM nr. 742, datë 09.09.2015 “Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori”, mbajtësi i lejes duhet të mbajë shënim çdo emetim dhe nivelin e ndotësve në një regjistër të posaçëm, ashtu siç kërkohet nga VKM. Rezultatet duhet t’i paraqiten AKM rregullisht.
6. **Programi i monitorimit për emetimet e zhurmave (dhe dridhjeve)** – monitorimi periodik i emetimeve të zhurmave dhe dridhjeve nga mbajtësi i lejes. Matjet duhet të kryhen nga një laborator i akredituar mjedisor.
7. **Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM)** – mbajtësi i lejes duhet të përgatisë një Plan Menaxhimi Mjedisor, duke përfshirë shtojcat përkatëse bazuar në objektivat dhe detyrat e përcaktuara në lejen mjedisore. PMM duhet të rishikohet një herë në vit.
8. **Programi i Menaxhimit të Riskut** – mbajtësi i lejes duhet të identifikojë rreziqet e lidhura me projektin e industrisë nxjerrëse dhe të ndërmarrë masa zbutëse për të trajtuar këto rreziqe, t’i shmangë apo zvogëlojë ato aq sa të jetë e mundur.
9. **Raporti Vjetor Mjedisor** – mbajtësi i lejes duhet t’i paraqesë AKM një raport vjetor duke përfshirë në të të gjithë rezultatet, emetimet dhe masat zbutëse që janë ndërmarrë përgjatë gjithë vitit.
10. **Plani i Emergjencës** – mbajtësi i lejes duhet të përgatisë një Plan Emergjence që identifikon çdo rrezik që mund të vijë nga shkarkimet/ derdhjet, zjarret dhe/apo shpërthimet gjatë fazës operacionale. Mbajtësi i lejes duhet të marrë masat zbutëse përkatëse, duhet të disponojë pajisjet e duhura, sinjalistikën përkatëse, si dhe të zbatojë praktikën e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit (SHSM) me qëllim reagimin në kohën e duhur kundër çdo rasti apo emergjence të paparashikuar.
11. **Plan i Përputhshmërisë** – mbajtësi i lejes duhet të paraqesë një Plan Përputhshmërie sipas afatit të përcaktuar nga AKM dhe MTM në lejen mjedisore.
12. **Regjistri për prodhimin e mbetjeve dhe transferimin e tyre** – mbajtësi i lejes duhet të mbajë shënim (regjistrojë) të gjitha llojet e mbetjeve që krijohen gjatë veprimtarisë së projektit, duke përfshirë dhe sasitë përkatëse të mbetjeve të transferuara. Mbajtësi i lejes duhet të ketë një kontratë zyrtare me institucionet zyrtare (p.sh. bashkinë) dhe kompanitë private për asgjësimin dhe riciklimin e mbetjeve. Mbajtësi i lejes duhet të mbajë një regjistër transferimi për të gjitha transferimet e mbetjeve. Ky regjistër duhet të firmoset nga mbajtësi i lejes dhe kompania përkatëse. Të dhënat për mbetjet duhet të dorëzohen rregullisht pranë institucioneve shtetërore.
13. **Plan trajnimi** – Kërkohet që mbajtësi i lejes të hartojë një program trajnimi për punonjësit në lidhje me administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projektit. Mbajtësi i lejes duhet t’i përmbahet angazhimeve të tij në lidhje me aspektet mjedisore dhe sociale dhe të ndërgjegjësojë personelin e tij për këto çështje.

14. **Plani i mbylljes dhe rehabilitimit** – mbajtësi i lejes duhet t'i paraqesë institucioneve shtetërore një Plan Mbyllje dhe Rehabilitimi, duke përfshirë një plan zbatimi të hollësishëm dhe kostot përkatëse. Ky plan përditësohet çdo vit dhe i dorëzohet institucioneve shtetërore.
15. **Raporti i Monitorimit** – mbajtësi i lejes duhet t'i paraqesë AKM një Raport Monitorimi sipas afateve të përcaktuara në lejen mjedisore (çdo 1 muaj, çdo 3 muaj, çdo 6 muaj, etj.). Ky raport përmban zakonisht të dhëna mbi matjet e cilësisë së ajrit dhe ujit, zhurmës, matjet e zhurmës dhe dridhjeve/vibrimeve, të dhëna për mbetjet, llojet dhe sasi të tyre dhe të dhëna të tjera përkatëse që lidhen me veprimtaritë e projektit dhe aspektet mjedisore.
16. **Raporti i Auditimit Mjedisor** – siguron një vlerësim objektiv nga një palë e tretë të performancës mjedisore të veprimtarisë së projektit dhe një plan veprimi korrigjues që synon përmirësimin e saj. Raporti i Kontrollit Mjedisor kryhet një herë në vit.
17. **Plan i Veprimit, vetëm për guroret** – duke iu referuar Urdhërit Nr. 67, datë 11.03.2018 “Për Miratimin e “Planit të Veprimit për Veprimtaritë Minerare me Karrierë (Guroret)”, mbajtësi i lejes duhet të përgatisë një Plan Veprimi për industrinë minerare që prodhojnë materiale apo lëndë të parë për sektorin e ndërtimit siç janë guroret. Ky plan është i ngjashëm me një metodikë pune ose plan organizimi që përdoret për organizimin e kantierit gjatë veprimtarive operacionale dhe duhet të përmbajë të dhëna për planet projektuese, vendndodhjen e godinave dhe strukturave, vendndodhjen e konteniereve të mbetjeve në kantier, ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve që nevojiten për veprimtaritë e projektit, etj.

4.3.5. Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet Ligjore

Ky seksion identifikon mangësitë/ mospërputhjet/ boshllëqet në legjislacionin aktual kombëtar të mjedisit, kërkesat gjatë fazës së VNM-së dhe fazës së zbatimit dhe monitorimit nga autoritetet shtetërore të industrive nxjerrëse në Shqipëri. Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në legjislacionin e VNM-së dhe monitorimit gjatë funksionimit të aktiviteteve janë vlerësuar dhe krahasuar me kërkesat e legjislacionit ndërkombëtar, standarde dhe praktikave më të mira të përdorura në industrinë nxjerrëse.

Tabela 4. Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në legjislacionin kombëtar mjedisor, dhe praktikat e monitorimit për industrinë nxjerrëse, dhe kërkesat / aplikimet në bazë të legjislacioneve ndërkombëtare, standarde dhe udhëzimeve.

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
1.	Legjislacioni dhe procedura e VNM-së sipas: - Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar; - VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore”, i ndryshuar; - VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin	Legjislacioni shqiptar i VNM-së përmban disa mangësi/ mospërputhje/ boshllëqe gjatë aplikimit dhe procesit studimor jo vetëm për industrinë nxjerrëse, por edhe për llojet e tjera të projekteve. Këto boshllëqe mund të ndikojnë në fazën e VNM dhe projektin në vazhdim në një mënyrë negative, veçanërisht për industrinë nxjerrëse e cila mund të paraqesë ndikime më të mëdha mjedisore dhe sociale. 1) Procesi dhe aplikimi fillestar i VNM-së në Shqipëri është shpeshherë i ngatërruar për propozuesin e projektit ose zhvilluesin. Ekziston një udhëzim ministror, saktësisht udhëzimi nr. 6, datë 27.12.2006, i cili mendohet të veprojë si një listë kontrolli, shqyrtimi dhe studimi paraprak për vlerësimin e projektit. Ky udhëzim i është përmbajtur udhëzimit të BE-së për VNM-në për fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit, në të cilin një projekt i propozuar klasifikohet bazuar në ndikimet e tij nëse ka nevojë për një VNM	Në lidhje me kërkesat shqiptare për VNM, legjislacioni ndërkombëtar (p.sh. BE), Standardet e Performancës së IFC dhe Korniza Mjedisore dhe Sociale e Bankës Botërore kërkojnë hapa dhe studime shtesë. Në veçanti, për industrinë nxjerrëse këto standarde duhet të kombinohen me praktika të mira mjedisore dhe sociale, dhe udhëzime specifike të bazuara në përvojën / rastet studimore. Zbatimi i legjislacionit dhe standardeve ndërkombëtare për procedurën e VNM duhet të ndjekë proceset shtesë vijuese: 1) Përqëndrim/ Fokus në fazën e shqyrtimit – vlerësimi paraprak i projektit dhe ndikimet e lidhura me të. Si rezultat i kësaj faze, projekti mund të klasifikohet bazuar në kërkesat e VNM, pavarësisht nëse ka nevojë për një studim paraprak

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
	dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”; Udhëzim Nr. 6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”.	paraprake ose një VNM të thelluar. Sidoqoftë, në procedurën e VNM-së në Shqipëri, ky udhëzim përdoret rrallë gjatë procesit fillestar të aplikimit. Nuk ka një procedurë të qartë në fazat studimore dhe vlerësimit të VNM-së së projektit të propozuar, përkundrazi kjo përmbledhet në një proces të quajtur zakonisht 'vlerësimi fillestar ose paraprak'. Kjo kryhet nga propozuesi i projektit dhe / apo konsulenti, megjithatë komentet nga AKM dhe MTM në këtë fazë janë minimale ose joekzistente. Ka raste të caktuara kur propozuesi vlerëson që një projekt i industrisë nxjerrëse ka nevojë për një studim paraprak të VNM-së, por autoritetet qeveritare mund të vendosin që projekti duhet t'i nënshtrohet një studimi të thelluar të VNM-së, duke filluar kështu të gjithë procesin e aplikimit nga fillimi. Kjo mospërputhje e kohës dhe procedurës mund të krijojë një boshllëk të madh gjatë procesit të VNM, si dhe të shkaktojë probleme gjatë studimeve fillestare dhe fazës së vlerësimit të ndikimit. 2) Angazhimi i aktorëve të tjerë dhe konsultimi me publikun dhe / apo me palët e interesit është i kufizuar në legjislacionin kombëtar. Nëse një projekt klasifikohet për një studim paraprak të VNM-së, ligji nuk parashikon asnjë konsultim me publikun apo angazhim me palët e interesit. Për projektet që kanë nevojë për një studim të thelluar të VNM-së, kërkohet vetëm një cikël i konsultimit	ose të thelluar. Përdorimi i një liste kontrolli e shqyrtimi do të lehtësonte procesin. Udhëzimet për shqyrtimin rekomandohen të kryhen në përputhje me Direktivën 2011/92 / BE të ndryshuar nga 2014/52 / BE. 2) Përqëndrim/ Fokus në fazën studimore (scoping)– një proces me të cilin palët e interesuara këshillohen për të kontribuar në identifikimin e çështjeve kryesore që do të shqyrtohen si pjesë e VNM. Përdorimi i një liste kontrolli studimore do të lehtësonte procesin. Udhëzimet mbi fazën e studimit (scoping) rekomandohen të zhvillohen në përputhje me Direktivën 2011/92/BE të ndryshuar nga 2014/52/BE. Metodologjia e VNM përcaktohet në këtë fazë, si dhe studimet përkatëse fillestare që do të kryhen në fazat në vijim. Një raport studimor për VMN përgatitet në zbatim të kësaj kërkesë. 3) Plani i Angazhimit me Palët e Interesit dhe konsultimi me publikun – përfshin një qasje gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe konsultimit me palët e identifikuara të interesit gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Kjo përfshin komunitetin lokal, autoritetet e qeverisjes lokale, autoritetet

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		publik përpara dorëzimit të raportit përfundimtar në AKM. Kjo përfaqëson një mangësi/ boshllëk të madh në ligj, duke mos ofruar mundësi për rishikim të projektit apo ndryshime nga propozuesi, dhe duke mos përfshirë publikun, komunitetin lokal, autoritetet qeveritare dhe palët e tjera të interesit në procesin e vendim-marrjes. Mund të krijohen tensione midis propozuesit të projektit dhe publikut, duke rritur rrezikun e dështimit të projektit. Për më tepër, edhe nëse projekti është miratuar nga autoritetet shtetërore, gjatë fazës së operimit ai mund të shkaktojë shqetësime, pakënaqësi dhe irritim të komunitetit lokal, veçanërisht kur industria nxjerrëse shkakton ndotje të ajrit, ujit, gjenerim të zhurmave dhe mbetjeve. 3) Procesi shqiptar i VNM dhe legjislacioni i VNM nuk pasqyron plotësisht nevojën për t'u përqëndruar në ndikimet sociale. Sipas ligjit, VNM paraprake nuk përfshin ndonjë seksion apo studim të aspekteve sociale. Po kështu, VNM-ja e thelluar përfshin vetëm një pjesë të vogël brenda raportit. Si pasojë, ka pak të dhëna nga industritë nxjerrëse për aspektet sociale dhe vlerësimin e ndikimeve sociale. Kjo paraqet një mangësi/ boshllëk të madh në procesin ekzistues të VNM-së. Autoritetet qeveritare gjatë VNM-së të thelluar përqendrohen më shumë në konsultimin / dëgjuesën përfundimtare me publikun, i cili shumë	rajonale dhe kombëtare, përfshirë OJF-të dhe palët e tjera të interesuara. Standardet ndërkombëtare rekomandojnë të paktën 2-3 konsultime me publikun për një projekt që i nënshtrohet VNM-së së thelluar. 4) Përqëndrim/ Fokus në çështjet sociale – ndërsa legjislacioni shqiptar kryesisht i referohet ndikimeve në mjedis, standardet ndërkombëtare të tilla si IFC përqendrohen gjithashtu në identifikimin e ndikimeve sociale në komunitetet e prekura/ ndikuara dhe përcaktimin pasues të masave të nevojshme zbutëse/ lehtësuese.

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		shpesh nuk tregon pasqyrën e vërtetë të aspekteve sociale si rezultat i angazhimit 'të dobët' ose të kufizuar me palët e interesit dhe mungesës së një konsiderate të thelluar të gjetjeve kryesore sociale dhe ndikimeve përkatëse për shkak të zbatimit të projektit.	
2.	Ngjashmëria midis strukturës së raportit paraprak të VNM-së dhe Raportit të Ndërveprimit me Mjedisin i përdorur në procesin e VNM-së së thelluar.	Referuar VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 (i ndryshuar) ekziston një ngjashmëri e madhe midis raportit paraprak të VNM dhe Raportit të Ndërveprimit me Mjedisin. Kjo shpesh krijon konfuzion për propozuesit e projektit gjatë procesit të aplikimit dhe paraqet rrezik konflikti me autoritetet qeveritare. Raporti i Ndërveprimit me Mjedisin supozohet të zëvendësojë raportin për fazën e studimit (scoping, siç sugjerohet nga standardet ndërkombëtare), megjithatë struktura e raportit dhe kërkesat nuk e pasqyrojnë këtë. Një hendek/ mangësi tjetër është se angazhimi me palët e interesit nuk parashikohet në këtë fazë, duke shkaktuar boshllëqe të tjera në fazat e ardhshme të VNM-së së thelluar.	Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare u referohen proceseve dhe strukturave të ndryshme të raporteve për VNM-në paraprake dhe VNM-në e thelluar. Struktura e Raportit për fazën e Studimit është mjaft e ndryshme nga struktura e raportit të VNM-së paraprake. Raporti për fazën e Studimit përfaqëson një mjet për metodologjinë e VNM-së, studimet përkatëse që do të ndërmerren dhe ndarjen e informacionit me palë të ndryshme. Në këtë mënyrë zhvillohet një proces gjithëpërfshirës dhe të gjitha palët e interesit në projekt janë të përfshira në mënyrë proaktive. Një tjetër komponent i dobishëm i fazës së studimit dhe raportit studimor është lista e kontrollit që përmban studimi, e cila mund të shtohet si një shtojcë ose dokument i veçantë gjatë konsultimeve publike dhe aplikimit fillestar për VNM.
3.	Plani (et) i Menaxhimit Mjedisor (dhe Social).	Referuar VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 (i ndryshuar), PMM kërkohet brenda strukturës së raportit të thelluar	Standardet e IFC i referohen Planit (eve) të Menaxhimit Mjedisor dhe Social si një tërësi

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
	Dokumentet e kërkuara për paraqitjen periodike të mbajtësit të lejes sipas lejeve mjedisore dhe ligjit kombëtar për industrinë nxjerrëse.	të VNM. Për raportin paraprak të VNM-së PMM nuk kërkohet. Sidoqoftë, gjatë fazës së operimit zakonisht kërkohet brenda lejes mjedisore. Sidoqoftë, shpesh ka konfuzion në lidhje me PMM. Bazuar në rishikimin e disa lejeve mjedisore nga industritë nxjerrëse, mbajtësi i lejes gjatë operimit duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme (siç përmendet më sipër në seksionin 4.4.4): 1) Rezultatet e monitorimit të emetimeve në ajër; 2) Rezultatet e monitorimit të shkarkimeve të ujërave të ndotur; 3) Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe cilësisë së ujërave nëntokësore; 4) Regjistri i ankesave; 5) Regjistri për ndotësit e shkarkimeve dhe transferimet e tyre; 6) Rezultatet e monitorimit për emetimet e zhurmave (dhe dridhjeve/ vibrimeve); 7) Plani i menaxhimit mjedisor; 8) Plani i menaxhimit të riskut; 9) Raporti vjetor mjedisor; 10) Plani i emergjencës; 11) Plani i përputhshmërisë;	dokumentesh të nevojshme gjatë fazës së funksionimit të një aktiviteti, i cili merr në konsideratë të gjitha temat përkatëse mjedisore dhe sociale që mund të shkaktojnë shqetësime / pakënaqësi dhe ndotje, dhe adresohen përmes masa të ndryshme zbutëse për të minimizuar ose parandaluar çdo ndikim të mbetur. Përgjithësisht Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social përfshijnë shumë nën-plane dhe forma përkatëse monitorimi apo inspektimi që do përdoren gjatë fazës së funksionimit, të tilla si: • Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore; • Plani i Menaxhimit të Mbetjeve; • Plani i Menaxhimit të Biodiversitetit; • Plani i Menaxhimit të Punonjësve; • Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë; • Plani i Komunitetit Lokal dhe Investimeve; • Plani i Angazhimit me Palët e Interesit; • Plani i Menaxhimit të Zhurmave dhe Dridhjeve/ Vibrimeve; • Plani i Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit;

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		12) Regjistri për gjenerimin dhe transferimin e mbetjeve; 13) Plani i Trajnimit; 14) Plani i mbylljes dhe rehabilitimit; 15) Raporti i Monitorimit; 16) Raporti i auditimit mjedisor; 17) Plani i veprimit, vetëm për guroret. Siç mund të vërehet, shumë nga këto plane janë në të vërtetë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor. Shpesh PMM konsiderohet me rëndësi të ulët ose si një dokument i veçantë, i cili nuk përfshin nën-plane të tjera apo masa specifike zbutëse që duhet të zbatohen në terren. Për më tepër, PMM nuk është përcaktuar plotësisht brenda legjislacionit ekzistues të VNM. Duhet të ketë një përkufizim të strukturuar të PMM dhe planeve përkatëse që do të nevojiten gjatë fazës së operimit. Në mënyrë të ngjashme, duhet të ketë gjithashtu një strukturë të Raportit të Monitorimit të Mjedisit, si dhe dokumente / shtojca përkatëse të nevojshme (p.sh. rezultatet e monitorimit të ajrit, ujit, emetimit të zhurmave, etj.).	• Plani i Monitorimit Mjedisor; • Plani i Menaxhimit të Reagimit të Emergjencave; • Plani i Mbylljes dhe Rehabilitimit; Në mënyrë të ngjashme, standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare i referohen Raportit të Monitorimit të Mjedisit si një dokument që duhet të përmbajë të dhëna periodike për çështjet më të rëndësishme të specifikuar në lejen mjedisore si: • Emetimet në ajër; • Emetimet e zhurmave dhe dridhjeve/vibrimeve; • Shkarkimet e ujërave, përfshirë sasi të përkatëse; • Vlerësimi dhe matja e cilësisë së ujit; • Gjenerimi i mbetjeve, përfshirë llojin e mbetjeve, sasi të, transferimet dhe marrëveshjet e kontratave me kompani të tjera riciklimi; • Informacion mbi biodiversitetin përreth zonës së projektit; • Çështjet sociale, shqetësimet dhe ankesat;

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
			• Çdo të dhënë për aksidente, raste emergjente; • Trajnimi i punonjësve.
4.	Plani i Veprimit, sipas Urdhrit Nr. 67, datë 11.03.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit për Aktivitetet e Minierave në Karriera (Gurore)”.	Duke iu referuar takimeve të angazhimit me palët e interesit, është e paqartë nëse ky Urdhër Ministror po zbatohet në të vërtetë brenda sektorit të minierave (gurore). Është gjithashtu e paqartë nëse mbajtësi i lejes ka hartuar ndonjë dokument në përmbushje të kërkesave sipas urdhrit ministror. Plani i veprimit, siç përshkruhet në këtë urdhër ministror, ka për qëllim të jetë një plan i organizimit të zonës/ kantierit të projektit ose si metodë organizimi brenda zonës së projektit gjatë fazës së funksionimit. Plani i veprimit kërkon specifikime për aksin e rrugës hyrëse, ruajtjen e materialit dhe pajisjeve, menaxhimin e mbetjeve, zonën e grumbullimit të shtresës vegjetative të tokës, detajet e ndërtimit të strukturave, etj.	Sipas standardeve ndërkombëtare, udhëzimeve dhe praktikave më të mira, është e nevojshme që çdo projekt, jo i kufizuar vetëm në industrinë nxjerrëse, duhet të prodhojë një plan veprimi apo metodologji gjatë zbatimit / funksionimit të projektit. Zonat e projektit që janë të mirë organizuara do të performojnë më mirë, do të minimizohen rreziqet e shëndetit dhe sigurisë dhe ndikimet mjedisore dhe sociale.
5.	Plani i mbylljes dhe rehabilitimit.	Plani i Mbylljes dhe Rehabilitimit është një komponent kyç i procesit të VNM-së dhe fazave të tjera të projektit, në veçanti faza e funksionimit dhe nxjerrja nga përdorimi / braktisja. Shumica e projekteve që lidhen me industrinë nxjerrëse nuk kanë një plan mjaftueshëm të detajuar për rehabilitimin dhe restaurimin e zonës së projektit pas përfundimit të aktiviteteve të tyre. Në veçanti, kompanitë shqiptare	Aktualisht Plani i Mbylljes dhe Rehabilitimit për industrinë nxjerrëse në Shqipëri përditësohet çdo vit në përputhje me kërkesat e legjislacionit. Mungesa e përcaktimit të strukturës së Planit të Mbylljes dhe Rehabilitimit brenda raportit / procedurës së VNM-së paraqet një mangësi/ boshllëk të rëndësishëm. Përveç kësaj, një përmirësim

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		ofrojnë përpjekje minimale dhe fonde të limituara për fazën e rehabilitimit. Ka raste të tjera kur ka 'konfuzion' mbi masat zbutëse / planin e rehabilitimit dhe parashikimin e tyre gjatë procesit të VNM midis autoriteteve shtetërore dhe zhvilluesit. Nuk ka kriterë të mirëpërcaktuara nga legjislacioni shqiptar dhe / apo qeveria për një përqindje të caktuar të kostove të investimit që do të shkojnë për fazën e rehabilitimit. Ndonjëherë ka kërkesa të rrepta nga autoritetet shtetërore për një Plan shumë të hollësishëm të Mbylljes dhe Rehabilitimit brenda raportit të VNM-së dhe fazës së aplikimit të VNM-së. Aktualisht nuk ka ndonjë strukturë të përcaktuar në raportin / procedurën e VNM-së së planit të rehabilitimit dhe komponentëve që duhet të përmbajë. Kjo përbën një mangësi/ boshllëk tjetër në proces pasi plani shumë i detajuar duhet të hartohet dhe përgatitet gjatë zbatimit të projektit. Për më tepër, plani i detajuar duhet të përditësohet sipas periudhave, gjatë fazës së funksionimit dhe duhet të monitorohet më tej nga autoritetet shtetërore për zbatimin korrekt të masave në terren.	kryesor brenda legjislacionit mjedisor shqiptar do ishte përcaktimi i një përqindjeje të caktuar të investimeve kapitale që duhet të shkojë për fazën e rehabilitimit. Ky ndryshim në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit ose Ligjin e VNM-së do të ishte në përputhje të plotë me udhëzimet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të zhvilluara në Vendet Evropiane.
6.	Procesi i Monitorimit Mjedisor. Frekuenca e matjeve të monitorimit (p.sh. ajri, uji, etj.).	Parametrat e monitorimit mjedisor, kërkesat specifike dhe frekuenca e matjeve për secilin prej projekteve të industrisë nxjerrëse përcaktohen brenda lejes mjedisore. Sidoqoftë, nuk ka një rregullore, urdhër apo udhëzim të qartë se si vendosen/ përcaktohen këto parametra të monitorimit mjedisor për secilën lloj	Duhet të ekzistojnë rregulla të qarta në lidhje me aktivitetet e monitorimit që specifikojnë llojin e monitorimit, të dhënat që do të mbledhen, agjencinë ku do të dërgohen këto raporte dhe programin e monitorimit dhe raportimit. Programi i monitorimit dhe

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		industrie, apo ndonjë të dhënë tjetër mbi frekuencën / periodicitetin e matjeve sipas tipologjisë së projektit. Ekzistojnë gjithashtu mangësi/ boshllëqe të tjera të vërejtura gjatë rishikimit të lejeve të ndryshme mjedisore për lloje të ndryshme të industrive nxjerrëse. Për shembull, për projektet e pajisura me një Leje Mjedisi Lloji A u vu re se disa nga kërkesat më të zakonshme kishin të bënin me modelimin periodik të emetimeve në ajër (çdo 6-muaj) dhe raportin e auditimit të energjisë. Duke iu referuar kërkesës për modelimin e emetimeve në ajër, mund të ketë projekte të caktuara siç janë guroret kryesore të përdorura për nxjerrjen e gurëve gëlqerorë që mund të mos kenë nevojë për modelim periodik të emetimeve në ajër, veçanërisht nëse ato janë të vendosura në terrene malore / kodrinore larg zonave të banuara. Referuar kërkesës së auditimit të energjisë, kjo është diçka e re për legjislacionin shqiptar. Kuadri rregullator për auditimin e energjisë dhe auditorët u miratua vetëm në 2019, megjithatë sot nuk ka auditorë të licencuar të energjisë që mund të kryejnë këtë lloj studimi për industrinë.	raportimit mund të ndryshojë për lloje të ndryshme të aktiviteteve dhe projekteve.
7.	Bashkëpunimi midis autoriteteve qeveritare, MTM, AKM, DRM, AKBN dhe Inspektorati Mjedisor.	As legjislacioni sektorial dhe as legjislacioni mjedisor nuk përmbajnë kërkesa specifike për bashkëpunimin e autoriteteve përgjegjëse për industrinë nxjerrëse (MIE, AKBN) me autoritetet mjedisore (MTM, AKM,	Një qasje e adoptuar në vendet e tjera p.sh.në MB, është krijuar një rregullator i vetëm për një industri specifike. Në Mbretërinë e Bashkuar, qeveria krijoi Autoritetin e Naftës dhe Gazit (ANG) në 2015 për të rregulluar të gjitha aspektet e sektorit të nxjerrjes të naftës

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
		DRM) në rastet e ekzekutimit të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit.	dhe gazit. Në këtë mënyrë u bë një rishikim i qenësishëm i industrisë duke përcaktuar mënyrën e rregullimit, që solli rekomandimin e reformave të mëdha në sektor.
8.	Përdorimi i të ardhurave nga taksa e rentës minerare për mjedisin.	Legjislacioni nuk përmban ndonjë dispozitë e cila do të detyrojë Qeverinë të përdorë një pjesë të të ardhurave që vijnë nga taksa e rentës minerare e aplikuar në industrinë nxjerrëse me qëllim mbrojtjen e mjedisit apo rehabilitimin në zonat ku zhvillohen aktivitetet e industrisë nxjerrëse.	Ligji për Taksat Kombëtare duhet të ndryshohet duke alokuar një përqindje të të ardhurave nga taksa e rentës që do të përdoret për lehtësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale nga industritë nxjerrëse.
9.	Standardizimi i kërkesave të monitorimit dhe raportimit në industrinë e naftës.	Duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit sekondar dhe marrëveshjeve model të naftës, kërkesat e monitorimit dhe raportimit të vendosura në secilën marrëveshje të naftës mund të krijojnë pabarazi dhe probleme me monitorimin e kontraktuesve të ndryshëm.	Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Naftës (Kërkimi dhe Prodhimi), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore duhet të zhvillojë dhe përgatisë Marrëveshjet standarde të Naftës ku do të përfshihen klauzola specifike për monitorimin dhe raportimin e kërkesave në aktivitetet nxjerrëse të naftës.
10.	Standardizimi i garancive financiare për detyrimet mjedisore për Kontraktorët e Naftës.	Në të gjitha Marrëveshjet e Naftës nuk ka asnjë klauzolë të unifikuar që rregullon dhe përcakton garancitë financiare për mbrojtjen e mjedisit.	Në përputhje me kërkesat e Ligjit të Naftës (Kërkimi dhe Prodhimi), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore duhet të zhvillojë dhe përgatisë klauzola standarde të Marrëveshjeve të Naftës mbi detyrimet mjedisore dhe garancitë financiare që duhet të sigurohen nga Kontraktorët për këto detyrime.

Nr.	Tema e Referencës / Legjislacioni Kombëtar	Mangësitë/ Mospërputhjet/ Boshllëqet në Legjislacionit Kombëtar	Kërkesat / Aplikimet sipas Legjislacioneve Ndërkombëtare, Standardeve / Udhëzimeve dhe Praktikave më të mira
11.	Raportimi i mjedisit EITI.	Mungesa e procesit në Shqipëri.	EITI Shqipëri kohët e fundit ka filluar procesin e mbledhjes së të dhënave për sektorin industrisë nxjerrëse në Shqipëri dhe sigurimin e transparencës së monitorimit të mjedisit me publikun e gjerë. Përveç punës së EITI, procesi do të ketë nevojë për një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe të mirë me institucionet qeveritare si AKM, AKBN, MTM, MIE, etj., dhe me kompanitë private (mbajtës të lejeve) që operojnë në sektorin e industrisë nxjerrëse në Shqipëri.

4.3.6. Konkluzione dhe rekomandime

Rekomandime për VNM, Monitorimin dhe Menaxhimin e Industrive Nxjerrëse në Shqipëri

- ✓ Legjislacioni Mjedisor në Shqipëri ka nevojë për ndryshime të mëtejshme dhe aderim të plotë me legjislacionin ndërkombëtar, standardet (p.sh. IFC, BB ESF) dhe udhëzimet.
- ✓ Rekomandohet që VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” (i ndryshuar), duhet të përmirësohet / përditësohet në lidhje me temat e mëposhtme:
 - Përkufizim më i qartë i procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (dhe social);
 - Përkufizim i qartë i fazës së shqyrtimit dhe fazës së studimit (screening, scoping) të VNM-së;
 - Ndryshim i strukturës së raportimit të Raportit Paraprak të VNM-së dhe Raportit të Ndërveprimit me Mjedisin që nevojitet për studimin e thelluar të VNM-së. Sipas udhëzimeve të BE-së dhe legjislacionit ndërkombëtar, këto dy raporte nuk duhet të jenë të ngjashme në përmbajtje;
 - Përkufizim i qartë i Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, nën planeve dhe metodologji të tjera të nevojshme për fazat e ndërtimit dhe funksionimit;
 - Përcaktim i qartë i strukturës paraprake të Planit të Mbylljes dhe Rehabilitimit që kërkohet brenda studimit të VNM dhe planit të detajuar të kërkuar gjatë zbatimit të projektit;
 - Theks/ Fokus në çështjet sociale dhe vlerësimin e ndikimeve sociale, si për procedurat paraprake ashtu edhe për ato të thelluara të VNM-së.
- ✓ Rekomandohet që VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore” duhet të përmirësohet / përditësohet në lidhje me temat e mëposhtme:
 - Kërkohet më shumë fokus në Angazhimin me Palët e Interesit dhe Konsultimet me Publikun;
 - VNM Paraprake duhet të përfshijë të paktën 1 konsultim publik sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira;
 - VNM e thelluar rekomandohet të përfshijë të paktën 2-3 konsultime publike. Dy konsultime publike bëhen zakonisht gjatë fazës së studimit (scoping) të VNM-së nëse projekti zbaton standardet e IFC ose BB. Konsultimi i tretë publik kërkohet pas përfundimit të draft-raportit të VNM-së së thelluar.
- ✓ Rekomandohet që Udhëzimi Nr. 6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie” duhet të përditësohet në përputhje me Udhëzimin për Shqyrtimin dhe Studimin të Direktivës 2011/92 / BE e ndryshuar nga 2014/52 / BE. Përdorimi i udhëzimit nr. 6, datë 27.12.2006 duhet të përcaktojë vlerësimin fillestar / paraprak të kategorizimit të projektit dhe procedurës së VNM.
- ✓ Procesi i Monitorimit të Mjedisit duhet të përmbajë një seri të qartë të rregulloreve në lidhje me aktivitetet e monitorimit që specifikojnë llojin e monitorimit, frekuencën, të dhënat që do të mblidhen, strukturën e raportit, agjencinë pritëse për raportet dhe programin e monitorimit dhe raportimit.
- ✓ Rekomandohet që Plani i Veprimit, sipas Urdhrit të Ministrit Nr. 67, datë 11.03.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit për Aktivitetet e Minierave në Karriera (Gurore)”, të kërkohet për të gjitha llojet e projekteve, përfshirë projektet e industrive nxjerrëse. Plani i Veprimit ose i njohur ndryshe si Metodologjia për organizimin e kantierit gjatë punimeve duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

- ✓ Rekomandohet një bashkëpunim i fortë midis autoriteteve qeveritare si MTM, MIE, AKM, AKBN, DRM dhe Inspektorati Mjedisor që nga faza e hershme e një propozimi të projektit dhe bashkëpunim i vazhdueshëm gjatë fazave të ndërtimit, funksionimit, monitorimit dhe rehabilitimit.
- ✓ Rekomandohet që Ligji për Taksat Kombëtare të ndryshohet dhe të caktojë një përqindje të specifikuar të të ardhurave nga taksat e rentës minerare që do të përdoren me qëllim të zbutjes së ndikimeve mjedisore dhe sociale nga industritë nxjerrëse.
- ✓ Është e nevojshme një standardizim i plotë i kërkesave të monitorimit mjedisor dhe garancive financiare brenda sektorit të industrisë nxjerrëse, veçanërisht për sektorin e hidrokarbureve / naftës.

Konkluzione dhe rekomandime për EITI Shqipëri

- ✓ EITI Shqipëri krijon një proces për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të gjithë informacionit mjedisor të kërkuar nga klauzolat 6.1, b dhe 6.4 të Standardit EITI 2019 d.m.th., të dy kërkesat e informacioneve të detyrueshme dhe vullnetare.
- ✓ EITI Shqipëri përfshin informacione kontekstuale mbi natyrën praktike të aktiviteteve minerare dhe ato të naftës dhe gazit, p.sh. llojet e projekteve për të vendosur ndikimet mjedisore në kontekst. EITI Shqipëri bazon modelin e saj të raportimit për të dhënat mjedisore në modelet ekzistuese të përdorura në vendet ku ky standard aplikohet.
- ✓ EITI Shqipëri kryen aktivitete sensibilizuese me kompani dhe agjenci qeveritare në fushën e raportimit për të shpjeguar kërkesat e raportimit mjedisor dhe informacionin e kërkuar për të kompletuar modelin e raportimit.
- ✓ Aty ku është e mundur, EITI Shqipëri duhet të përdorë informacionin përkatës mjedisor tashmë të publikuar.
- ✓ EITI Shqipëri duhet të nxisë kompanitë e naftës dhe gazit që përdorin teknikat me thyerje hidraulike (fraktimi) të jenë transparente në lidhje me llojet e teknikave të përdorura dhe ndikimin e mundshëm.

5. Hulumtim bazuar në të Dhëna Ekzistuese - Ndikimet në Mjedis të Industrive Nxjerrëse

5.1. Ndikimet në Biodiversitet

Projektet e industrisë nxjerrëse mund të shkaktojnë ndikime negative në biodiversitet (florë dhe faunë). Aktivitete si guroret dhe minierat priten të kenë një ndikim më të madh në biodiversitet në krahasim me projektet e naftës dhe gazit për shkak të zonës më të madhe të shfrytëzimit për aktivitetet e projektit. Përgjithësisht projektet e naftës dhe gazit shpërndahen në vende relativisht të vogla eksplorimi, në vende përreth një rajoni ose shtrirje në një sipërfaqe të madhe, duke zvogëluar kështu efektin e heqjes të bimësisë dhe copëtimin e madh të habitateve. Sidoqoftë, kjo mund të ndryshojë nga një rast në tjetrin, në varësi të llojit të projektit.

Fragmentimi i habitateve ndodh kur zona të mëdha toke ndahen në zona gjithnjë e më të vogla, duke shkaktuar humbjen e specieve të florës dhe duke e bërë shpërndarjen e specieve vendase të faunës nga një vend në tjetrin të vështirë apo të pamundur, dhe duke prerë rrugët migratore. Izolimi mund të çojë në zvogëlim të specieve të faunës në nivel lokal, apo efekte gjenetike të tilla si ulje të riprodhimit brenda llojit. Speciet e faunës që kanë nevojë për zona të mëdha pyjore thjesht zhduken ose ato mund të lëvizin në distanca të gjata për të kërkuar habitate të përshtatshme për jetesë. Projektet e industrisë nxjerrëse mund të shkaktojnë ndikime të drejtpërdrejta dhe jodirekte në dëmtimin e florës dhe faunës. Ndikimet e drejtpërdrejta mund të përfshijnë zhdukjen e bimësisë dhe humbjen e habitatit natyror. Ndikimet jodirekte mund të përfshijnë shqetësime të specieve të faunës për shkak të gërmimeve, gjenerimit të zhurmave, dridhjeve/ vibrimeve dhe ndotësve të ajrit, kryesisht pluhurit. Disa ndikime janë afatshkurtra dhe të kufizuara në zonën e projektit, ndërsa të tjerat mund të kenë efekte afatgjata. Madhësia dhe ashpërsia e ndikimeve do të varet nga qasja që ndërmerr mbajtësi i lejes. Nëse mbajtësi i lejes angazhohet të zbatojë masat e duhura zbutëse dhe menaxhuese gjatë aktivitetëve të kërkimit dhe shfrytëzimit, ndikimi do të minimizohet në një nivel të pranueshëm në përputhje me kërkesat specifike ligjore. Në një farë mase, projektet e industrisë nxjerrëse si guroret dhe minierat mund të kompensojnë zhdukjen e habitateve origjinale, duke mbështetur ri-mbjelljen në zonën e projektit me specie vendase të florës dhe duke gjeneruar biotope të larmishëm për speciet e faunës si amfibët, zvarranikët, insektet dhe zogjtë, të ngjashme me kushtet para fillimit të aktivitetëve të punimeve/ operimit. Në industrinë e naftës dhe gazit rehabilitimi i zonave / habitateve të prekur/ ndikuar mund të jetë më i vështirë për shkak të funksionimit / shfrytëzimit të zonave për periudha të gjata kohore. Sidoqoftë, mbajtësi i lejes në këto raste duhet të angazhohet për të rivendosur dhe rikthyer në gjendjen e mëparshme të gjitha zonat e prekura gjatë fazës së kërkimit dhe për të minimizuar ndikimet në habitatin dhe biodiversitetin dhe kufizimin e tyre brenda zonave të punës ku ndodh shfrytëzimi.

5.2. Ndikimet në Gjeologji, Cilësinë e Tokës, Përdorimin e Tokës dhe Peizazhin

Industritë nxjerrëse mund të shkaktojnë ndikime të mëdha në gjeologjinë, tokën, përdorimin e saj, peizazhin e zonës dhe pamjes vizuale. Për shumicën e projekteve të gurore dhe minierave, gërmimet e mëdha sjellin ndryshime të mëdha në gjeologjinë dhe topografinë e një zone. Për shkak të ndryshimeve në topografi, potenciali për erozionin e tokës dhe sedimenteve rritet, pra paraqet rreziqe për degradimin e cilësisë së tokës dhe degradimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë. Kësisoj, që nga fillimi i projekteve, duhet kushtuar një vëmendje e rëndësishme ndaj kontrollit të erozionit. Erozioni mund të shkaktojë sasi të konsiderueshme të sedimenteve në trupat ujorë në afërsi (ujërat sipërfaqësorë dhe ujërat nëntokësorë), veçanërisht gjatë stuhive të mëdha dhe periudhave të shkrirjes së borës. Guroret dhe minierat mund të kontaminojnë ose degradojnë cilësinë e tokës në një sipërfaqe të madhe. Nëse janë në afërsi, aktivitetet bujqësore mund të preken gjithashtu. Gërmimet në këto lloje projektesh të industrive nxjerrëse modifikojnë

topografinë dhe peizazhin duke vënë në rrezik tokën dhe shkëmbinjtë natyralë të patrazuar më parë. Përveç ndikimeve të përmendura më sipër, kantieret e guroreve dhe minierave shpesh përfaqësohen nga ndikime të mëdha vizuale gjatë aktiviteteve të operimit, si dhe pas mbylljes së zonës nëse rehabilitimi i vendit nuk është kryer siç duhet. Në Shqipëri ka shumë zona minierash që paraqesin probleme me procesin e rehabilitimit, mungesën e ri-mbjelljes së bimësisë dhe profilimit të duhur (me tarraca). Kjo qasje krijon ndikime negative në peizazhin dhe pamjen vizuale, në veçanti kur zonat e projekteve të industrisë nxjerrëse janë në afërsi të zonave të banuara dhe / apo në afërsi të rrugëve kryesore. Për shembull, raste të ngjashme mund të vërehen në Bulqizë, zonën e Malit Tomori, zonat Krujë dhe Fushë-Krujë, zona Dimal (e quajtur më parë Urë-Vajgurore), zona e Beratit, etj.

Ndikime të ngjashme mund të vërehen gjithashtu në projektet e naftës dhe gazit në tokë. Ndikimet nga kjo lloj kategorie projekti janë zakonisht më të ulëta sesa ato në gurore dhe miniera. Sidoqoftë, gjatë fazës së shfrytëzimit mund të ketë ndikime të konsiderueshme në gjeologjinë dhe cilësinë e tokës për shkak të proceseve të shpimit dhe fraktimit hidraulik. Fraktimi hidraulik mund të ketë ndikime të konsiderueshme në gjeologji për shkak të injektimit të ujit për nxjerrjen e hidrokarbureve. Në varësi të zonës më të favorshme për nxjerrjen e hidrokarbureve, zonat e projektit mund të ndodhen në një larmi të madhe të llojeve të terrenit, duke përfshirë afër zonave të banuara, zonave kodrinore / malore dhe tokave bujqësore. Në rastin e tokave bujqësore, zona do të shndërrohet nga një tokë e kultivuar në një zonë industriale, e cila si rezultat i aktiviteteve të projektit mund të kontaminohet (derdhje) dhe / apo të degradohet për shkak të proceseve të ndryshme nxjerrëse. Për sa i përket ndikimeve në peizazh, madhësia mund të jetë më e ulët në projektet e naftës dhe gazit krahasuar me guroret dhe projektet e minierave. Sidoqoftë, ndikimet vizuale mund të jenë afatgjata për shkak të periudhës së gjatë të shfrytëzimit të hidrokarbureve. Pajisjet dhe makineritë nxjerrëse mund të krijojnë shqetësime vizuale në komunitetet lokale dhe tek vizitorët. Këto lloj ndikimesh mund të zvogëlohen përmes masave të ndryshme zbutëse dhe menaxhuese nëse praktikatat e mira ndiqen në çdo kohë.

5.3. Ndikimet në Cilësinë e Ajrit

Ndotja e ajrit mbetet ndër çështjet më shqetësuese të mjedisit në industrinë nxjerrëse. Emetimet në ajër mund të ndodhin gjatë secilës faze të ciklit të projektit të industrive nxjerrëse, veçanërisht gjatë hulumtimit, përgatitjes së aktiviteteve, shfrytëzimit dhe veprimtarive operacionale. Burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit në operimin e industrive nxjerrëse janë:

- Grimcat ngurta në ajër (kryesisht PM_{2.5} dhe PM₁₀) si rezultat i gërmimeve, shpërthimeve (p.sh. gurore), transportit të materialeve, erozionit të erës (më e shpeshtë në minierat e hapura), pluhurit të shpërndarë nga objektet e mbetjeve industriale, rezervave, vend-depozitimeve të mbetjeve dhe trafiku rrugor;
- Emetimet e shkarkimit nga burimet e lëvizshme (makina, kamionë, makineri / pajisje të rënda) gjithashtu mund të kontribuojnë në rritjen e niveleve të grimcave të ngurta në ajër, si dhe çlirimin e emetimeve të gazit (NO_x, SO_x, CO, etj.);
- Emetimet e pluhurit nga përpunimi i mineraleve dhe hidrokarbureve dhe lëvizja e trafikut, veçanërisht në rrugët e pashtuara; dhe,
- Emetimet e gazit nga djegia e karburanteve në burime të palëvizshme dhe të lëvizshme, nga shpërthimet, dhe përpunimi i mineraleve dhe hidrokarbureve.

Sapo ndotësit lëshohen/ çlirohen në atmosferë, ata pësojnë ndryshime fizike dhe kimike përpara se të arrijnë një receptor. Këta ndotës mund të shkaktojnë efekte serioze negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, veçanërisht në biodiversitet (faunë dhe florë). Aktivitetet e minierave dhe / apo naftës dhe gazit në shkallë të gjerë kanë potencialin të kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit, veçanërisht në fazën e operimit

ose shfrytëzimit. Rastet më problematike mendohen të jenë aktivitetet nxjerrëse që operohen pranë komuniteteve dhe / apo brenda zonave të banuara.

Emetimet më shqetësuese të ndotësve të ajrit nga lloje të ndryshme të industrive nxjerrëse, janë si më poshtë:

- 1) **Guroret** - emetimet e pluhurit (grimcat e imta) që vijnë nga pastrimi i vendit, aktivitetet e shpërthimit, gërmimi, thërmimi i shkëmbinjve dhe fraksionimi dhe lëvizja e trafikut.
- 2) **Minierat** - pjesa më e madhe e ndotësve të ajrit ka të bëjë me emetimet e pluhurit për shkak të aktiviteteve të mundshme të shpërthimit, aktiviteteve të operimit dhe lëvizjes së trafikut. Mund të ketë edhe emetim të gazit gjatë përpunimit të mineraleve dhe metaleve (përpunimi i xeherorëve në metal), megjithatë kjo do të varet nga teknologjia e përdorur për përpunimin specifik dhe lloji i mineralit.
- 3) **Nafta dhe Gazi** - ndotësit më shqetësues të ajrit kanë të bëjnë me emetimet e gazit, në veçanti SO_x, NO_x, CO, CO₂, etj., Gjatë veprimtarisë ose aktiviteteve të shfrytëzimit. Gjatë aktiviteteve të eksplorimit mund të ketë aktivitate shpuese, të cilat gjenerojnë ndotës të grimcave të ngurta në ajër. Gjenerimi i pluhurit mund të ndodhë gjithashtu për shkak të lëvizjes së trafikut; megjithatë, kjo konsiderohet si një çështje me më pak rëndësi në këto lloje aktivitetesh.

5.4. Ndikimet në Ujërat Sipërfaqësorë dhe Ujërat Nëntokësorë

Ndër ndikimet më të rëndësishme të projekteve të industrive nxjerrëse janë efektet e tyre në cilësinë e ujit dhe disponueshmërinë e burimeve ujore brenda zonës së projektit. Pasiguritë kryesore janë nëse burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore do të mbesin të pa devijuara, të pa ndotura dhe / apo të përshtatshme për konsum njerëzor (p.sh. ujërat nëntokësore), dhe nëse cilësia e ujërave sipërfaqësorë në zonën e projektit do të mbetet e përshtatshme për të mbështetur jetën ujore vendase dhe jetën e egër tokësore. Në varësi të llojit të aktiviteteve nxjerrëse ka ndikime të ndryshme në burimet ujore sipërfaqësore dhe ujore nëntokësore.

- 1) **Guroret** - shumica e problemeve me guroret shpesh lidhen me ndikimet në ujërat nëntokësore. Veçanërisht në Shqipëri, guroret ose minierat e hapura janë të vendosura në terrene të larta si kodra dhe male. Këto zona janë kryesisht larg burimeve të mëdha ujore sipërfaqësore (p.sh. lumenjtë, përrenjtë). Mund të ketë rrjedha të vogla uji në afërsi ose brenda zonës së projektit, por mundësia më e lartë e burimeve ujore që mund të gjendet në këto zona ka të bëjë me burimet e ujërave nëntokësore. Ndikimet e mundshme në burimet ujore që mund të lidhen me aktivitetet minerare të hapura/ gurore mund të përfshijnë: i) humbjen ose devijimin e burimeve ujore sipërfaqësore / ujërave nëntokësore për shkak të aktiviteteve të shpërthimit dhe gërmimit të mineraleve; ii) përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore për shkak të veprimtarive të operimit / shfrytëzimit, i cili si pasojë mund të shoqërohet me ndikime në shëndetin e njeriut në rastet kur ujërat nëntokësorë përdoren për konsum njerëzor (shumë i zakonshëm në fshatra); iii) përkeqësimin e cilësisë së ujit sipërfaqësor që mund të shoqërohet me ndikime të pafavorshme në biodiversitetin ujor.
- 2) **Minierat** - ndikimet në burimet ujore në sektorin minerar ndryshojnë për shkak të llojit të mineralit që do të nxirret dhe proceseve të prodhimit. Shumë shpesh në nxjerrjen e mineraleve, burimet e ujërave nëntokësore në zonë përdoren për proceset e prodhimit. Prodhimi i mineraleve zakonisht nuk mund të arrihet pa ujë. Prandaj, ka një ndikim në disponueshmërinë ose shfrytëzimin e burimeve të ujërave nëntokësore. Një ndikim tjetër i mundshëm lidhet me ndotjen ose përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore për shkak të aktiviteteve të gërmimit dhe shfrytëzimit. Veçanërisht në minierat nëntokësore ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe devijimin (apo

edhe humbjen) e ujërave nëntokësore parashikohen të jenë më të rëndësishme. Ndikimet në ujërat sipërfaqësorë vlerësohen gjithashtu të jenë të larta në projektet minerare nxjerrëse. Brenda zonës së projektit, mund të ketë rrjedha uji ose përrenj të cilët mund të ndikohen drejtpërdrejt nga aktivitetet e kërkimit dhe shfrytëzimit. Në afërsi të zonave të projektit mund të gjenden lumenj të cilët gjithashtu mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit. Përveç kësaj, ka ndikime të parashikuara në rrjedhjet e ujit kullues ose ujërave sipërfaqësorë. Këto ndikime janë po aq të rëndësishme për zonat minierave aktive dhe jo-aktive (të braktisura) për shkak të përqendrimit të madh të metaleve që gjenden në këto zona. Për shembull, si zonat aktive ashtu edhe ato të braktisura të minierave të qymyrit prodhojnë ujëra acide të kullimit të minierës (UAKM) të cilat mund të përmbajnë përqendrime të mëdha hekuri (si dhe metale të tjerë të rëndë). Këto ujëra me pH të ulët dhe me përqendrim të lartë të metaleve të rënda paraqesin rreze të mëdha për ndotjen e burimeve ujore nëntokësore dhe burimeve të tjera ujore sipërfaqësore. Për shembull, në vendet e zhvilluara si Mbretëria e Bashkuar, Japonia dhe SHBA, ujërat kullues që vijnë nga zonat e minierës trajtohen përmes metodave të ndryshme të trajtimit aktiv ose pasiv para se të lëshohen në mjedis. Në Shqipëri, ende nuk ka rregullore për trajtimin e ujërave të kullimit të minierave nga zonat e minierave aktive dhe / apo të braktisura.

- 3) **Nafta dhe Gazi** - ndikimet në burimet ujore në sektorin e naftës dhe gazit gjithashtu mund të ndryshojnë në varësi të proceseve nxjerrëse dhe teknologjisë së përdorur. Aktivitetet e shpimit të naftës dhe gazit mund të shkaktojnë shqetësime, humbje të burimeve të ujërave nëntokësore dhe përkeqësim të cilësisë së ujit. Aktivitetet e eksplorimit mund të përfshijnë injektimin e ujit nën tokë. Ka raste kur uji i injektuar i përdorur në proces është i kripur ose i njelmët. Kjo teknikë mund të çojë në ndikime negative në cilësinë e ujërave nëntokësore, përmes shkaktimit të prurjes së ujit të kripur ose të njelmët. Janë zhvilluar teknika të cilat përdorin ujë të pijshëm ose ujë të trajtuar për injeksion nëntokësor. Sa i përket ndikimeve të mundshme në ujërat sipërfaqësorë, derdhjet gjatë proceseve të kërkimit dhe shfrytëzimit mund të çojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe të shkaktojnë ndikime negative në biodiversitetin ujor dhe mjedisin në përgjithësi. Ndikime të tjera në burimet ujore sipërfaqësore nga sektori i naftës dhe gazit lidhen me keqAdministrimin e mbetjeve të hidrokarbureve.

5.5. Ndikimet nga Gjenerimi i Zhurmave dhe Dridhjeve/ Vibrimeve

Ndotja nga zhurmat

Ndotja nga zhurma e lidhur me industrinë nxjerrëse mund të përfshijë gjenerimin e zhurmave nga motorët e automjeteve dhe makinerive, proceset e gërmimit, ngarkimin dhe shkarkimin e shkëmbinjve në kazanë çeliku, kanalet, aktivitetet e shpërthimit dhe shpimit, aktivitetet e shfrytëzimit dhe burime të tjera të lidhura me to. Ndikimet e shumta të gërmimit, grisjes, shpimit, shpërthimit, transportit, dërrimit, bluarjes dhe grumbullimit të stoqeve mund të ndikojnë ndjeshëm në jetën e egër dhe të banorëve në afërsi, veçanërisht kur ndodhin disa procese në të njëjtën kohë. Praktika më e mirë kërkon që proceset kryesore të gjenerimit të zhurmës të mos kryhen njëkohësisht, por si procese të ndara, si dhe të kryhen brenda orëve të punës në një kohë të përshtatshme gjatë ditës (zakonisht jo koha e drekës dhe / apo natën).

Në çdo rast, duhet të ketë një dallim midis zhurmës së vazhdueshme dhe asaj të përhershme për shkak të origjinës së tyre që është e ndryshme dhe krijimit të llojeve të ndryshme të ndikimeve / shqetësimeve. Zhurmat tipike të vazhdueshme janë ato që krijohen nga trafiku i automjeteve përgjatë rrugëve kryesore në zonën e projektit. Zhurma e prodhuar zakonisht nga guroret, përpunimi i mineraleve dhe aktivitetet e naftës dhe gazit rrallë bie në këtë kategori, në përgjithësi është me ndërprerje ose edhe sporadike. Disa zhurma të vazhdueshme sidoqoftë mund të ndodhin, p.sh. nga një ekskavator që punon në gurore ose nga një nxjerrës pluhuri ose një rrip transportieri ose një aktivitet shpimi. Impiantet e përpunimit gjithashtu mund të krijojnë zhurmë të vazhdueshme, por, zakonisht mbahet nën kontroll me anë të izolimit Meqenëse kjo

zhurmë e vazhdueshme e nivelit të ulët është pjesë e zhurmës mbizotëruese të sfondit, ndikimi është zakonisht i vogël dhe i tolerueshëm.

Zhurma me ndërprerje prodhohet nga procese pune specifike: kryesisht shpërthimi, por edhe ndezja ditore e motorëve, ngarkimi i shkëmbinjve në vend depozitime, shkarkimi në hinkat e çelikut të thërmuesve primarë, etj. Nëse nuk ndjek një cikël periodik, ose kur periudha është e gjatë, mund të cilësohet si zhurmë sporadike. Për të parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e zhurmës nga aktivitetet e industrisë nxjerrëse, duhet të ketë masa specifike zbutëse në zonë dhe një plan administrimi (plani i zvogëlimit të zhurmës). Nëse nuk menaxhohen si duhet, shqetësimet nga zhurma mund të shkaktojnë shqetësime të mëdha në receptorët njerëzorë dhe jetën e egër.

Shqetësimet nga Dridhjet/ Vibrimet

Në industrinë nxjerrëse, shpërthimi (në miniera) dhe procesi i fraktimit hidraulik (naftë dhe gaz) janë burimi kryesor i dridhjeve. Pajisjet dhe makineritë e përdorura gjatë aktiviteteve të kërkimit dhe shfrytëzimit gjithashtu mund të shkaktojnë dridhje. Për shembull, shpesh herë kërkohet shpërthimi në gurore, veçanërisht para fillimit të aktiviteteve të shfrytëzimit. Kjo përfshin shpimin e vrimave të shpërthimit në shkëmb. Secila vrimë më pas mbushet me material shpërthyes, përgatitet dhe shpërthehet. Shpërthimi krijon valë dridhjeje të cilat shkaktojnë lëkundje toke të ngjashme me një ngjarje sizmike, prandaj është një proces që për një periudhë të shkurtër mund të krijojë shqetësime në receptorët njerëzorë dhe jetën e egër. Aktivitetet e shpërthimit mund të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e shtresave të tokës / shkëmbinjve dhe burimeve të ujërave nëntokësore, veçanërisht për minierat nëntokësore, ku ndikimet shpërndahen drejtpërdrejt në tokë dhe efektet e dridhjeve janë shumë më të forta sesa në minierat e hapura.

Në industrinë e naftës dhe gazit, fraktimi hidraulik ka krijuar probleme për shkak të dridhjeve. Kjo teknikë përdoret për të nxjerrë hidrokarbure duke injektuar ujë (dhe kimikate) nën presion për të thyer shkëmbinjtë dhe për të lejuar lëshimin e naftës dhe gazit në sipërfaqe. Kjo teknikë mund të shkaktojë lëvizjen e shtresave nëntokësore të tokës dhe shkëmbinjve, të cilat si pasojë mund të shkaktojnë shqetësime në tokë, lëvizje të shtresave, dridhje dhe tërmete. Përveç ndikimeve të mundshme mjedisore, dridhjet për shkak të fraktimit hidraulik mund të shkaktojnë shqetësime dhe ndikime të rënda sociale në komunitetet lokale afër zonave të shfrytëzimit të naftës dhe gazit.

Studimet tregojnë se dridhjet kanë ndikuar në qëndrueshmërinë e infrastrukturës lokale, shtëpive, ndërtesave dhe aktiviteteve rekreative të vendosura pranë operimit të industrisë nxjerrëse (guroret, minierat dhe aktivitetet e naftës dhe gazit). Tronditjet dhe dridhjet e papritura si rezultat i aktiviteteve të shpërthimit dhe / apo fraktimit hidraulik mund të çojnë në krijimin e zhurmës dhe pluhurit, dëmtimin ose shembjen e strukturave në zonat e banuara përreth dhe shqetësim të jetës së egër. Prandaj, është shumë e rëndësishme që këto aktivitete të planifikohen siç duhet, dhe të menaxhohen nga mbajtësit e lejeve. Praktika më e mirë kërkon që mbajtësit e lejeve njoftojnë në kohë komunitetin lokal para fillimit të çdo aktiviteti shpërthimi ose copëtimi ose ndonjë aktiviteti tjetër që mund të gjenerojë dridhje. Në rast të shqetësimeve nga dridhja e lartë ose shkaktimi i tërmeteve dhe dëmtimit të pronës, mbajtësi i lejes duhet të respektojë të gjitha detyrimet për kompensim siç parashikohet në ligjin ekzistues në fuqi.

5.6. Ndikimet nga Gjenerimi i Mbetjeve

Mbetjet si pasojë e operimit të industrive nxjerrëse janë ndër rrymat më të mëdha të mbetjeve në BE dhe SHBA. Minierat e hapura (guroret) dhe minierat metalore (nxjerrja e mineraleve) mund të gjenerojnë vëllime të mëdha të mbingarkesës dhe mbetjeve nga shkëmbinjtë, si dhe mbetjeve të mbetura pasi mineralet janë nxjerrë nga xeherorët. Për shembull, mbetjet nga procesi i kërkimit të aktiviteteve minerare dhe gurore, përfshirë trajtimin fizik dhe kimik të mineraleve mund të përfshijnë:

- mbetjet nga gjermimi i mineraleve;
- mbetjet nga përpunimi fizik dhe kimik i mineraleve metaliferike;
- mbetjet nga përpunimi fizik dhe kimik i mineraleve jo-metaliferike;
- baltat e shpimit dhe mbetjet e tjera të shpimit.

Në guroret e gurit gëlqeror shumica e materialeve të gjeneruar përfshijnë shtresa toke dhe shkëmbinj të tokës së sipërme dhe të mbingarkesës, megjithatë këto materiale mund të ripërdoren lehtësisht gjatë fazës së rehabilitimit të vendit ose edhe si materiale përzierjeje gjatë thërrmimit ose thyerjes së shkëmbinjve. Përgjithësisht guroret e gurit gëlqeror nuk prodhojnë vëllime të mëdha mbetjesh, pasi të gjitha materialet e gjeneruar zakonisht shfrytëzohen dhe (ri) përdoren për qëllime të projektit.

Në minierat e mineraleve, mund të ketë sasi të mëdha të mbetjeve të gurëve dhe mbetjeve pas nxjerrjes së xeheve. Këto mbetje mund të dëmtojnë mjedisin, të ndotin burimet ujore dhe të shkaktojnë dëme në biodiversitetin për shkak të përbërjes së tyre dhe pranisë së metaleve toksike si hekuri, zinku, arseniku, kadmiumi, etj. Grumbullimi i këtyre mbetjeve pa Menaxhimin e duhur ose depozitimin në vendet e miratuara mund të shkaktojë probleme të rënda mjedisore. Kur uji i shirave bie në kontakt me mbetje të tilla, krijon ujëra të ndotura kulluese që mund të përmbajnë përqendrimet e larta të metaleve të rënda, të cilat paraqesin rreziqe për ndotjen e burimeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në BE, mbetjet shkëmbore dhe mbetjet minerale shpesh klasifikohen si mbetje të rrezikshme, prandaj asgjësimi i tyre shoqërohet me kosto të larta të funksionimit dhe transportit.

Në sektorin e naftës dhe gazit ndotja mund të ndodhë gjatë aktiviteteve të kërkimit dhe shfrytëzimit. Pasi nxirren, substancat hidrokarbure konsiderohen si materiale të rrezikshme për shkak të përbërjes së tyre dhe vetive toksike që mund të shkaktojnë dëme dhe / apo ndotje të mjedisit (në burimet ujore, biodiversitet) dhe mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Derdhjet aksidentale mund të shkaktojnë ndikime të mëdha në mjedis. Toka e ndotur me substanca hidrokarbure konsiderohet si mbetje e rrezikshme dhe duhet të menaxhohet dhe asgjësohet si duhet në përputhje me kërkesat ligjore në zonat e dedikuara të depozitimit ose në landfille. Materialet e tjera të rrezikshme siç janë pajisjet e vjetra, makineritë, depozitat e magazinimit dhe substanca të tjera konsiderohen gjithashtu mbetje të rrezikshme. Përgjithësisht këto mbetje mund të ndoten me substanca hidrokarbure dhe kimikate të tjera. Në Shqipëri, ka shumë zona të "nxehta" si Marinza, Ballshi, Kucova, etj., që paraqesin rreziqe mjedisore dhe sociale për shkak të pajisjeve të vjetra të shpimit të hidrokarbureve të lëna në zonë, derdhjeve të hidrokarbureve dhe / apo llojeve të tjerë të materialeve të rrezikshëm të braktisur nga aktivitetet e mëparshme industriale nxjerrëse. Shpesh këto materiale dhe substanca të rrezikshme paraqesin shqetësime të mëdha për komunitetin lokal për shkak të çlirimit të mundshëm të aromave, kontaminimit të burimeve ujore dhe tokës, veçanërisht gjatë periudhës së verës. Mbajtësit e lejeve duhet të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe të sigurojnë menaxhim të praktikës më të mirë për asgjësimin, trajtimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktivitetet e tyre.

5.7. Ndikimet në Infrastrukturë dhe Trafik

Ndikimet në infrastrukturë dhe trafik mund të jenë pozitive dhe negative. Guroret, minierat dhe projektet e naftës dhe gazit mund të çojnë në ndërtimin e infrastrukturës së re siç janë rrugët dhe urat, apo të përmirësojnë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës rrugore. Kompanitë që veprojnë në minierat dhe industrinë e naftës dhe gazit shpesh angazhohen për të përmirësuar infrastrukturën lokale dhe të investojnë në zonën e projektit (p.sh. ndërtime të reja ose rinovimi i qendrave shëndetësore, shkollave, rrjeteve të furnizimit me ujë, etj.). Kjo qasje shpesh është e mirëpritur nga komuniteti lokal dhe ofron mundësi të mira për zhvillimin e një zone si dhe promovimin e iniciativave të reja të biznesit.

Sidoqoftë, ka shumë raste të tjera kur kompania nuk ofron investime lokale në zonë, por përdor infrastrukturën ekzistuese lokale. Në këto raste, infrastruktura lokale rrezikon të përkeqësohet më shpejt me kalimin e kohës për shkak të rritjes së lëvizjes së trafikut. Trafiku i rritur mund të jetë gjithashtu një problem në zonat e projektit të industrive nxjerrëse. Shqetësimi nga trafiku është për shkak të vëllimit më të lartë të makinave, kamionëve dhe transferimit të mineraleve midis vendeve të nxjerrjes dhe përpunimit. Përgatitja e një plani menaxhimi të trafikut është praktika më e mirë për të siguruar sigurinë e transportit për punonjësit, komunitetin dhe vizitorët, dhe për të shmangur shqetësimet e mundshme gjatë zbatimit të projektit.

5.8. Ndikimet në Komunitetin Lokal

Ndikimet sociale në komunitetet lokale ku ndodhen gurore, miniera të përmasave të mëdha dhe projekteve të naftës dhe gazit janë të diskutueshme dhe komplekse. Zhvillimi i industrive nxjerrëse mund të krijojë pasuri, rritje ekonomike, punësim në një nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, por gjithashtu mund të shkaktojë shqetësime të konsiderueshme veçanërisht kur nuk ndiqen praktikatat e mira gjatë gjithë kohës. Projektet e industrive nxjerrëse mund të krijojnë vende të reja pune, rrugë, shkolla, të promovojnë nisma biznesi dhe të rrisin kërkesat për mallra dhe shërbime në zona të largëta ose të varfra, por përfitimet dhe kostot mund të ndahen në mënyrë të pabarabartë. Nëse komunitetet mendojnë se po trajtohen padrejtësisht ose dëmshpërblehen në mënyrë jo të duhur, projektet e industrive nxjerrëse mund të krijojnë tension shoqëror dhe në raste ekstreme, konflikte të dhunshme. Bilanci midis ndikimeve pozitive dhe negative në komunitetet lokale varet nga sa mbajtësi i lejes përmbush angazhimet e tij të detyrueshme dhe vullnetare mjedisore dhe sociale.

5.9. Rastet e Mospërputhjes së Industrive Nxjerrëse në Shqipëri

Industritë nxjerrëse janë ndër sektorët më kompleksë për tu menaxhuar dhe monitoruar nga autoritetet qeveritare. Në Shqipëri, nxjerrja e lëndëve të para (p.sh. gur gëlqeror) nga guroret është një veprimtari e rëndësishme ekonomike dhe e përhapur në të gjithë vendin, e cila ka ekzistuar që nga kohërat historike. Sidoqoftë, përkundër kontributit të tij drejt zhvillimit ekonomik, mund të ndodhin disa ndikime të pafavorshme, veçanërisht kur nxjerrja kryhet pa planifikimin e duhur dhe përdorimin e teknologjisë moderne dhe metodave dhe planeve jo të duhura të menaxhimit. Mungesa e masave të duhura të rehabilitimit është dështimi më i zakonshëm i mbajtësve të lejeve ekzistuese që operojnë gurore në Shqipëri. Disa raste të praktikës së dobët janë identifikuar në rajonet e Malit të Tomorit, Fushë-Krujës dhe Urës-Vajgurore. Që nga viti 2017, MTM dhe AKM kanë kryer një monitorim të rregullt të guroreve të vendosura në këto rajone dhe kanë pezulluar lejet mjedisore të një numri operatorësh të guroreve për një periudhë të pakufizuar kohore. Sidoqoftë, një numër i konsiderueshëm i kompanive janë ende duke operuar në këto zona, duke shkaktuar ndikime të mëdha në mjedis dhe ndikime të pafavorshme sociale në komunitetet lokale. Deri më tani nuk ka pasur asnjë vlerësim të plotë të ndikimeve mjedisore dhe sociale të këtyre guroreve nga autoritetet qeveritare. Megjithatë kjo paraqet një sfidë të vërtetë, EITI Shqipëri potencialisht mund të ofrojë një perspektivë të ndryshme të “praktikave më të mira” të zbatuara në sektorin e minierave sipërfaqësore (guroreve) dhe të kontribuojë në përmirësimin e situatës aktuale përmes bashkëpunimit me autoritetet kryesore mjedisore.

6. Rasti Studimor 1 - Albchrome

6.1. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit

Albchrome shpk zhvillon aktivitete minerare në rajonin e Bulqizës. Kompania kryen nxjerrjen e mineralit të kromit përmes minierave nëntokësore në Bulqizë. Zona e projektit u hap fillimisht në 1948 gjatë periudhës komuniste dhe ka vazhduar të përdoret dhe operohet pa ndërprerje për më shumë se 72 vjet. Zona e projektit e miratuar për shfrytëzim është 3.506 km² (tunele nëntokësore) dhe kapaciteti i parashikuar është 120,000 ton / vit. Përveç minierave nëntokësore të Bulqizës, Albchrome administron dhe operon asete të tjera të tilla si: impianti i pasurimit në Bulqizë, impianti i përzgjedhjes në Klos, Mat dhe dy fabrika të shkrirjes së ferro-kromit në Elbasan dhe Burrel. Sidoqoftë, objekt i këtij rasti studimor është vetëm miniera nëntokësore e Bulqizës.



Figura 9. Vendndodhja e zonës minerare të operuar nga Albchrome

6.2. Përshkrimi i kontratës, lejeve, licencave të marra

Miniera nëntokësore e Bulqizës është pjesë e një numri asetesh të tjera nën administrim të Albchrome shpk, kjo e fundit në pronësi 100% nga Grupi BALFIN, një kompani shqiptare me aktivitete të ndryshme tregtare në të gjithë vendin dhe Ballkanin.

6.2.1. Marrëveshja e Konçesionit

Ndërsa Albchrome shpk u krijua në 1991 si një kompani tregtare që zotëron asetet kryesore të industrisë së kromit, në 2000 dhe 2001, aktivet më të rëndësishme si minierat e kromit në Bulqizë dhe Prrenjas, ajo e shkrirjes së hekurit në Elbasan dhe Burrel, si dhe impianti i pasurimit në Bulqizë, impianti i përzgjedhjes në Klos ju dhanë përmes marrëveshjeve të konçesionit një kompanie private, DARFO Spa. Në vitin 2009 kompania iu shit një kompanie ruso-austriake, e cila e shiti përsëri kompaninë tek Balfin Group në 2013.

Minierat e kromit të Prenjas dhe Pojska dhe shkrirja e ferro-kromit në Elbasan u dha me Marrëveshjen e Konçesionit të miratuar nga Parlamenti me Ligjin nr.8590, datë 23.03.2000 të ndryshuar me Ligjin nr.80 / 2016, ndërsa miniera e kromit dhe impianti i pasurimit të Bulqizës, dhe uzina e shkrirjes në Burrel u dha me marrëveshjen e konçesionit të miratuar nga Parlamenti me Ligjin nr.8791, datë 10.05.2001 të ndryshuar me Ligjin Nr.79 / 2016.

Bazuar në marrëveshjet e ndryshuara të konçesionit të bëra në 2016, të gjitha asetet do të përdoren nga Albchrome për një afat deri në 31 Dhjetor 2040. Marrëveshjet e konçesionit parashikojnë se pas përfundimit të afatit të konçesionit të gjitha pasuritë do të transferohen Qeverisë.

Duhet theksuar se të dy marrëveshjet e konçesionit nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që përcakton ndonjë kërkesë mjedisore për shoqërinë.

6.2.2. Leja Mjedisore

Bazuar në legjislacionin mjedisor, të gjitha aktivitetet e kryera nga Albchrome duhet të kryhen me leje specifike mjedisore. Konsulentët kanë verifikuar se shoqëria ka marrë për çdo aktivitet një leje specifike mjedisore siç jepet më poshtë:

- Leje Mjedisi e tipit B për minierën nëntokësore të kromit të Bulqizës me nr.1450, datë 12.09.2013 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- Leje Mjedisore e tipit B për impiantin e pasurimit në Klos, Mat me nr.1450, datë 12.09.2013.
- Dy Leje Mjedisi të tipit A për dy impiantet e shkrirjes në Elbasan dhe Burrel, përkatësisht me PN-1531-12-2015, datë 04.10.2019 për fabrikën e shkrirjes Elbasan dhe PN-0855-09-2015, datë 16.09.2015 për fabrikën e shkrirjes Burrel.

Përshkrimi i shkurtër i kërkesave kryesore të Lejes Mjedisore për minierën nëntokësore të kromit Bulqizë.

Leja Mjedisore e tipit B lëshohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për veprimtarinë e shfrytëzimit të mineralit të kromit me galerinë e minierave nëntokësore. Leja lëshohet për një afat të papërcaktuar, prandaj është në fuqi deri në fund të veprimtarisë tregtare të kompanisë (31 dhjetor 2040).

Leja përmban një numër kushtesh dhe detyrimesh specifike që duhet të respektohen nga mbajtësi i lejes.

a) Detyrimet e monitorimit dhe raportimit të mjedisit

Leja përcakton se Shoqëria, duke përdorur ekspertët e saj të brendshëm apo burime të huaja të kontraktuara, duhet të kryejë vetë-monitorimin mjedisor të veprimtarisë, i cili do të kryhet bazuar në programin e monitorimit. Programi i vetë-monitorimit duhet të mbulojë çështjet e mëposhtme:

- Monitorimi i ndikimeve të mundshme në mjedis dhe elementet e tij që mund të lindin si rezultat i veprimtarisë minerare;
- Monitorimi i zbatimit të termave dhe kushteve të lejeve mjedisore;
- Monitorimi i progresit të masave rehabilituese dhe efektiviteti i tyre;
- Raportimi i të dhënave mjedisore tek autoritetet shtetërore, AKM dhe MTM.

Leja përcakton një numër kërkesash për raportimin e të dhënave mjedisore, duke përfshirë:

- Mbajtësit të lejes i kërkohet të kryejë një vlerësim mjedisor periodik të aktiviteteve të tij jo më pak se një herë në tre muaj;
- Mbajtësi i lejes duhet të përgatisë një regjistër të veçantë për ruajtjen e informacionit për monitorimin e mjedisit;
- Të dhënat e vetë-monitorimit do t'u dorëzohen autoriteteve mjedisore çdo tre muaj për periudhën e ndërtimit dhe çdo gjashtë muaj gjatë fazës së shfrytëzimit;

- Mbajtësi i lejes duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Mjedisit për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji ose operim, të cilat nuk janë paraqitur në Raportin e VNM-së;
- Mbajtësi i lejes duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për çdo aksident nëse situata emergjente ka ndikim negativ në mjedis;
- Mbajtësi i lejes duhet të trajtojë të gjithë punonjësit dhe t'i njoftojë ata mbi termat dhe kushtet e lejes.

b) Menaxhimi i mbetjeve minerare

Duke pasur parasysh specifikat e aktiviteteve minerare, leja përcakton një numër kërkesash për menaxhimin e mbetjeve që vijnë si rrjedhojë e aktivitetit minerar të mbajtësit të lejes. Leja kërkon që mbetjet të përdoren për aktivitetin e minierave sa herë që është e mundur. Në rast se kjo nuk është e mundur, Mbajtësi i Lejes do të bjerë dakord me Autoritetin Lokal dhe Drejtorinë Rajonale të Mjedisit për vendet ku do të depozitohen mbetjet.

c) Kushte të tjera

Leja përmban gjithashtu një numër kushtesh të tjera, përfshirë pagesën e një tarife shërbimi vjetor prej 5,000 Lek dhe sanksione administrative të zbatuara nga autoritetet në rast të shkeljes së termave dhe kushteve të Lejes Mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

Sidoqoftë është e rëndësishme të theksohet se Leja Mjedisore nuk përcakton ndonjë kufi specifik për emetimet në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës të cilat mund të ndikohen gjatë aktiviteteve minerare.

6.3. Ndikimet kryesore mjedisore, sociale dhe kumulative

Shoqëria ka kryer një studim paraprak të VNM-së sipas legjislacionit shqiptar. Ndikimet mjedisore, sociale dhe kumulative janë vlerësuar brenda raportit të VNM-së. Ndikimet kryesore siç pasqyrohen në raportin e VNM përfshijnë: ndikimet në biodiversitetin, ajrin, burimet ujore (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore), tokën dhe gjeologjinë, nga zhurmat dhe dridhjet, peizazhin / dhe mjedisin vizual dhe mbetjet. Tabela 5 më poshtë jep një përmbledhje të ndikimeve të mundshme të aktivitetit.

Tabela 5. Përmbledhje e ndikimeve të mundshme të adresuara në raportin paraprak të VNM-së

Nr.	Aspekti mjedisor / social	Ndikimet/Ndërlikimet
1.	Biodiversiteti	Hegja e bimësisë (kjo përbën një problem të vogël pasi zona është përdorur për disa vjet dhe bimësia ishte hequr që në momentin e hapjes së zonës së projektit). Shqetësimi i specieve të faunës për shkak të lëvizjes së automjeteve, punimeve të shfrytëzimit si rrjedhojë e përdorimit të makinerive dhe pajisjeve të punës.
2.	Ajri	Emetimet e pluhurave nga aktivitetet e shpimit ose shpërthimit (kur është e nevojshme) dhe lëvizja e automjeteve në zonë. Emetimet e gazeve nga motorët e automjeteve dhe makinerive.
3.	Uji	Nuk ka ndikim të rëndësishëm në trupat ujorë sipërfaqësorë. Ndikime të mundshme nga rrjedhjet e ujërave sipërfaqësore në zonën e projektit. Ndikime të mundshme në burimet ujore nëntokësore për shkak të punimeve të gërmimit për xeherorin e kromit.

Nr.	Aspekti mjedisor / social	Ndikimet/Ndërlikimet
		Ndikimet e mundshme nga derdhjet që mund të ndodhin gjatë operimit në rast të ngjarjeve të paplanifikuara.
4.	Toka dhe Gjeologjia	Gërmimi i tuneleve nëntokësore. Ndikimet e mundshme nga derdhjet që mund të ndodhin gjatë operimit në rast të ngjarjeve të paplanifikuara.
5.	Zhurmat dhe dridhjet	Zhurmat dhe dridhjet nga aktivitetet e shpimit dhe shpërthimit (kur është e nevojshme). Gjenerimi i zhurmave nga aktivitetet e kërkimit dhe shfrytëzimit, si dhe nga lëvizja e automjeteve.
6.	Mbetjet	Gjenerimi i mbetjeve minerale dhe mbetjeve metalike nga aktivitetet e operimit. Ndikimet e mundshme nga keqmenaxhimi i mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme të mundshme të krijuara gjatë aktiviteteve të operimit.
7.	Peizazhi dhe mjedisi vizual	Ndikimet vizuale dhe në peizazh janë identifikuar. Zona e projektit është përdorur për më shumë se 72 vjet, së pari nga shteti (gjatë periudhës komuniste) dhe tani nga Albchrome (shoqëri private).
8.	Ndikimet kumulative	Ndikimet në peizazh dhe aspektet vizuale janë identifikuar, sepse në zonë ka disa shoqëri të tjera që operojnë gjithashtu në aktivitete të minierave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

6.4. Masat zbutëse dhe monitoruese

Albchrome ka përgatitur një Plan të Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit, i cili adreson të gjitha masat përkatëse zbutëse që do të ndërmerren për të përmbushur detyrimet në përputhje me ligjin Shqiptar dhe kërkesat e Lejes Mjedisore. Shoqëria ka një departament të dedikuar që menaxhon të gjitha çështjet në lidhje me aspektet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë. Leja Mjedisore përcakton detyrimet e shoqërisë në lidhje me performancën mjedisore gjatë operimit. Mbajtësi i lejes (Albchrome shpk) është i pajisur me të gjitha dokumentet e kërkuara nga leja e mjedisit, siç renditet në seksionin 4.3.4. më sipër (Detyrimet mjedisore dhe rehabilituese sipas kontratës, lejes dhe ligjit).

Albchrome përgatit një raport të Monitorimit të Mjedisit çdo 6-muaj, i cili paraqet matjet përkatëse mbi cilësinë e ajrit, cilësinë e ujërave dhe parametrat e zhurmës dhe dridhjeve. Këto matje kryhen nga një laborator i akredituar, palë e tretë, i cili shqyrton dhe vlerëson nivelet e matura dhe konfirmon se ato janë në përputhje me normat e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar. Lidhur me mbetjet, Albchrome ka kontraktuar shoqëri të licencuara riciklimi që transportojnë, ruajnë, asgjësojnë dhe riciklojnë mbetje jo të rrezikshme dhe të rrezikshme të krijuara gjatë aktiviteteve të operimit. Albchrome ka përgatitur gjithashtu një Plan të detajuar të Rehabilitimit, i cili zbatohet në baza periodike dhe rishikohet çdo vit, sipas kërkesave të legjislacioni shqiptar.

6.5. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore

Mbajtësi i lejes, Albchrome shpk, përputhet plotësisht me kërkesat dhe detyrimet ligjore shqiptare të përcaktuara në Lejen Mjedisore. Sidoqoftë, për një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, mbajtësi i lejes mund të zhvillojë një politikë të re mjedisore dhe sociale me synim zbatimin e standardeve të performancës së IFC dhe kornizën mjedisore dhe sociale të

Bankës Botërore. Kjo qasje do t'i ndihmojë ata të vendosin objektiva të reja drejt një zbatimi më të qëndrueshëm të projektit dhe të sigurojë që ata të vazhdojnë të përmbushin praktikat më të mira ndërkombëtare. Për shembull, një objektivi i ri mund të lidhet me tejkalimin e detyrimeve ligjore shqiptare në Planin e Rehabilitimit në lidhje me gjelbërimin dhe restaurimin e zonës.

7. Rasti Studimor 2 - Antea Cement

7.1. Përshkrimi i aktiviteteve të projektit

Antea Cement shpk, pjesë e Titan Group, ka ndërtuar një fabrikë çimentoje në zonën e quajtur “Boka e Kuqe”, Borizanë, Shqipëri. Projekti u financua nga BERZH dhe IFC, të cilat investuan rreth 40% të kostove kapitale dhe Titan Group 60% të kostove të përgjithshme. Aktualisht, Titan Group është aksioneri dhe operatori i vetëm i Antea Cement. Prodhimi ditor i impiantit të çimentos është 3,300 ton klinker në ditë. Impianti përdor lëndë të parë nga gurorja e gurit gëlqeror (minierë sipërfaqësore) e treguar në Figurën 10 më poshtë. Shfrytëzimi i gurores nisi në vitin 2008 kur Antea Cement filloi prodhimin. Gurorja ka një sipërfaqe totale prej 0.988 km² dhe prodhon afërsisht 1.4 milion ton / vit.



Figura 10. Vendndodhja e gurores “Boka e Kuqe”, Antea Cement

7.2. Përshkrimi i kontratës, lejeve, licencave të marra

7.2.1. Lejet minerare

Antea Cement ka filluar aktivitetin e saj tregtar në Shqipëri në vitin 2007. Me qëllim përdorimin e mineraleve flish dhe gur gëlqeror, kompania nënshkroi një marrëveshje specifike minerare, e cila u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr.9813, datë 01.10.2007. Marrëveshja e shfrytëzimit të minierave është dokumenti kryesor ligjor për veprimtarinë minerare të Antea Cement, i cili u bazua në Ligjin e mëparshëm të Minierave (Ligji nr. 7796, datë 17.02.1994) me një afat prej 99 vjetësh. Sipas ligjit, marrëveshje të tilla afatgjata minerare ishin të justifikuara në rastet e një **investimi të rëndësishëm** që investitori do të bënte për përdorimin e mineraleve të nxjerra, i ngjashëm me rastin e investimit të bërë nga Antea Cement për ndërtimin dhe funksionimin e fabrikës së çimentos .

Shoqëria gjithashtu ka marrë në 2007 dy leje minerare për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, flish dhe argjilë, përkatësisht nr. 988/1 dhe 987/1, të cilat u rinovuan për një periudhë tjetër 10 vjeçare 2017. Siç ishte rasti me Albchrome, as marrëveshja kryesore e shfrytëzimit të minierave dhe as dy lejet e reja të minierave nuk përmbajnë ndonjë dispozitë ose kusht në lidhje me ndikimin në mjedis.

7.2.2. Lejet Mjedisore

Për shkak të aktiviteteve të ndryshme që kryhen, shoqëria ka marrë dhe posedon një numër lejesh mjedisore për aktivitete të ndryshme, përfshirë aktivitetet minerare, instalimet teknologjike për djegien e lëndëve të para dhe prodhimin e klinkerit.

Ky rast studimor është përqendruar në aktivitetin e minierave sipërfaqësore (gurore) të Antea Cement. Për aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve gëlqerorë në guroren kryesore, fillimisht kompania mori Lejen e Mjedisit PN-0570-07-2010, datë 05.07.2010. Leja u lëshua për një afat kohor të papërcaktuar.

Meqënëse leja fillestare ishte lëshuar bazuar në ligjin e mëparshëm për mjedisin (Ligji nr. 8934, datë 5.09.2002), pas miratimit të legjislacionit të ri mjedisor, leja mjedisore u përditësua dhe leja e re mjedisore e tipit B Nr.5595, datë 01.9.2016 është lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Leja Mjedisore është e vlefshme për të gjithë periudhën që mbulon Marrëveshja e Shfrytëzimit të Minierave e miratuar me Ligjin nr.9813, datë 01.10.2007.

Leja e re përmban një numër kushtesh dhe detyrimesh që mbajtësi i lejes duhet të respektojë gjatë aktivitetit. Më poshtë jepen termat dhe kushtet kryesore të lejes:

✓ Trajnimi i punonjësve

Mbajtësi i lejes duhet të trajnojë të gjithë punonjësit në lidhje me kërkesat e lejes mjedisore dhe legjislacionit.

✓ Regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve dhe dokumentacioni i informacionit mjedisor

Mbajtësi i lejes duhet të përgatisë dhe mirëmbajë një regjistër për mbajtjen e të gjitha shkarkimeve dhe transferimin e ndotësve dhe dokumentacionin për çdo informacion mjedisor. Regjistri i shkarkimeve do të përgatitet dhe dorëzohet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda tre muajve nga lëshimi i lejes.

✓ Plani i përputhshmërisë dhe programi kohor

Leja përcakton se shoqëria duhet të zbatojë Planin e Përputhshmërisë së bashku me programin kohor, i cili përcaktohet në afatin e lejeve. Plani përmban një numër veprimesh dhe masash së bashku me buxhetin e nevojshëm për t'u shpenzuar nga shoqëria.

✓ Kufizimet e shkarkimeve të ujit dhe niveleve të zhurmës

Leja përcakton një numër kufizimesh për shkarkimet në ajër, në kanale dhe ujëra sipërfaqësorë dhe për nivelet e zhurmës. Leja kërkon që shkarkimet mesatare ditore të mos jenë më të larta se kufijtë e vendosur në leje, ndërsa nivelet e zhurmës duhet të jenë gjithmonë më të ulëta se ato të përcaktuara në legjislacion. Matja e nivelit të shkarkimeve dhe zhurmës do të duhet të bëhet nga një laborator i akredituar.

✓ Menaxhimi i mbetjeve

Leja përmban disa terma dhe kushte për menaxhimin e mbetjeve që vijnë si rrjedhojë e aktiviteteve minerare dhe fuqisë punëtore të kompanisë.

✓ Përdorimi i lëndëve të para dhe energjisë

Leja kërkon që shoqëria të përdorë me efikasitet lëndët e para dhe energjinë. Kërkon që një raport i auditimit duhet të përgatitet për përdorimin e lëndës së parë dhe energjisë, përfshirë masat për zvogëlimin e konsumit të energjisë. Raporti i auditimit do të përfshihet në raportin vjetor mjedisor të ndërmarrjes.

✓ **Monitorimi mjedisor**

Leja kërkon nga Kompania që të gjithë parametrat mjedisorë të vendosur në leje të monitorohen vazhdimisht. Shoqëria duhet të marrë mostra, të bëjë matje dhe prova për këto parametra.

✓ **Dokumentimi dhe raportimi**

Kompanisë i kërkohet të mbajë rezultatet e monitorimit të mjedisit dhe t'i dërgojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo 6 muaj raporte për nivelet e shkarkimeve në ajër, shkarkimet e ujërave në kanalizime dhe në ujërat sipërfaqësore. Kompanisë i kërkohet gjithashtu të përgatisë një Program të Monitorimit të Zhurmës dhe një Plan të Monitorimit të Mjedisit brenda tre muajve nga data e lëshimit të lejes.

Shoqërisë i kërkohet gjithashtu të paraqesë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit një raport vjetor mjedisor. Raporti përfshin të gjithë informacionin e mbledhur dhe të grumbulluar gjatë vitit në përputhje me kërkesat e lejes dhe legjislacionit mjedisor.

✓ **Incidentet dhe situatat emergjente**

Kompanisë i kërkohet që brenda katër muajve nga data e lëshimit të lejes të përgatisë dhe miratojë një dokument të politikës për parandalimin e incidenteve dhe aksidenteve me ndikim në mjedis, ndërsa brenda 6 muajve duhet të përgatisë dhe miratojë procedurën e trajtimit për rastet e incidenteve dhe situatave emergjente.

✓ **Mbyllja, rehabilitimi dhe kontrolli pas përfundimit të aktivitetit**

Leja përmban disa terma dhe kushte për mbylljen dhe rehabilitimin e zonës së ndikuar nga aktiviteti. Plani i rehabilitimit të gurores përditësohet çdo vit dhe miratohet nga AKM.

✓ **Kushte të tjera**

Leja përmban gjithashtu një numër kushtesh të tjera përfshirë pagesën e një tarife shërbimi vjetor prej 5,000 Lek dhe sanksione administrative të zbatuara nga autoritetet në rast të shkeljes së termave dhe kushteve të Lejes Mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

7.3. Ndikimet kryesore mjedisore, sociale dhe kumulative

Antea Cement ka përgatitur një VNMS të thelluar për guroren e gurit gëlqeror në përputhje me kërkesat legjislative shqiptare dhe standardet ndërkombëtare (BERZH, IFC). Ndikimet mjedisore, sociale dhe kumulative janë shqyrtuar plotësisht në raportin e VNMS-së. Tabela 6 më poshtë jep një përmbledhje të ndikimeve të mundshme të gurores gëlqerore të adresuara në raportin e thelluar të VNMS-së.

Tabela 6. Përmbledhje e ndikimeve të mundshme të adresuara në raportin paraprak të VNM-së

Nr.	Aspekti mjedisor / social	Ndikimet/Ndërlikimet
1.	Biodiversiteti	Heqja e vegjetacionit brenda kufijve të zonës së gurores. Shqetësimi i specieve të faunës për shkak të lëvizjes së automjeteve, punimeve të gërmimit përmes makinerive të rënda dhe pajisjeve të tjera.
2.	Ajri	Emetimet e pluhurave nga aktivitetet e shpërthimit (kur është e nevojshme), dhe lëvizja e automjeteve përgjatë rrugës hyrëse. Emetimet e gazit nga motorët e automjeteve dhe makinerive.

Nr.	Aspekti mjedisor / social	Ndikimet/Ndërlikimet
3.	Uji	Nuk ka ndikime të rëndësishme në ujërat nëntokësore dhe burimet ujore sipërfaqësore.
4.	Toka, Gjeologjia dhe Erozioni	Asnjë ndikim i rëndësishëm në cilësinë e tokës pasi zona është e përbërë kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë. Potencialisht rrezik i mundshëm i erozionit të tokës për shkak të punimeve të gërmimit.
5.	Zhurmat dhe Dridhjet	Zhurmat dhe dridhjet nga gërmimet dhe aktivitetet e shpërthimit (kur është e nevojshme). Gjenerimi i zhurmave nga lëvizja e automjeteve dhe makinerive të rënda gjatë operimit.
6.	Mbetjet	Gjenerimi i mbetjeve inerte nga aktivitetet e operimit. Ndikimet e mundshme nga keqmenaxhimi i mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme të mundshme të krijuara gjatë aktiviteteve operuese.
7.	Peizazhi dhe mjedisi vizual	Ndikimet në peizazh dhe pamjes vizuale janë identifikuar. Zona e projektit do të përdoret për shumë vite, pasi Titan Group dhe Antea Cement shpk kanë një kontratë për shfrytëzimin e zonës për 99 vjet.
8.	Ndikimet kumulative	Ndikimet vizuale dhe në peizazh për shkak të punimeve të gërmimeve dhe ndryshimeve në topografi. Në rast të keqmenaxhimit mund të ketë ndikime të mundshme kumulative në cilësinë e ajrit për shkak të afërsisë me fabrikën kryesore të prodhimit të çimentos.

7.4. Masat zbutëse dhe monitoruese

Përveç kërkesave ligjore shqiptare, Antea Cement zbaton standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira për fabrikën e prodhimit të çimentos dhe guroren e gurit gëlqeror. Shoqëria zbaton plotësisht kërkesat e ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social përfshin procedurat e mëposhtme, raportimin, nënplanet dhe masat zbutëse:

- Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Cilësisë së Ajrit;
- Menaxhimi i Zonës së Projektit të Gurores Gëlqerore;
- Monitorimi i Zhurmave;
- Menaxhimi i Energjisë;
- Menaxhimi Emetimeve të Pikave/Stacioneve;
- Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta dhe të Lëngshme;
- Monitorimi i Dridhjeve/ Vibrimeve;
- Menaxhimi i Tokës, Ujërave Sipërfaqësore dhe Ujërave Nëntokësore;
- Menaxhimi i Aspekteve të Peizazhit dhe Pamjes Vizuale;
- Menaxhimi i Burimeve Ujore, përfshirë ujërat nëntokësore, menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura;
- Regjistri i shkarkimeve të ndotësve (ajri, uji dhe toka);
- Planifikim afatshkurtër dhe afatgjatë për shfrytëzimin e gurores;
- Regjistri i ankesave dhe Plani i angazhimit me palët e interesit;
- Plani i Veprimeve Korrigjuese;
- Trajnim për çështje mjedisore dhe sociale;

- Plani i Parandalimit dhe Menaxhimit të Ndotjes;
- Plani i Emergjencës;
- Plani i Rehabilitimit dhe Rikuperimit;
- Dokumentacioni - raportimi periodik në AKM dhe DRM.

Raporti i Monitorimit të Mjedisit për guroren e gurit gëlqeror kryhet çdo 6-muaj në përputhje me kërkesat e Lejes Mjedisore. Plani i rehabilitimit dhe rikuperimit të gurores është një nga pikat kryesore të Antea Cement. Gurorja menaxhohet, shfrytëzohet dhe kthehet në gjendjen e mëparshme përmes një plani shumë të saktë dhe të detajuar. Zbatimi i aktiviteteve rehabilituese përfshin hapat e mëposhtëm:

- 1) Mbushja e tarracave me dhe vegjetal** - përdorimi i tokës sipas specifikimeve (trashësia, lloji i tokës dhe mbushja me material inert) të përshkruara në studimin VNMS dhe praktikave më të mira;
- 2) Ri-vegjetacioni dhe mbjellja** - vlerësimi i zgjedhjeve për përzgjedhjen e bimëve dhe sipërfaqes sipas nevojës së vendit për rehabilitim;
 - a) Përdorimi i llojit të bimësisë vendase;
 - b) Për strukturat, një kombinim i shkurreve dhe pemëve;
 - c) Për shpatet, *hydroseeding* (mbjellje në të njomë) dhe bimë të tjera që mund të mbajnë tokën dhe të parandalojnë erozionin;
 - d) Për rrugën hyrëse, pemë të larta;
- 3) Periudha e mbjelljes** - mbjellja zakonisht kryhet nga dhjetori në shkurt, para fillimit të reshjeve dhe pranverës;
- 4) Mirëmbajtja e bimëve** - përveç kërkesave të standardeve shqiptare, kompania zbaton praktikën më të mira për frekuencën e ujitjes, sasinë e ujit të nevojshëm dhe fertilizimin periodik.
- 5) Mbrojtja e zonave të rehabilituara** - zonat e mbjella mbrohen nga dëmtimet e mundshme nga kafshët që ushqehen me bimë. Kur është parë e përshtatshme, në zonën e projektit, është vendosur një rrjetë rrethimi për të parandaluar shqetësime dhe dëmtime të mundshme të zonave të mbjella.

7.5. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore

Mbajtësi i lejes, Antea Cement shpk, përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira për shfrytëzimin e gurores gëlqerore, duke tejkaluar kërkesat dhe detyrimet ligjore shqiptare të përcaktuara në Lejen Mjedisore. Plani i Menaxhimit të Kantierit, Plani i Rehabilitimit dhe Restaurimit të gurores zbatohen sipas standardeve më të larta. Gurorja e Antea Cement mund të konsiderohet një shembull i praktikës më të mirë në Shqipëri.

8. Referencat

Bazat e minierave dhe përpunimit të mineraleve <https://www.pwc.com/gx/en/mining/school-of-mines/2012/pwc-basics-of-mining-2-som-mining-methods.pdf>

Bib.Minierave: Një bibliotekë e problemeve të minierave të hapura
https://www.researchgate.net/publication/257516250_MineLib_A_library_of_open_pit_mining_problems
<https://theconversation.com/uk-governments-fracking-ban-has-a-convenient-loophole-126475>
<https://www.bbc.co.uk/news/business-50267454>

Industritë Nxjerrëse dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm - Një Vlerësim i Përvojës së Grupit të Bankës Botërore
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/579221468328166526/pdf/32671.pdf>

Kërkesat ISO 14001:
https://www.british-assessment.co.uk/insights/what-are-the-iso-14001-requirements/?utm_source=adwords&utm_medium=ppc&utm_term=certification%20iso%20140001&utm_campaign=ISO+14001&hsa_cam=79985710&hsa_grp=4107071950&hsa_acc=6188181041&hsa_ad=457699156282&hsa_src=g&hsa_kw=certification%20iso%20140001&hsa_tgt=

Kuadri Social dhe Mjedisor <https://www.worldbank.org/en/projects-operations/environmental-and-social-framework>

Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social dhe Studimi Fillestar, për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social për Projektin e Menaxhimit të Qëndrueshëm të Burimeve Minerale (SMMRP)
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/535241468312004917/pdf/E21380EA0AFR1E10Box338888B01PUBLIC1.pdf>

Kuadri mjedisor dhe social i Bankës Botërore
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/383011492423734099/pdf/The-World-Bank-Environmental-and-Social-Framework.pdf>

Mbetjet Nxjerrëse <https://ec.europa.eu/environment/waste/mining/>

Menaxhimi mjedisor në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit
<https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/8275/-Environmental%20Management%20in%20Oil%20%26%20Gas%20Exploration%20%26%20Production-19972123.pdf?sequence=2%26isAllowed=y>

Menaxhimi i minierave për zhvillim të qëndrueshëm: Libri burimor
<https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/poverty-reduction/Managing-Mining-for-SD.html>

Natura 2000 https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

Një përmbledhje e problemeve dhe zgjidhjeve të minierave të braktitura në Afrikën e Jugut
https://www.researchgate.net/publication/276061220_A_review_of_problems_and_solutions_of_abandoned_mines_in_South_Africa

Parimet e Ekuatorit: <https://equator-principles.com>

Praktika e mirë mjedisore në industrinë evropiane nxjerrëse: Udhëzues
<http://ec.europa.eu/DocsRoom/documents/23143/attachments/1/translations/en/renditions/pdf>

Raporti i Armenisë 2016-2017 (f. 280): <https://eiti.org/document/20162017-armenia-eiti-report>

Raporti i Qëndrueshmërisë së PB 2019 (f.54-59):

<https://www.bp.com/en/global/corporate/sustainability.html>

Raporti i Qëndrueshmërisë Anglo-Amerikane 2019 (f.37-59):

<https://www.angloamerican.com/~media/Files/A/Anglo-American-Group/PLC/investors/annual-reporting/2020/aa-sustainability-report-2019-v1.pdf>

Raporti i Qëndrueshmërisë së Equinor 2019 (f.38 e tutje): <https://www.equinor.com/en/how-and-why/sustainability.html>

Raporti i njësisë së Inteligjencës për Energjinë dhe Klimën në Britaninë e Madhe: <https://ca1-eci.edcdn.com/briefings-documents/Briefing-Fracking-in-the-UK.pdf?mtime=20190529125354&focal=none>

Raporti i EITI Mongoli 2018 (f.110-115): https://eiti.org/files/documents/mongolia_2018_eiti_report_eng-12.30.pdf

Raporti i EITI i Auditimit të Naftës dhe Gazit në Nigeri 2018 (shih f. 95-100): <https://neiti.gov.ng/index.php/neiti-audits/oil-and-gas/category/203-oga-2018-report>

Raporti i Auditimit të Mineraleve të Ngurta të Nigerisë, EITI 2018 (f. 70-74): <https://neiti.gov.ng/index.php/neiti-audits/solid-minerals/category/201-sma-2018-report>

Raportet e OGA: <https://www.ogauthority.co.uk/exploration-production/onshore/onshore-reports-and-data/preston-new-road-pnr-1z-hydraulic-fracturing-operations-data/>

Raportet e shtypit: <https://www.theguardian.com/environment/2019/nov/02/fracking-banned-in-uk-as-government-makes-major-u-turn>

Raporti i Qëndrueshmërisë së Rio Tinto 2019: <https://www.riotinto.com/sustainability/sustainability-reporting>

Raporti i Qëndrueshmërisë i Royal Dutch Shell 2019 (f. 30 e tutje): https://reports.shell.com/sustainability-report/2019/servicepages/downloads/files/shell_sustainability_report_2019.pdf

Raporti i studimit për projektin e propozuar të minierave West Wits <https://s3-eu-west-1.amazonaws.com/s3live.slrconsulting.com/files/site/2018-08-03-West-Wits-Revised-Scoping-Report-for-Public-Review.pdf>

Raporti i Qëndrueshmërisë së SOCAR 2018 (p111 e tutje): <http://www.socar.az/socar/assets/documents/en/socar-annual-reports/Sustainable%20development%20report-2018.pdf>

Raporti i Qëndrueshmërisë së Tarmac 2018:

http://sustainability-report.tarmac.com/?utm_source=tarmac.com&utm_medium=referral&utm_content=footernav&utm_campaign=TarmacSustainabilityReport

Raporti i EITI Ukrainës 2017 (f. 261 & f366): <http://eiti.org.ua/en/documents/national-eiti-report-of-ukraine-2017/>

Sfidat në Adminstrimin e të dhënave të mbetjeve nxjerrëse – rasti i Polonisë <https://link.springer.com/article/10.1007/s13563-019-00203-5>

Standardet e GRI: <https://www.globalreporting.org/standards/gri-standards-download-center/>

Udhëzimet e IFC për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë

https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/topics_ext_content/ifc_external_corporate_site/sustainability-at-ifc/policies-standards/ehs-guidelines

Udhëzimet e Qeverisë së MB <https://www.gov.uk/government/publications/guidance-on-application-for-hydraulic-fracturing-consent>

Udhëzues: Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektet minerare në Finlandë https://www.researchgate.net/publication/275518512_Guide_Environmental_Impact_Assessment_Procedure_for_mining_projects_in_Finland

Udhëzimet nën-sektorale mjedisore dhe sociale: Guri, Rëra dhe Zhavorri <https://www.ebrd.com/downloads/about/sustainability/Stone.pdf>

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis <https://ec.europa.eu/environment/eia/eia-support.htm>

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) - Udhëzime për Aktivitetet e Guroreve të Gurit http://www.epd.sabah.gov.my/v1/images/pdf/EIA/eiaguidelines/EIA_Guidelines_Quarries.pdf?type=file

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisor, Social dhe Shëndetësor (VNMSSH) për Operacionet Vista Onshore - Kuadri Ligjor https://www3.opic.gov/Environment/EIA/vistaaleph/ESIA/Chapter_4/Chapter_4_Legal_Framework.pdf

Zgjerimi i fushës së vlerësimit të ndikimit në mjedis të ujit në minierë: Prespektiva e MB https://www.researchgate.net/publication/248536882_Broadening_the_scope_of_mine_water_environmental_impact_assessment_A_UK_perspective

Zhvillimi i një dokumenti udhëzues mbi praktikën më të mirë në Planet e Menaxhimit të Mbetjeve Nxjerrëse - Plani i Ekonomisë Qarkulluese https://ec.europa.eu/environment/waste/mining/pdf/guidance_extractive_waste.pdf

9. Shtojcat

9.1. Shtojca A - Foto nga zona e projektit, Albchrome



9.2. Shtojca B- Foto nga zona e projektit, Antea Cement



9.3. Shtojca C - Termat e Referencës së Projektit⁵

1. Objektivat e detyrës

Në emër të Qeverisë së Shqipërisë dhe GNP/ MSG Shqiptare, EITI Shqipëri kërkon një Konsulent kompetent dhe të besueshëm për Planifikimin e Industrive Nxjerrëse dhe Ndikimit në Mjedis, pa konflikte interesi, për të ofruar Shërbime Konsulente në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe këto Terma Reference.

Objektivi i detyrës është të vlerësojë Ndikimin në Mjedis të Industrive Nxjerrëse në komunitetet që jetojnë në zonat ku operojnë kompanitë e Industrive Nxjerrëse. Detyra do të:

- Parashtrojë analizën e ndikimit aktual të mjedisit në komunitete, ndikimin e mundshëm në secilin prej komponentëve të identifikuar mjedisorë: Mjedisi i tokës, mjedisi i ajrit, mjedisi i ujit (ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë), mjedisi i zhurmës, mjedisi biologjik, etj., dhe ku ndikon më së shumti industria Nxjerrëse;
- Identifikojë se cilët komponentë të ndikimit në mjedis përfshihen në licencat e veprimtarisë minerare dhe hidrokarbure dhe të vlerësojë se çfarë detyrimesh mjedisore dhe rehabilitimi kanë kompanitë nxjerrëse sipas kontratës / licencës;
- Analizojë se çfarë detyrimesh kanë kompanitë sipas licencës dhe çfarë është bërë në të vërtetë si edhe të japë rekomandime dhe sugjerime se cilat aspekte të kontratave dhe lejeve në këtë drejtim mund të përmirësohen;
- Paraqesë një Rast Studimor (lidhur me aktivitetin minerar) duke krahasuar implikimet e përgjithshme mjedisore dhe ekonomike të lidhura me opsione të ndryshme të zhvillimit industrial në Shqipëri dhe japë rekomandime, duke marrë parasysh gjithashtu të ardhurat lokale nga sektori, tregtinë dhe investimet e huaja, ndikimet ekonomike dhe lehtësimin e varfërisë të ndikimeve kumulative të aktivitetit: zona / aktiviteti minerar do të zgjidhet me marrëveshje paraprake me GNP/ MSG dhe Sekretariatit Kombëtar të EITI Shqipëri;
- Paraqesë gjetjet e Studimit kërkimor në një Workshop që do të organizohet nga EITI Shqipëri me praninë e GNP dhe palëve të tjera të interesit pjesë të Studimit;
- Paraqesë Raportin Përfundimtar për nevojat e GNP/ MSG, Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri dhe palëve të tjera të interesit të përfshira në proces.

2. Qëllimi i Shërbimit dhe Detyrave

Konsulenti duhet të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

- ❖ Të kryejë një Rishikim Ligjor dhe Rregullator në lidhje me Ndikimin Mjedisor të Industrive Nxjerrëse me fokus në:
 - Rishikimin e kornizës ligjore dhe rregullatore lokale për të ndihmuar në identifikimin e tërësisë së ligjeve dhe rregulloreve që janë tashmë në fuqi në lidhje me Ndikimin Mjedisor të Industrive Nxjerrëse,
 - Rishikimin e kontratave ekzistuese, lejeve dhe licencave të ndërmarrjeve që veprojnë tashmë në sektorin e nxjerrjes në Shqipëri, për identifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave në lidhje me ndikimin Mjedisor të Industrive Nxjerrëse,
 - Rishikimin e praktikës kombëtare në lidhje me ndikimin mjedisor të industrive Nxjerrëse,
 - Vlerësimin se cilat janë detyrimet mjedisore dhe rehabilituese që kanë kompanitë nxjerrëse sipas kontratës / licencës,

⁵ Terma të referencës më poshtë janë përkthyer në shqip sipas versionit anglisht të përgatitur nga EITI Shqipëri. Përkthimi i termave të referencës është kryer për arsye kuptueshmërie dhe lexueshmërie nga publiku i gjerë dhe palët e interesit.

- e) Identifikimin e boshllëqeve dhe këshillimin mbi praktika më të mira që do të ndiqen në të ardhmen.
- ❖ Të kryerjë një studim bazuar tek të dhëna ekzistuese për të identifikuar të gjitha përgjegjësitë kryesore të korporatave / Standardet mjedisore, në përdorim nga Industria Nxjerrëse (minierat dhe hidrokarburet), dhe identifikimin e atyre që përmbajnë / synojnë Ndikimin në Mjedis.
 - ❖ Të paraqesë një Rast Studimor (lidhur me aktivitetin minerar) duke krahasuar implikimet e përgjithshme mjedisore dhe ekonomike të lidhura me opsione të ndryshme të zhvillimit industrial në Shqipëri dhe japë rekomandime, duke marrë parasysh gjithashtu të ardhurat lokale nga sektori, tregtinë dhe investimet e huaja, ndikimet ekonomike dhe lehtësimin e varfërisë të ndikimeve kumulative të aktivitetit: zona / aktiviteti minerar do të zgjidhet me marrëveshje paraprake me GNP/ MSG dhe Sekretariatit Kombëtar të EITI Shqipëri;

Konsulenti duhet të ofrojë aktivitetet e mëposhtme për ndërtimin e kapaciteteve:

- ❖ Wokshop gjysmëditor për të prezantuar gjetjet e Studimit Kërkimor dhe për të prezantuar ushtrimin dhe metodologjinë. Pjesëmarrësit duhet të përfshijnë GNP/ MSG, përfaqësues të Qeverisë, përfaqësues të qeverisë lokale, përfaqësues të kompanive nxjerrëse, si dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.
- ❖ Takim Prezantues një-ditor për të gjithë aktorët për të prezantuar gjetjet dhe Studimin Përfundimtar. Të japë rekomandimet mbi praktikën më të mira që do të ndiqen në të ardhmen dhe një deklaratë mbi gjetjet nga kërkimi, boshllëqet dhe praktikën më të mira.

Pritet që numri i të pranishmëve të mos kalojë 60 pjesëmarrës.

3. Dokumentet që do të dorëzohen

Detyra pritet të fillojë në gusht 2020 me përfundimin e saj deri deri më 30 Shtator, 2020.

Konsulenti do të ketë një periudhë prej 40 ditësh kalendarike për të përgatitur detyrën.

Studimi do të përgatitet në të dy gjuhët, në Anglisht dhe Shqip.

- Konsulenti do të përgatisë dhe paraqesë Raportin Fillestar që përshkruan metodologjitë që do të përdoren dhe punën që do të kryhet përfshirë planin e detajuar të punës pranë Sekretariatit EITI Shqipëri për shqyrtim dhe koment brenda 3 ditësh nga data e caktimit;
- Konsulenti do të përgatisë dhe paraqesë draftin e Studimit Kërkimor për Vlerësimin në Mjedis të Industrive Nxjerrëse, pranë Sekretariatit EITI Shqipëri për shqyrtim dhe koment brenda 20 ditësh nga data e caktimit;
- Sekretariati i EITI Shqipëri do t'i japë komente Konsulentit brenda 7 ditëve të ardhshme kalendarike.
- Konsulenti do të përgatisë prezantimin e Studimit Përfundimtar, brenda 10 ditëve kalendarike nga dërgimi i komenteve.

Programi i propozuar është si më poshtë:

Nënshkrimi i Kontratës	Gusht 2020
Dërgimi i Studimit Fillestar	3 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Dërgimi i draft- Studimit Kërkimor	20 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Workshop mbi draft-Studimin kërkimor	22 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës

Nënshkrimi i Kontratës	Gusht 2020
Dërgimi i Studimit Përfundimtar	37 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Takim për prezantimin tek aktorët e tjerë	40 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës

9.4. Shtojca D - Formati i raportimit i të dhënave mjedisore, EITI

9.4.1. Hyrje

Qëllimi i Formatit	
Për të përmbushur kërkesat e Standardit EITI 2019 për identifikimin e pagesave mjedisore dhe për të raportuar mbi ndikimin mjedisor të aktiviteteve të industrive nxjerrëse.	
Kërkesa 6.1.b parashtrohet, "Kur pagesat materiale që kryejnë kompanitë për qeverinë në lidhje me mjedisin janë të detyrueshme me ligj, rregullorja ose kontrata që rregullon investimin nxjerrës, parashtrohet se këto pagesa duhet të publikohen".	
Në kërkesën 6.4 thuhet, pjesërisht, "Vendet zbatuese nxiten të zbulojnë informacione mbi Adminstrimin dhe monitorimin e ndikimit mjedisor të industrive nxjerrëse".	
Ky dokument përmban fletët e mëposhtme:	
	* Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)
	* Monitorimi dhe Vlerësimi i Mjedisit (MVM) - Pas Fillimit
	* Administrimi i Katastrofave Mjedisore (MKM)
Udhëzimet:	
1.	Vendosni emrin e kompanisë raportuese në kutinë më poshtë. Kjo duhet të jetë kompania që zotëron licencën dhe duhet të jetë forma ligjore e emrit të kompanisë siç regjistrohet në regjistrin e kompanive.
2.	Plotësoni VETËM fletët që kanë të bëjnë me aktivitetet e kompanisë suaj
3.	Vendosni detaje vetëm për incidentet ose pagesat mjedisore që kanë ndodhur ose janë bërë në periudhën raportuese, viti financiar 2019.
3.	Të gjitha kutitë me ngjyrë portokalli duhet të plotësohen. Nëse paraqitja zero, ju lutemi tregoni kështu në secilën kuti portokalli
4.	Dërgoni kopje elektronike në format PDF të dokumenteve të mëposhtme, nëse është e nevojshme, kur të dërgoni këtë format.
i)	Raportet e VNM-së
ii)	Raportet e MVM-së
iii)	Raportet e MKM-së
5.	Nëse duhet të raportoni për më shumë se një fushë ose objekt nën të njëjtën kompani, ju lutemi bëni kopje të fletëve përkatëse
Emri i Kompanisë Raportuese	
Pas përfundimit, ju lutemi dorëzoni formularët e plotësuar dhe dokumentet burimore të skanuara, me postë elektronike,	

9.4.2. Të dhënat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

[illegible]

9.4.3. Monitorimi dhe Vlerësimi i Mjedisit (MVM) - Të dhënat pas fillimit

[illegible]

9.4.4. Të dhëna mbi Menaxhimin e Katastrofës Mjedisore

Lënda:	Të dhëna mbi Adminstrimin e Katastrofës Mjedisore										
MARRËVESHJET TREGËTARE - BO											
Emri i fushës ose i Objektivit											
Emri i Operatorit											
Përshkrimi i Katastrofës											
		Numri i ngjarjeve ose i incidenteve	Vendi/vendndodhja e Ngjarjeve	Humbje në njerëz/ jo - financiare	Pagesë për Qeverinë		Pagesë për Komunitetin		Pagesa e përgjithshme		Përshkrimi i Strategjisë së Rikuperimit
					LC	USD	LC	USD	LC	USD	
Ndotja e ujit (derdhje të naftës, etj)											
Ndotja e Ajrit (tymi, zjarri, etj)											
Ndotja e Tokës (Dhuna, sabotimi, aksidenti, etj)											

Ky punim u mbështet nga Fondi Shumëdonator i Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS), i administruar nga Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtoreve Ekzekutive të saj apo qeverive që ata përfaqësojnë.